


Nuk më kujtohet në ç'rrethana i jam prezantuar. E di se ndodhi në Paris rreth vitit 1930. Në ndonjë provë gjenerale? Ndoshta. Për mua, Pirandello përfaqësonte shkëlqesinë e fundit botërore, shkrimtari i cili solli një notë të re në dramaturgjinë bashkëkohëse. Nuk mund të mos kërkoja ta njihja.

Për të unë isha një publicist ballkanas i paqartë, drejtor apo sipërmarrës teatri, i cili nuk i kishte paguar honoraret dhe mund të luante me të, sigurisht duke i paguar detyrimet monetare.

VIKTOR EFTIMIU

Takimet e mia me Luigi Pirandello-n

Përktheu nga gjuha rumune Pandi Bello



NESËR, 88-VJETORI I KADARESË

ROMANI "KËSHTJELLA" I
KADARESË DHE KTHESA
QË SOLLI NË ROMANIN
HISTORIK SHQIPTAR

Prof. Dr. Klara Kodra (fq. 10)

KADAREJA ËSHTË
PLOTËSIA E TRINISË
KOMBËTARE

Nga Dr. Bledar Kurti (fq. 4)

SHËNIME MBI LIBRAT

"ALIPASHAIDA" E IRAKLI
KOÇOLLARIT, NJË
LIBËR I RRALLË

Nga Enver Kushi (fq. 5)

Në 100 vjetorin e lindjes

QAMIL BUXHELI – MË E
BUKURA MENDJE E HUMORIT

Nga Josif Papagjoni (fq. 8)

DOM NDRE ZADEJA DHE
MELODRAMA "ROZAFI", 87
VJET MË PARË...

nga Xhahid Bushati (fq. 7)

Bujar Kapexhiu, "Variacione", Uet Press

KARAKTERET E
PORTRETEVE NË VIJËZIME
KRIJUESE ARTISTIKE

nga Enver S. Morina (fq. 12)



Për një poetikë krahasimtare në studimet shqipe: perspektiva historiko- letrare e ALI XHIKUT

Nga Blerina Suta

A është e mundur një histori e letërsisë shqipe përmes gjinive? Vepra e profesor A. Xhikut është, ndoshta, e vetmja histori e letërsisë shqipe deri më sot që synon të gjejë në zhvillimin e secilës prej gjinive tiparet që dëshmojnë se vepra asnjëherë nuk përputhet me tiparet e gjinisë, se te thyerja qëndron legjitimiteti i veprës... (fq. 6)

PREZA FËRGËLLON E
EMOCIONUAR NË DIELL
Reportazh nga Xhevair Lleshi

(fq. 18)

Një intervistë e pabotuar me

G. G. MÁRQUEZ:

Ndoshta mitet
për mua janë më
interesante se jeta ime

Në këtë intervistë të pabotuar deri tani, fituesi i Çmimit Nobel në Letërsi në vitin 1982, diskuton mbi muzikën, Karaibet, paratë, dashurinë, librat, dhe idetë. (fq. 20)



BIBLIOTEKË

Nurie Emrullai (fq. 11)

Princesha e peshqve

Sabit Rustemi (fq. 14)

*Brenda një grimce
që drithëron*

Ylli Pango (fq. 15)

Dy tregime

Charles Bukowski (fq. 19)

Gjeniu i turmës

Përktheu Roland Gjoza

CHARLES
BAUDELAIRE,
THEMELUES I
POEZISË MODERNE

Prof. as. Dr. Anton Papeka (fq. 16)

SI U EDUKUA SYRI IM TË
SHOHË SOT TABLONË
"ORIGJINA E BOTËS" TË
GUSTAVE COURBET

Nga Eleni Laperi (fq. 22)

Nuk më kujtohet në ç'rrethana i Njam prezantuar. E di se ndodhi në Paris rreth vitit 1930. Në ndonjë provë gjenerale? Ndoshta. Për mua, Pirandello përfaqëson shkëlqesinë e fundit botërore, shkrimtari i cili solli një notë të re në dramaturgjinë bashkëkohëse. Nuk mund të mos kërkoja ta njihja.

Për të unë isha një publicist ballkanas i paqartë, drejtor apo sipërmarrës teatri, i cili nuk i kishte paguar honoraret dhe mund të luante me të, sigurisht duke i paguar detyrimet monetare.

Vetëm kur rron jashtë vendit kupton se sa pak vlen një shkrimtar nga një vend i vogël dhe sa kalimtare është lavdia e dobët që gëzon në atdhe. Afrohesh pranë njerëzve të mëdhenj, duke iu zgjuar vëmendjen për një interes personal.

Kështu, fjalët me të cilat më priti Pirandello ishin:

- Më janë luajtur disa pjesë në Bukuresht dhe nuk kam marrë asnjë para...

Replika nuk më befasoi, sepse Pirandello ishte i pari dramaturg i huaj i cili reklamonte të drejtat e autorit dhe nuk kuptonte pse i ishin konfiskuar nga drejtorët bukureshtean.

Evreinov edhe sot pret atë që i takon për pjesën *Komedia e lumturisë*. Ndërsa nëse një avokat i aftë do të ndiqte teatrot tona, vetëm për Bernard Shaw-un do të fitonte disa qindra mijëra lei.

(Midis dokumenteve me të cilat "më mbante në dorë" i ndjeri Mavrodi, ishte edhe një faturë me 1000 franga franceze të dhëna Hugo Hoffmannsthal-it për pjesën *Elektra*, të luajtur gjatë drejtimit tim të parë në Teatrin Kombëtar. Shtypi më sulmoi menjëherë për këtë "abuzim".)

Kur ke vizituar Marinettin, i cili është një vullkan me shpërthime të vazhdueshme, shpërthyes i lartë dhe entuziast, i paparashikueshëm dhe i pastër (ka pak kohë që Marinetti më duket i lodhur dhe përgjumet ku të mundet), i njohuri i Pirandello-s fillon një hyrje e re në genin e madh dhe të ndritshëm italian, në lojën me të pakuptueshmen, të jashtëzakonshme dhe të pa vlefshme për njeriun lindor që nuk beson.

Por Pirandello nuk kishte asgjë nga jugu akrobatik që e jepte emri i tij me tingëllimë trompete. Ishte një burrë në moshë të madhe me trupin e dobësuar, i përmbajtur, ngjante në fytyrë me mareshalin Presan. Në sjellje dhe buzëqeshje, ngjante me dashamirësinë dhe kujdesin e G.Taushan.

Nuk më tha asnjëherë gjëra të jashtëzakonshme. Ndoshta nuk kishte asgjë për të treguar ose i ruante për vete. Vetëm një herë tha diçka që dilte nga e zakonshmja: Në përfundim të një të ngrëne ngrinim

VIKTOR EFTIMIU

Takimet e mia me Luigi Pirandello-n

Përktheu nga gjuha rumune Pandi Bello

të dy duart me një gotë prej kristali në fund të së cilës lëkundej pak konjak. Duke përfunduar ceremoninë këndonim me zë të ulët masat e fundit të Parsifal-it (Opera e fundit e kompozitorit Rikard Wagner, shënim i përkthyesit).

- Wagner nuk është një kompozitor i madh... Bellini - ja muzikanti! - më tha plot melankoli Pirandello.

Një kohë takoheshim shpesh. I interesoja si sipërmarrës. Shihte tek unë njeriun që mund të organizonte një turne në jug-lindjen europiane për aktoren me të cilën ishte i dashuruar.

Gjithashtu një njeri i shkëlqyer i teatrit francez më dërgoi para 10 vitesh të bëja me zonjën Noyka-Iniota, valltarja e cila kishte qenë para disa ditësh në Bukuresht, një seri me spektakle nëpër vendet tona më pak të vizituara. Gjithmonë sipërmarrës. Vetëm Isai Racaciunin e marrin drejtorët parisienë në stacioni i trenit dhe i kërkojnë libra për ta prezantuar.

E takoja Pirandello-n në teatër ose hanim bashkë në një restorant italian pranë Champs Elysee. Fillova të sillem me të si Marinetti,

domethënë të flas vetëm unë, t'i tregoj gjëra të jashtëzakonshme. Kisha një pasuri ekstreme në të folur. Isha një lloj Pirandello autentik që e ngryste atë që kisha përballë. I bëja një terror të ëmbël mjeshtrit të butë aq kurioz në vepra dhe aq i thjeshtë në jetën e përditshme.

Një zakon i keq më shtynte të shijoj nga pjata e të tjerëve. E kuptoi vesin Pirandello. Porsa i sillej ushqimi më ndante një pjesë dhe ma afronte. Faleminderit mjeshtrë! i thashë një herë. Rri i qetë se unë të ha vetëm makaronat, por të tjerët të vjedhin pjesët dhe personazhet!

Ishte i dashuruar me një aktore përballë së cilës bëhej i vogël. Diçka si baba shumë i ndjeshëm, si fëmijë i trembur dhe si dashnor i zbuar, në gjithë sjelljen e tij përballë kësaj gruaje që mungonte gjithmonë me sy prej somnambule dhe me qëndrime me kërcënime të vazhdueshme si të një maceje të egër.

Porsa nuk flitej për të, për lavdinë e saj të ardhshme universale, për turnetë në Europën Lindore, na kthente kurrizin të gjithëve dhe shikonte ventilatorin. Që ta risillte mes nesh i shkreti Pirandello fillonte ta lavdëronte përsëri të fliste për



triumfet që e prisnin në vende ku Eleonora Duse dhe Emma Gramatica - aktore inferiore në raport me të - ishin pritur aq shkëlqyer.

Duke abuzuar me pasionin që ia shfaqte ky njeri, i goditur rëndë nga dëshira për martesë, komedianja e çuditshme sillej si një mbretëreshë me një djalosh fisnik të dashuruar. Për francezët e moderuar dhe të sjellshëm kjo frymë prej zanatçieje të përkëdhelur kishte diçka barbare dhe arkaike.

Nuk e kam kuptuar asnjëherë më mirë sensin e fjalës *meteque* se sa në kohën kur kam parë një aktore të zakonshme duke fyer, me anë të sjelljes së saj ndaj dramaturgut më të shkëlqyer të epokës, Parisin e dashur e të sjellshëm, ku ekstravaganca nuk ka ç'të kërkojë, ku njeriu duhet të jetë miqësor, i përmbajtur dhe më pak i pa vërtetë se kudo.

Pirandello nuk e kuptoi asnjëherë pirandelizmin, domethënë atë lojë me personazhe imagjinare, rezultat i një loje ideshë, jo e realitetit të vrojtuar.

Originaliteti i Pirandello-s nuk ishte një djallëzi mendore, një mekanikë e të pavërtetës, por kopja e thjeshtë e një realiteti tragjik Ajo



qenie e cila është dhe nuk është vetë ai i çmendur apo ajo e çmendur, ajo krijesë që e ka humbur personalitetin dhe del gati në të gjitha dramat e Pirandello-s nuk është veçse gruaja fatkeqe e dramaturgut. Ka shumë vite që kur zonja Pirandello është mbyllur në një sanatorium. Turbullimi i kësaj gruaje të shkretë, reagimet e saj shpirtërore, largimet e saj në botë imagjinare kanë krijuar të gjithë letërsinë dramatike të të ndjerit siçilian. Përtej këtij depërtimi turbullues të disa të zotëruarve, vepra e Pirandello-s nuk ndryshon në asgjë me shkrimin e ndershëm të një shkrintari të mirë realist.

Asgjë e jashtëzakonshme, as në konstrukcion, as në idetë, as në dialogun e Pirandello-s. Hiqni gjykimin e dobët dhe do mbetet e përditshmja.

Ja pse vetë Pirandello nuk e konsideronte veten një shpikës i madh teatri, një vizionar, një impresionues. Ai ka kopjuar deri në fund një model tragjik. Vetëm atyre që nuk kanë njohur enigmën mund t'ju duket pirandelismi një formulë arti e re.

E kam takuar herën e fundit në Theatre de Mathurins në mbrëmjen kur intelektualiteti francez i festonte Çmimin Nobel.

Nuk mbaj mend grososje më të tmerrshme se sa ky festim. Ishin shumë njerëz, nga më të zgjedhurit, pra nga ata më të ngarkuarit me elektricitet, autoritete, autorë, kritikë. Pirandello i vodhi secilit çmimin e shpikësit të dinamitit. Shumë vetëve i u ra shpejt një pjesë.

Një italian i organizonte festën një armen rus. Pitoeff nuk ishte një organizator tavolinash që të entuziazmonte një Paris të tërë që kishte nisur qëndrime kundër të huajve.

Atmosfera nuk ishte nga ato më të favorshmet për pasionin e madh kolektiv. Pjesa që do luhej, *Në këtë mbrëmje do improvizojmë*, ishte fantazia e fundit dramatike e Pirandello-s dhe ribotonte temën e tij të preferuar: "Unë nuk jam unë. Ajo që besoni se është teatër ndodh qartë, ndërsa ajo që ju duket realitet është thjesht falsitet".

Shumë e komplikuar. Heronjtë ishin dhe nuk ishin realë, si në ato *Gjashtë personazhe në kërkim të një autori*. Në një moment aktorët nuk luanin më me tekstin dhe flisnin me emrat e tyre:

-Nuk ke të drejtë i dashur Pitoeff!


Ose:

-Dëgjo Fainsilber!

Ose:

-Ljudmilla, mos luaj me kaq sinqeritet, sepse do të ndihesh keq.

(Në një moment, zonja Pitoeff u ndje vërtet keq, por nuk dihet nëse ishte e vërtetë apo ishte një i fikët i parashikuar në pjesë).



I gjithë ky veprim, në dukje i mrekullueshëm, do të vazhdonte në tre akte. Por spektakli do të fillonte në orën 10, në mënyrë që të mbaronte pas mesit të natës, kur aktorët që e kishin interpretuar më parë Pirandello-n bënin riprezantimin në teatri respektiv dhe vinin të nderonin mjeshttrin, duke luajtur skenat më të rëndësishme të sukseseve të vjetra.

Pitoeff, drejtori i trupës dhe organizatori i festes, e quajti të domosdoshme të mbajë një referat për artin e Pirandello-s, si duhet kuptuar teatri, falsi në realitet, realiteti në fals, që nga pantomimë në barok ose diçka të tillë.

Pitoeff ngatërrohej, përsëriste dhe pas gjysmë ore pasi na mësoi se në Pirandello unë nuk jam unë, ndërsa ajo që besoni se është e qartë nuk është veçse false etj., arriti ta bëjë sallën të padisponueshme për gjithë mbrëmjen.

-Ky është i mërzitshëm! - Protestonte tepër fort në lozhën e afërt një zotëri plak dhe i shëndoshë,

i veshur me frak, me pamjen e një borgjezi të harruar në teatër.

-Kush është zotëria? - e pyeta zonjën Benjamin Cremieux, e cila më pranoi miqësisht në lozhën e saj.

- Mareshali Franchet d'Esperay! - më tha me zë të ulët Anne-Marie Comnene.

Në një konjunkturë kaq të fryrë u luajt e pavlefshmja *Në këtë mbrëmje do improvizojmë*, nga e cila askujt nuk i mbeti asgjë.

Në pauzë, një ministër dekoroi të festuarin me një lloj trëndafil të Legjionit të Nderit.

Kjo u krye në formë konfidenciale në një qoshe të sallës. Pas mesit të natës filluan të arrijnë edhe aktorët e shquar duke luajtur pa makiazh dhe kostume skenat kryesore të pjesëve të dikurshme.

Të gjithë thoshin gati të njëjtë gjë:

- Unë nuk jam unë...Ajo që ti beson nuk është e vërtetë... Çmenduria ime është shumë më logjike se sa mençuria jote...

Ngjante si një revistë ngjyrë gri,

parodi e genit Pirandello dhe më e rëndë sepse zgjati deri më dy të mëngjesit.

Në lozhën tonë ishte edhe aktorja për të cilën ju fola. U prezantua dhe ajo, pa një sukses special, si një numër Pirandello.




Dukej më humane se herët e tjera. Kaloi dhe ajo disa vjet, ndërsa lavdia universale nuk i erdhi. Bota merrej me Greta Garbo-n dhe Marlene Dietrich.

Eleonora Duse arriti kohë më të favorshme për aktoret me temperament. Tani jetojmë në kohën e ansambilit të vlerave të ekranit.

Erdhi edhe Pirandello të na thoshte mirë mbrëma. Nuk e kisha parë prej shumë kohe. Ishte më i verdhë dhe më melankolik se çdo herë.

Kujtoja se më kishte harruar. Por jo. U përkul në parmakun e lozhës dhe më shtrëngoi dorën për herë të fundit:

Natën e mirë zoti Eftimiu!



Pa Ismail Kadarenë, letrat ndërshekullore shqipe do të ishin thjesht një holokaust mendimi dhe një abort intelektual. Talenti, pena dhe forca e tij e mendimit janë *exclusif*. Ismail Kadare ka *exclusivitet* të ketë një forcë të fjalës e cila ka frymëzuar pothuajse të gjithë shkrimtarët aktualë shqiptarë të bëhen njerëz të librave dhe me mijëra të tjerë që aspirojnë të hynë në këtë udhëtim. Askush tjetër nuk e ka patur e nuk e ka një pushtet të tillë. Askush tjetër nuk ka frymëzuar kaq shumë njerëz të lexojnë apo të shkruajnë, apo të dashurohen me letërsinë.

Forca e Kadaresë është fjala. Ajo lind, krijon dhe kapërcen muret e mijëvjeçarëve. Fjala është *exclusivitet*, një urë lidhëse e realitetit me mbretërinë e qiejve, ndaj edhe ajo ishte që nga fillimi dhe do të jetë deri në fund. Kush e kupton është *exclusif*, kush e transmeton është i parazgjedhur, kush e kërkon është i ndriçuar. Të tjerët, ata që janë larg fjalës, lindin e ngordhin në shurdhi e shkretinë. Ndaj edhe thuhet:

Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Ai (fjala) ishte në fillim me Perëndinë.

Sigurisht që këtu flitet për Perëndinë dhe Krishtin, jo për mjeshttrin Kadare, por gjithsesi koncepti, zbatueshmëria dhe rekuizimi mbi fjalën mbetet edhe për vdekatarët. Ajo ka atributet e krijimit dhe shpengimit. Ndaj edhe Kadareja, pavarësisht se do të ishte tërësisht e pavend të vishej me petkun e mitit dhe për më tepër herezi të përshkruhej me ngjyra hyjnie, nuk ka asnjë dyshim që, sikurse e gjitha elita botërore e letërsisë, nuk është thjesht skrib, por një levit i fjalës.

Të gjithë mund të hynin në tempull, të gjithë mund të adhuronin në të, por ishte vetëm një fis i caktuar që mund të hynte në tebernakull, në shenjtorin e tempullit. Këta ishin levitët. Dhe çfarë gjendej në vendin më të shenjtë të të shenjtëve? *Arka e Besëlidhjes*. Dhe çfarë kishte brenda arkës? Dy rrasa guri me dhjetë urdhëresa. Pra, fjalë të gdhendura në gurë. Prandaj edhe fjala është *exclusivitet*. Prandaj edhe Kadareja është leviti i vetëm me shërbesë universale në historinë e letrave shqipe. Ka pasur edhe levitë të tjerë që u kanë shërbyer nevojave të këtij vendi e këtij populli dhe pa asnjë dyshim gjithsecili prej nesh duhet t'u jetë mirënjohës, por Kadareja ka qenë dhe do të mbetet leviti që frymëzon aventura në fantazinë e fjalëve, udhëtime ndërhapësinore historike dhe kulturore, dhe paraqet si asnjë penë tjetër shqipe faktin më themelitar që harrohet nga çdo shkrimtar shqiptar, që fjala nuk mund të banojë dot brenda kufijve. Qofshin ata gjeografikë apo mendorë.

Pena e tij është ngjizur në Shqipëri, por vendmbërritja e fjalëve të tij shkon përtej kohës dhe hapësirës. Dy nga përbërësit e vetë universit tonë dhe pa dyshim atij letrar, xhelozojnë cilindo mekanizëm mendor që funksionon me lëvizje të avashtë.

Në periudhën e errët të regjimit komunist, nën dekadat e mortit të shpresës, një penë dhe një dorë e thjeshtë frymëzoi shqiptarët të bëhen shkrimtarë e mendimtarë. Disa ia dolën të afirmohen e disa jo por ne lexuam, ëndërruam, pamë një univers tjetër në çdo faqe të librave të Kadaresë. Lexuam *Pallati i Ëndrrave* dhe kuptuam që në momentet kur e liga të censuron edhe ëndrrat, gjëja më e keqe që mund të bëjë një njeri është të bëjë asgjë. Kadareja e përshkroi atë institucion varrmihës të ëndrrave në ditët e veta më të forta. Një akt guximi që frymëzoi dhe u manifestua më pas edhe në shkrimet e shumë shkrimtarëve të tjerë.

Pallati i Ëndrrave ishte shuplaka më e madhe ndaj regjimit komunist në Shqipëri. Kjo vepër frymëzoi shumë intelektualë të kohës dhe u la të kuptojnë që vetëm peshku i ngordhur shkon me rrjedhën. Pjesa më e madhe e artistëve të atyre viteve ishin konformistë, sado të vegjël apo të mëdhenj, fanatikë të kuq apo oportunistë privilegjesh. Sot ne e dimë, por edhe vetë ata e kuptojnë,

Kadareja është plotësia e trinisë kombëtare

Nga Dr. Bledar Kurti

që nuk ishin tjetër veçse peshq të ngordhur. Nën atë marrëzi nuk kishte rregulla. Nuk kishte një udhëzues apo protokoll që duhej të ndiqej sesi të mbeteshe i papërlyer nën diktaturën më të ashpër të Europës.

E vetmja gjë që udhëhiqte mendjen, zemrën dhe vullnetin, ishte instinkti i mbijetesës. Megjithatë, kërkohej vetëm një akt shpagimi për të ecur kryelartë e pa turp drejt së ardhmes. Ashtu si keqbërësi i kryqëzuar në krah të Krishtit u shpëtua vetëm me një akt të vetëm kur tha: "Zot, kujtohu për mua kur të vish në mbretërinë tënde", ashtu edhe disa shkrimtarë shqiptarë u shpëguan përpara historisë dhe së ardhmes përmes penës së tyre. Ata të tjerët që nuk e morën këtë guxim, sidomos ata që ende jetojnë dhe krijojnë edhe sot, duhet të jenë modestë në kujtimet e tyre dhe për asnjë moment nuk duhet të shiten për atë çfarë nuk kanë qenë kurrë: levitë të fjalës dhe lirisë. Me *Pallati i Ëndrrave* i vitit 1981, kur Përbindësi ishte edhe më i rrjedhur dhe paranojak sesa më parë, pena e Kadaresë i dha dy sinjale të fuqishme atij regjimi: që nuk jeni të paprekshëm dhe se edhe kur prekeni, jeni aq injorantë e të trashë, saqë nuk arrini ta kuptoni talljen e një shkrimtari me ju.

Kur ne ishim më lindorë në mendim sesa më lindorët gjeografikisht, Kadareja të yshtte me një refleks Perëndimi. Të gjitha personazhet e penës së tij janë civilë e sharmantë, të hirshëm, tërheqës, disi të ftohtë e të përmbajtur, aspak ballkanikë e provincialë, por gjithnjë plot kulturë e intelekt. Të gjithë shkrimtarët e tjerë ranë pre e barazisë së klasave dhe e provincializmit. Komunizmi i ngrinte mendjen karrocierit se ishte filozof dhe bujkut se ishte poet, pa kuptuar ata mjeranë se kjo dredhi nuk bëhej për t'i ngritur vlerat e tyre, por për të ulur vlerat e filozofëve, poetëve dhe shkrimtarëve të vërtetë. Por Kadareja arrinte gjithmonë të kapërcente gravitetet e censurës dhe sterrosjen e regjimit, duke krijuar personazhe dhe koncepte të mëdha që vetëm sa nxirrnin zbuluar injorancën dhe privimin e talentit tek ata që u bënin

recensione veprave të tij, që e denonconin atë apo që mundoheshin t'ia ndalonin botimet.

Në pikun e asaj marrëzisë, Kadareja shkruante në disa nivele të perceptimit letrar, prej të cilave disa kuptoheshin nga regjimi e disa të tjera jo. Shumë shkrime ishin të shigjetuara ndaj vetë diktaturës, me një ton prej disidenti kolosal, si te vepra *Dimri i Vetmisë së Madhe*, e cila fliste pikërisht për diktatorin famëkeq, E. Hoxha.

Kadareja është ndërgjegjja e kombit tonë. Për më tepër, veprat e tij kanë shërbyer e do mbeten një portë yjesh. Falë tij Shqipëria e vogël dhe periferike, ritet tona, tradita jonë, qytete tona si Gjirokastra, prej dekadash janë në duart e lexuesve në mbarë globin. Me dhjetra kombësi kanë *Kronikë Në Gur* e janë mahnitur qysh në faqet e para:

Duke ruajtur me vështirësi jetën njerëzore në gjymtyrët dhe nën lëvozhgën e tij të ngurtë, qyteti i shkaktonte asaj padashur shumë dhimbje, gërvishje dhe plagë, dhe kjo ishte një gjë e natyrshme, përdërisa ky ishte një qytet prej guri dhe çdo prekje e tij ishte e ashpër dhe e ftohtë. Ishte e vështirë të ishte fëmijë në këtë qytet.

Rrallë mund të gjendet një përshkrim i tillë i një qyteti në mbarë universin e letrave. Ky përshkrim i Gjirokastrës, që në faqet e para të librit e liston penën e Kadaresë në elitat e letërsisë botërore. Por, përtej artit *per se*, ka shërbyer edhe si far orientues mbi botëkuptimin sesi vende dhe shoqëri të ndryshme e shohin pozicionin që zënë ata në raport me mbarë rruzullin.

Ishte Ernest Hemingway ai që i joshi dhe i ngashënjeu amerikanët me aromën europiane, u zbuloi atyre se çfarë kulturash, traditash, pasionesh, qytetërimesh dhe bukurish gjenden jashtë kufijve. Veprat e tij bënë që Spanja, Afrika, Italia, Franca, Havana, demat, treadingorët, peshkimi, gjuetia e elefantëve, përcudnitë, tmerrret e luftës dhe e gjithë bota me bukurinë dhe trishtimin e saj të vinte te lexuesi amerikan. Të njëjtën gjë ka bërë edhe




Kadareja, por në mënyrë të anasjelltë. I tregoi mbarë botës se kush është Shqipëria, Gjirokastra, natyra dhe tradita e shqiptarit, soji i rrallë i komunizmit që u mbart dhe u kultivua këtu për gjysmë shekulli, dhe detaje të tjera të cilat jo vetëm bota, por edhe vetë të lindurit e kësaj toke nuk do t'i kishin vënë re kurrë. Dhe lexuesit, nga çdo skutë dhe skaj i globit, e kishin të voglën Shqipëri në studion e tyre, në xhepin e tyre, në çantën e tyre, në duart dhe në mendjen e tyre, të manifestuar e të zbuluar në mënyrë madhështore.

Ismail Kadare është i vetmi në Shqipëri që e ofron këtë portë yjesh. Asnjë shkrimtar tjetër, asnjë artist, muzikant, aktor, etj, nuk të përball me një pasqyrë boshe ku ti sheh pak nga pak pjesë nga vetja dhe kombi nga ku vjen, në varësi të perceptimit që të ofrohet nga ajo çfarë reflekton pas pasqyrës. Kjo është magji. Ky është gjenialitet. Të gjithë shkrimtarët dhe artistët shqiptarë të shekullit të njëzetë, por edhe më herët, pa asnjë përjashtim, e hapën kompasin e mendjes, talentit dhe ndikimit deri në kufijtë e këtij shteti të vogël. Fatkeqësisht, shkrimtarët vendas të këtij shekulli të ri e kanë shtrirjen e kompasit edhe më të ngushtë. Ata matin veten sa lart e gjerë, në zbulim të rolit që luajnë si individë në një shoqëri vendase e krahinore, ndërkohë që misioni i shkrimtarit është të përshkojë dimensionet dhe universet të tjera të cilat shtrihen përtej gjeografisë, madje edhe vetë realitetit.

Shkrimtarët dhe artistët janë *exclusivitet* e një shoqërie. Ata më gjenialët janë levitë të parazgjedhur të fjalës. Për ta fjala është më e shenjta e së shenjtës. Ata janë në shërbim të rrasave të Besëlidhjes midis njeriut dhe krijuesit të njeriut. Si levitë, janë ndërgjegjja e një kombi. Ata i shërbejnë *Arkës së Besëlidhjes*, ose *Arka e Dëshmisë*, siç njihet ndryshe. Ndaj shkrimtarët e kalibrit të Kadaresë e kanë si mision të tyre të dëshmojnë. George Orwell dëshmonte për atë që shihte në të ardhmen, ndërsa Kadareja dëshmon për atë që përjetoi në të tashmen e tij dhe në të shkuarën tonë si një komb. Të dy këta, bashkë me shumë pena të tjera mbarëbotërore, janë levitë në tebernakullin e letërsisë dhe qytetërimit. Brenda Arkës së Dëshmisë gjendeshin rrasat mbi të cilat ishin shkruar dhjetë urdhëresat, por gjithashtu kishte edhe një enë të artë me *mana*, si edhe shkopi i Aaronit. Ndaj një penë si e Kadaresë dëshmon përpara mbarë botës forcën e fjalës, mrekullinë e manës, ushqimit dhe çlirimit që ra nga qielli edhe kur marrëzia i shpalli luftë Perëndisë në vitin 1967 dhe shërben si ndërgjegjja e një kombi, ashtu siç shërbente shkopi i Aaronit. Ndaj vepra të Kadaresë, si *Piramida*, *Hija*, *Shkaba*, *Spiritus*, *Vajza e Agamemnonit*, *Pasardhësi*, *Darka e Gabuar*, *E penguar: Rekuem për Linda B.*, *Aksidenti*, *Kukulla*, *Mëngjeset në Kafe Rostand* etj., vazhdojnë të dëshmojnë për historinë, botëkuptimin dhe karakteristikat e Shqipërisë.

Së fundmi, Ismail Kadare është plotësia e trinisë kombëtare. Nëse Gjergj Kastrioti është simbol i guximit dhe qëndresës së popullit tonë, Nënë Tereza, zemra e madhe e Shqipërisë, Ismail Kadare është mendja dhe pena e ndritur e kombit shqiptar.

Gëzuar 88 vjetorin e lindjes Ismail Kadare.



Ishte e shtuna e fundit e vitit 2023, ose më saktë mesdita e asaj dite, kur diku pranë kinema "Agimit", u takova me Prof. Irakli Koçollarin. Portreti i tij i qeshur, veçanërisht vështrimi i butë dhe i zgjuar, që përshfaqin mirësi, por edhe modesti të një personaliteti të diplomacisë, historisë dhe kulturës shqiptare, mbetën pjesë e përhershme e qënies së tij. . . Pasi më dhuroi librin e tij më të fundit "Alipashaida"-kronikë e një lindje të përgjakur, u ndamë duke e falenderuar për dhuratën e çmuar dhe uruar Motmotin e Ri 2024. Duket që nga libri i tij i parë, "Arvanitët", botuar në vitin 1993, deri te "Alipashaida", pra trembëdhjetë gjithësej, tetë prej tyre i kushtohen Ali Pashë Tepelenës. Dhe kjo nuk është rastësi, sepse sipas

Prof. Dr. Irakli Koçollari, tepelenasi "Është reformatori i madh dhe kurajoz. Ato u shtrinë jo vetëm në rrafshin ekonomik dhe politik, por edhe atë ushtarak, urban, infrastrukturor, arsimor, kulturor e më gjerë".

Këtë mendoja, ndërsa ecja në trotuarin e majtë të Unazës, për t'u kthyer në shtëpinë time te "Parku". Pastaj ngadalsova hapat duke parë librin. Herë-herë qëndroja në këmbë dhe shihja jo vetëm gravurën, por lexoja edhe vargje të "Alipashaidës", emra vendesh, luftëtarësh nga vise të ndryshme të Shqipërisë, Epirit tim, Labërisë, Gegërisë. . . Ishte një mesditë e shtune, si gjithë të tjerat, me një diell disi të verbër. Me siguri qëndrimet e mia të gjata në trotuar, duke shfletuar librin, u ka bërë përshtypje kalimtarëve të shumtë, që nxitonin disi në ankth, në pritje të natës së Motmotit të Ri. Ndoshta ndonjeri prej tyre më ka quajtur tuaf, ose të marrë dhe nëse do ndalej për të më pyetur se çfarë lexoja dhe a nuk kisha vend tjetër për të lexuar, do t'i përgjigjesha: "Po lexoj Alipashaidën" e Haxhi Shehretit. Dhe a e di se kush e gjeti dhe ua solli shqiptarëve këtë zog të mahnitshëm, shqipëruar mrekullisht bukur? Është Irakli Koçollari. Metaforën "Zog i mahnitshëm" e ka thënë Dritëto Agolli shumë vite më parë. Lexojeni këtë libër. Mos u merrni natë e ditë me celularë ose të shihni ca programe të shpëlarë në TV shqiptare . . . "Pastaj me mirësjellje do t'i uroja Motmotin e Ri dhe se të më falni, por kinse jam në Tiranë, por ky libër më ka çuar qindra kilometra në Jugun tim. Poetët janë si magjistarët ose mistikët e mëdhenj që të çojnë në hapësira të tjera gjeografike dhe kohore. Kam kapërcyer nëntë male dhe nëntë lumenj dhe më janë hapur portat e Epirit, Çamërisë time. Tani jam në Janinë përballë sarajeve të Ali Pashë Tepelenës dhe dëgjoj të qeshurën si bubullimat e maleve të Tepelenës dhe në dritare shoh çamen e bukur nga Pleshavica. Është e bukur si Helena e Homerit dhe Pashai e donte marrëzish nusen shumë të re se ai. Nuk e sheh që jam në shoqërinë e poetit Haxhi Shehretit dhe Irakli Koçollari?

2

"Alipashaida"- kronikë e një lindje të përgjakur", është një libër me peshë të rëndë, jo në kuptimin që ka fjala "peshë" si rëndimi i një trupi në krahasim me të tjerë, që matet me një njesi të caktuar ose sa rëndon një trup a një send. Libri nuk ka njësi matëse gramim, kilogramin. Ai ka njësi tjetër matëse, që lidhet me vlerat shkencore, estetike, emocionet që përcjell te lexuesi ose mikrobotën dhe botën shpirtërore, ndjenjën që të mbërthen, teksa shfleton faqet e librit. Borgesi, një nga mëndjet e ndritura të njerëzimit, librin e quan si zgjatim të kujtesës dhe imagjinatës. Gjithashtu Borgesi, duke cituar Emersonin, shkruan se "Biblioteka është një lloj kabineti magjik". Ai shton se "duhet të hapim librin që shpirtrat të rizgjojnë".

Sa më lart, përse libri i Prof. Irakli Koçollari ka "peshë të rëndë" dhe si vjen në këtë libër kujtesa shqiptare e kohës së Ali Pashë Tepelenës në të? Si e rizgjon poeti i madh i letrave shqipe Haxhi Sheriati nga Delvina, shpirtrat e asaj periudhe?

Jam i bindur që "peshën" këtij libri ja jep autori i tij, Prof. Irakli Koçollari. Ai dhe vetëm ai, falë në radhë të parë kulturës së gjerë, njohjes shumë të mirë të historisë dhe kulturës shqiptare, autorëve të huaj

"ALIPASHAIDA" E IRAKLI KOÇOLLARIT, NJË LIBËR I RRALLË

Nga Enver Kushi


ballkanas, europianë e më gjerë që kanë shkruar për këtë kulturë dhe histori e veçmas për Ali Peshë Tepelenën, Epirin etj. por mbi të gjitha njohjes së gjuhës greke, shfrytëzimit të botimeve të studiuesve seriozë grekë, kërkimeve këmbëngulëse në arkivat e fqinjit tonë jugor, e bëjnë "Alipashaidën" një nga botimet më shkencore e kulturore. Do të shtoja këtu edhe pasionin dhe dashurin e tij për Shqipërinë, historinë dhe kulturën e saj nga më të bukurat dhe befasueset në Ballkan e më gjerë, si dhe punën, vetëm punën e palodhur të tij. Me të drejtë Dritëro Agolli ka shkruar se "shqipërimi i vyer i Irakli Koçollari është edhe një akt patriotik. Në kohën e Bajronit kur shkruhej "Çajld Haroldi", ishte shkruar edhe "Alipashaida". Kështu që pylli i poezisë shqipe është pyll i lashtë dhe na bën të mburremi. Dhe këtë mburrje e kemi falë edhe Irakli Koçollari, këtij burri të talentuar, stoik, të kulturuar me vetitë e një intelektualit të vërtetë dhe me ndjenjën e lartë të patriotizmit".

Ky botim është më i plotë se ai i vitit 1978, por edhe më cilësor si paraqitje falë kujdesit të Bujar Hudhrit, drejtuesit të Shtëpisë Botuese "Onufri". Autori, sipas Prof. Dr. Shaban Sinani "duke i shtuar lexuesit informacionin për pjesë të panjohura për pashain e bëmave dhe gjemave të lavdishme e tronditëse, si dorëshkrimi i vajeve për Ali Tepelenën, me gjasë autor Shehretin, dhe

ajo histori anonim për Sulin dhe Pargën (anonime se ashtu desh vetë autori, jo se dikush ia fshihur emrin). . . Ky është një libër për studiues dhe dashamirës të dijes, për historianë e filologë, për poetë e përkthyes".

Mendoj se pjesa e parë e librit "Arbëria, trashigimia e saj kulturore dhe identiteti nëpër shekujt", që i paraprinë "WILLIAM LEAK: "Biografia e Ali Pashës", "Haxhi Shehreti në fondin e dokumenteve të "Arkivit të Ali Pashës", "Dy fjalë për poemën "Ali Pashaida", për të ardhur më pas te poema "Alipashaida", që siç shkruan Koçollari "Me përmasat e saj të pazakonta, çuditërisht, për gati dy shekuj, e vjetër dhe e heshtur, vazhdon të pulsojë ende pasuri", si dhe "Rapsodi të tjera të poemës "Ali Pashaida" botuar nga Kostandin Satha". "Pjesë të tjera të poemës "Ali Pashaida"-në botimin e Spiro Aravantinoit" etj. është nga studimet serioze për historinë e kulturës dhe letërsisë shqipe, në të gjitha hapësirat e botës shqiptare.

Ky studim i thellë, mbështetur në botime, autorë vendas e të huaj, na sjell botën shqiptare dhe Pashallëkun e Janinës në shekujt XVIII-XIX, vetëdijen Kombëtare dhe trashëgiminë kulturore tek shqiptarët, sfidat e Ali Pashait drejt progresit dhe investimit e tij në dije, kulturë, arsim, erën e iluminizimit në Pashallëk. Prof. Irakli Koçollari jo pa qëllim ndalet gjatë në krijimtarinë letrare



në Pashallëkun e Janinës. Ai nënvizon faktin se "trashëgimia kulturore në tërësi dhe ajo folklorike e popullsisë shqiptare, veçmas në periudhën e sundimit të Ali Pashës, mori përmasa të reja, ndoshta të papara me dekadat apo shekujt e mëparshëm. Edhe sot, është mjaft i dukshëm fondi i madh dhe larmija e krijimtarisë popullore e asaj epoke". Pikërisht në këtë atmosferë dhe në atë hapërisë gjeografike që nga Delvina, Çamëria dhe Janina, lindi "Alipashaida" dhe autori i saj Haxhi Shehreti që ishte këshilltar politik dhe konfident i Ali Pashës, ministri më i besuar i tij dhe një nga njerzit më të ditur e të kulturuar të kohës. Në studimin e tij për krijimtarinë letrare të Pashallëkut të Janinës, Koçollari shtron disa pyetje: Kush është ky krijues? Cila qe bota e tij dhe kush e yshti apo frymëzoi drejt një krijimi të tillë? Kush qe formimi i tij, të njohurit dhe të afërmit? Cilat ishin raportet e tij me Pashain tepelenas? Cila ishte karriera e tij krijuese? Dhe këtyre pyetjeve, ai u përgjigjet me argumente bindëse dhe shkencore, mbështetur, siç nënvizua më lart në dokumente arkivore, autorë të huaj veçanërisht atyre grekë, etj. për Haxhi Shehretin, poemën e tij prej 10.000 vargësh.

Mendoj se është me interes të ndalem edhe në një tezë të studimit të Irakli Koçollari: Folklori shqiptar dhe folklori grek i epokës së Ali Pashës, ku me të drejtë analizon vlerën e mijëra krijimeve poetike popullore shqiptare që rrokin hapësirat epika të trojeve tona, veçanërisht në Epir, por edhe në hapësira të tjera arbënore, si dhe krijimtarinë folklorike dhe këngët popullore greke të kësaj kohe që i dedikohen Ali Pashës, komitëve shqiptarë dhe grekë, suljotëve, ngjarjeve dhe konflikteve që përfshinë pashallëkun nën vezirin zulmëmadrh, flasin për Beratin, Kardhiqin, Gjirokastrën, Janinën, Pargën, Sulin, Prevezën etj. Këto ditë ndërsa lexoja poemën "Alipashaida" ose i rikthehesha për të satën herë asaj, ju riktheva një botim të rrallë "Mbledhës të hershëm të folklorit" (1635-1912), përgatitur nga Instituti i Folklorit, Tiranë 1961. Është një libër shumë i vyer, ku përfshihet "Bleta shqiptare", mbledhur e botuar nga Thimi Mitko, "Dorëshkrimi i Pragës", me tekste që janë gjetur në Pragë, në arkivin e filologut çek, profesor Jan Urban Jasnikut. Mitkua i pat përgatitur këto për t'i botuar në një vëllim të veçantë. Në tekstin sqarues të botimit të këtij dorëshkrimi, shkruhet se Mitkua i pat përgatitur këto për t'i botuar në një vëllim të veçantë. Editori vinez Veckenstedt, të cilit i qe drejtuar Mitkua, ja përcolli një pjesë të dorëshkrimit Jarnikut që njihej atëhere si një nga specialistët më të mirë të gjuhës shqipe... Vdekja e bënë të pamundur botimin e këtyre teksteve, që mbetën s'prej asaj kohe në bibliotekën e Jarnikut. I lexova këto tekste, e veçanërisht këngët e vajit dhe ato historike, që sjellin deri në ditët tona kohërat dhe atmosferën ose shtratin ku lëvizin figurat historike të poemës "Alipashaida". Ju riktheva edhe eposit të Çamërisë, kujtesës çame, asaj që Kadareja ynë i madh në parathënieën e vëllimit "Këngë popullore nga Çamëria" (1983), përgatitur nga Fatos Mero Rrapaj, shkruan: "Në këtë vepër përpara lexuesit tonë vizatohet e plotë fuqia kolektive e një popullsie heroike, të talentuar, jashtëzakonisht vitale, të zgjuar, aktive, plot kolorit".

Unë, pasardhës i fisit tim me rrënjë nga Suli dhe vendosur më pas në Spatar pranë Filatit, ndoshta ndryshe nga shumë lexues të tjerë të "Alipashaidës", forca magjike dhe

(Vijon në faqen 7)

Historiani i letërsisë dhe studiuesi Ali Xhiku ka botuar së fundmi veprën *Një pasqyrë e Shqipërisë letrare 1945–1961* (Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2022), vijim i profilit historik të letërsisë së traditës deri më 1944, *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe 1555–1944* (Albas, 2014), që vjen si ripunim me plotësime i studimit *Letërsia shqipe si polifoni* (Dituria, Tiranë, 2004), duke përbushur kështu projektin e tij historiografik, i vetmi deri tani që synon plotësimin e ambicies së krijimit të një historie të plotë të letërsisë shqipe në këndvështrim mbinacional.

Kjo vepër e re e profesor A. Xhikut, veç vështirësisë së qasjes së objektit letrar të gjysmës së dytë të shekullit XX, siç dihet i karakterizuar nga vizioni “ahistorik” i botës (Erich Auerbach) mbart vështirësitë e dinamikave të artit të realizmit socialist, në funksion tautologjik të riprodhimit të ideologjisë për artin, siç shprehet vetë studiuesi, “duke u nisur prej vetes e duke mbetur po aty”.

Megjithëse përballë dy realitetesh me “sfond historik të ndryshëm”, qasja historiko-letrare e A. Xhikut, bart në vetvete edhe gjykimin për fazën pararendëse, letërsinë e traditës, objekti letrar i vështimit historiko-letrar *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe (1555–1944)*, që përbën objektin e parë të vlerësimit kritik për metodën e përdorur prej tij.

Modestia e qasjes ndaj lexuesit, e përcjellë nëpërmjet emërtimit “sprovë”, që bart thelbin e ndërgjegjes kritike për krizat e gjeneruara nga metoda e qasjes komparativiste, nuk e pengon lexuesin e specializuar të vërejtë se autori e bën të tijën atë krizë, duke e përshkuar e tejkaluar në emër të transmetimit, interpretimit të letërsisë shqipe nëpërmjet një qasjeje mbinacionale si forma më e natyrshme e studimit të letërsisë.

Një përcaktim i prerjes metodologjike-kritike në këtë vepër, mund të përmblihet në parimin se poetika e tij komparativiste është pasojë e një përpunimi të vazhdueshëm të qëndrimit materialist për botën.


Në këndvështrimin e Xhikut, letërsia, në komunikim, krijon vizionin mbi botën (Weltanschauung), “me të cilin e gjithë jeta shpirtërore e një periudhe historike ngjizte unitete (njëjtësi) të dallueshme në pafundësinë e pashmangshme të diversiteteve (ndryshimeve) që e karakterizonin” (f. 7).

Ndonëse studimet kritiko-letrare të këtyre dhjetë vjetëve të fundit dëshmojnë për kontakt të studiuesve me teorinë krahasimtare bashkëkohore, mungon një paraqitje sistematike e kësaj fushe studimi, që

Pjesa e parë: Vështrimi alternativ i historisë së letërsisë në qasjen krahasimtare të Ali Xhikut: *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe (1555–1944)*

Për një poetikë krahasimtare në studimet shqipe: perspektiva historiko-letrare e Ali Xhikut

nga Blerina Suta



është, para së gjithash, një metodë qëndrimi dhe këndvështrimi ndaj letërsisë më shumë sesa një enëmbajtëse mjetesh konkrete për operim me tekstin letrar.

Metoda krahasimtare e veprës *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe (1555–1944)*, i jep konceptimit të historisë së letërsisë atë natyrë dinamike e atë prurje të rëndësishme që mund t’ia japë vetëm histori e gjinive, prerje që mëton, siç thotë autori ta shkëpusë letërsinë shqipe nga “izolacionizmi i pakuptimtë”.

Ideja e autorit se vizioni për letërsinë është ngjizur nga një këndvështrim unik mbi botën, rindërtohet qartësisht sidomos kur bën fjalë për letërsinë e prodhuar gjatë romantizmit dhe fillimit të modernizmit, periudhë-rrymë homogjene, kur kultivohej një profil unik i idesë mbi botën.

Për periudhën e romantizmit, letërsia shqipe ofron, me profilet e saj letrare, në kuadër të rrjetit ndërletrar të Mesdheut, gjeometri të ndryshme të kontakteve me kulturat e tjera, të kushtëzuara nga bashkëjetesa në të njëjtat komunitete administrative specifike, siç është rasti i perandorive të mëdha në fazën para krijimit të shteteve kombëtare.

Përkthyes në shqip i veprës më klasike për qasjen krahasimtare në studimin e letërsisë, *Letërsia e krahasuar* (Albin, 2002), (botuar më 1989-n nga komparatisti i shquar francez Yves Chevrel), profesor Xhiku e konsideron, pikërisht si Chevrel-i, historinë e letërsisë, objektin kryesor të komparativistit, kur pohon, se “me vështrimet e tyre të shtrira në kohë dhe në hapësirë, studimet krahasuese kanë treguar se si takimet me tjetrin dhe ndikimet e lindura që këtej, i hapin rrugë rrymave të mëdha për të shkuar tej një letërsie e për të krijuar vizione artistike mbikombëtare”.

Komunikimin me tjetrin, studiuesi e sheh si nevojë të lindur të letërsisë vetë, duke hulumtuar një poetikë komparativiste nga shekujt XVI–XVII, periudhë kur *letërsia shqipe vjen si jehonë e humanizmit kristian; Prurjeve lindore dhe poezisë së mjedisëve myslimane; Lëvizjes kulturore-letrare ortodokse; që bartet gjatë Romantizmit me poezinë dhe poezinë epiko-lirike, lirikën, epikën, dramën; duke vijuar gjysmën e parë të shekullit XX me Fillimet e shpërbërjes së romantizmit dhe ardhjen e një letërsie tjetër; me kultivimin e lirikës (politiko-shoqërore; shoqërore; të mendimit; të dashurisë; të natyrës; erotike); si dhe në trajtimin e çështjeve të raporteve të poetit dhe poezisë, sa dhe hetimin e gjinive përndjekur në hulli të rrymës apo lëvizjes, si: epika, poema dramatike, satirika, proza (novela, tregimi, proza e shkurtër, romani); drama – të gjitha këta*

kapituj e çështje kyçe në përbërje të studimit.

Karakteri *dinamiko-metodologjik* i metodës komparativiste përfutur në sprovën historiko-letrare si arsytim i takimit me *tjetrin*, si përfaqje mes koncepteve: *letërsi e krahasuar*, *letërsi e përgjithshme*, *e huaj*, *kombëtare*, *përkthim* (si mjet i pafund takimesh me një vepër, thënë ndryshe, me një kulturë), imponon një filtrim përkatës për realitete si ai shqiptar, sa europiane aq dhe ballkanike.

Një ndërmarrje e tillë historiko-letrare, nëpërmjet gjinive, e vendos autorin në një sprovë me disa dimensione që kanë të bëjnë me natyrën asnjëherë statike të gjinisë: vepra në këndvështrim të zhvillimit të gjinisë; gjinia dhe çështja e kanonit; vepra në këndvështrim të zhvillimit të personalitetit krijues të autorit; vepra në këndvështrim të studimit të temave dhe funksioni i tyre në historinë e gjinisë (në realitetin tonë kishte kuptim të flitej për lirike atdhetare etj.).

A është e mundur një histori e letërsisë shqipe përmes gjinive? Vepra e profesor A. Xhikut është, ndoshta, e vetmja histori e letërsisë shqipe deri më sot që synon të gjejë në zhvillimin e secilës prej gjinive tiparet që dëshmojnë se vepra asnjëherë nuk përputhet me tiparet e gjinisë, se te thyerja qëndron legjitimiteti i veprës, se një sërë veprash të letërsisë shqipe shfaqin ‘problematika’ në inkuadrimit të tyre brenda një gjinie të vetme dhe se letërsia shqipe e traditës është bartëse e gjinive, që sendërtojnë kuptime të ndryshme në epokë të ndryshme.

Nuk ka dyshim se studimi historiko-letrar nëpërmjet gjinive shfaqet si perspektivë komplekse e historisë sociale-alternative ndaj eseistikës letrare të tipit monografik, si urë lidhëse mes historisë së mendimit, formave e poetikave; gjinia si e tillë ndërlihd historinë e intelektualëve që propozon historia tradicionale e letërsisë me temat dhe format letrare. Qasje të tilla kanë privilegjin të zgjerojnë perspektivën e vazhdimësisë mbi kategori ngushtësisht filologjike ku të çojnë studimet binare.

Historiani i letërsisë Ali Xhiku është i bindur se vizioni mbinacional mund ta ruajë të paprekur prurjen e letërsisë shqipe në “detin e rrymave gjithëpërfshirëse europiane”. Teksa arsyeton për letërsinë kombëtare, ai ka parasysh parametrat dhe konkluzionet që Shoqata Ndërkombëtare e Letërsisë së Krahasuar ka parashtruar në programin e *Historisë së krahasuar të letërsisë të gjuhëve evropiane*, modeli metodologjik që duhej të drejtonte ekipet e studiuesve në punën për krijimin e historisë së letërsisë shqipe.

DOM NDRE ZADEJA DHE MELODRAMA “ROZAFJA”, 87 VJET MË PARË...

nga Xhahid Bushati

Autorët shkodoranë, në krijimtarinë e tyre, në kohë dhe në hapësirë (edhe pse Koha e Legjendës është shekuj larg...) i janë kthyer historisë së Rozafës, ku legjenda kthehet në kala dhe kalaja kthehet në legjendë; për ta përjetësuar: kush në poezi, kush në tregim, kush në poemë, kush në dramë, kush në roman, kush në letërsi për fëmijë... etj. Ndërsa Dom Ndre Zadeja, me artin e tij të magjishëm, e ka përjetësuar këtë figurë sa legjendare aq dhe mitike në melodramën e tij me tre akte, të titulluar “Rozafa”.

Nga revistat e kohës, të cilat në faqet e tyre bënë shkrime për këtë Melodramë, mësojmë se, “Rozafa” u shfaq në Shkodër, më 26 prill 1936 nga “Schola Cantorum” të Kathedrales, në nder të dy Shkëlqesive: Imzot Thaçi (Argjipeshkev Metropolit i Shkodrës) e Imzot Prennushi (Ispeshkev i Sapës). Shfaqja u përsërit edhe me 3 e 10 maj. Pati sukses në popull e tek kritika letrare, ndërsa “... shtypi i ynë heshti fare”. Theksojmë se “Cirka” (në numrin e saj të parë) dhe “Gazeta Shqipëtare” e Barit i bënë jehonë kësaj Melodrame. Kurse “Kumbona e së Dielles”, në parathënien e veprës, mes të tjerave thotë: “Na e kemi qitë ceken me i botue të gjitha punimet poetike të Zadejës. Vepra e tij pergjithsisht nuk asht e njoftun. Ky botim e të tjerat qi kanë me ndjekë, padyshim kanë me interesue boten letrare tonë, qi ka me pá se Zadeja xën një vend të veçantë, e jo nder të mbrëmët, në letersin shqiptare.”

Po i rikujtojmë dhe po i përmendim me respekt emrat e interpretuesve të shfaqjes së parë: - Rozafa - Loro Bytyçi; Afrodizi, i shoqi - Nikollë Çuni; - Miri, Frisku, vëllezërit e Afrodizit - Tefë Gjonej, Gjon Kujxhija; - Petriti, kryefetar ilir - Joz Jakova; - Orfeu, këngëtar ilir - Pjetër Gjoka; - Kunata I - Ndoc Jakova; Kunata II - Kolë Naraçi; - Shtriga - Cin Lufi; - Murtati, sundues i territ - Gac Luli. (Taraboshi, vulkan; Shkerbë; hije; fëmij shkodoranë e paranikë ilirë.

-Nga artikulli kritik mbi melodramën “Rozafa”, publikuar në “Gazeta Shqipëtare”

Citojmë: “Kjo shfaqje melodramatike u ba nen drejtimin e D. Mikel Koliqit prej kangëtorvet të “Schola Cantorum” e Kathedrales.

Perpara se me fillue shfaqja e melodramit Kombëtar Auktori mbajti një parathanje ku pershkoi kohët e bukra Illirjane dhe kulturen e të parvet t'onë e se si të huji na i kan marrë né shum e shum legenda e ba per vedi. [... ..] Akti parë i dam në tri pjesë, e dy aktet tjera u zhvilluen rreth legendet gershetuem me një fantazi të mrekullueshme prej auktorit, ... [... ..] Akti sublim i Rozafes dhe trathtija e vllazenvet bane një pershtypje të thellë në zemrat e spektatorvet. Sa e sa herë asht duertrokitë vepra nuk asht punë qi mbahet mend vetun duhet dijte se në mbarim u kerkue me insistencë dalja në palk e auktorit me duertrokitje dhe brohori frenetike.”

-Nga artikulli kritik mbi melodramën “Rozafa” i titulluar: “Shfaqja e një Melodramit Kombëtar”, publikuar nga “Cirka”

Citojmë: [... ..] “Në na intereson e na gzon në mëndyrë të pá mäsë fakti se letrari i ynë D. Zadeja, mbas kaq vjet heshtimi, po nisë me mårre persi aktivitetin e vet aq të çmueshem, aktivitet qi, si patme nderen m'e ndi prej goje s'auktorit vetë, ká m'e vijue mbrënda një kohe së shkurtë edhë me melodrama tjerë me permbajtje kombëtare. [... ..] Na pikon zëmra gjak kah ndijmë se si sod rinija e jonë ushqehet e defrehet me kángë e melodina të hueja ase të vjedhuna e të kopjueme prej s'huejsh. Neper rruga, neper shpija, nder oborre, kù deri dje ushtojshin kángët e vallet t'ona kombëtare, s'ndihet tjetër, por “canzonette” në daç italiane, në daç greke o sllave, por jo shqyptare. Na pikon zëmra gjak kah mëndojmë se deri shumica e melodive të kángëve t'ona atdhetare, qi má parë se kurrjá tjetër kishte m'u dasht t'ishin shprehja fjesht shqyptare e ahteve të zëmrave t'ona.”

Tek melodrama “Rozafa”, këndvështrimi i autorit është i tillë: Legjenda vë përballë aktin sublim me tradhtinë, dashurinë për



atdhe me atë prindërore, forcat e dritës: Rozafa, Afrodizi, Petriti, Orfeu me ato të errësirës: Kunatat, shtrigat, Murtatin, Shkerbeun e hijet e vëllezërve besëthyer. Melodramat e Zadejës merrnin jetë nga muzika e hartuar prej Dom Mikel Koliqit. Partiturat e tri melodramave “Rozafa”, “Rrethimi i Shkodrës” dhe “Ruba e Kuqe” të ruajtura me dashuri prej Koliqit, disa vite më vonë, u përpunuan me mjeshtëri nga kompozitori Tonin Harapi.

Figura e Dom Ndre Zadejës, veçanërisht krijimtaria letrare, ende, është e panjohur në plotësinë e saj, ende e pastudiuar. Për Dom Ndreun është botuar: “Dom Ndre Zadeja - Veprat -1-, përgatitur prej Lec Zadejës. (Botues: “Lisitan”, Lezhë, 1994. Një botim, me një përgatitje fotografike dhe grafike, inkurajuese).

Në jetën e aktivitetin e tij artistik, Dom Ndre Zadeja, përmes kulturës së tij, na la një krijimtari (për aq sa e njohim deri tani) që ndrit si një gur i çmuar. Pasuria e tij letraromuzikore e publistike shtrihet në një kohësi prej 4 dekadash. Kjo periudhë përkon me një jetë kulturore, artistike e shkencore të gjallërueshme në Shkodër. Mjafton të kujtojmë që kishte mbi 10 shtypshkronja. Është për t'u theksuar, se në këtë kohë personaliteti i Fishtës ishte rrezatues. Por, një fenomen i tillë fishtjan, nuk mund të ekzistonte pa krijues të tjerë. E njëri nga ato ishte dhe Dom Ndre Zadeja. Ishte poet, dhe shkëlqeu me poezitë “Muzhika” dhe “Piktura”. Mendoj se në poezinë lirike elegjiake Zadeja arriti kulmin artistik. Ndrin poema liriko-filozofike “Kunora e bylbylave”, ku motivi romantik mbart edhe filozofi jete. Ishte prozator. Mbartin vlera shkrimet e tij publicistike-pedagogjike. Së bashku me Fishtën ka meritën se kontribuoi me sukses në gjininë e dramatikës, në llojin e melodramës. Të pjesshme apo të plota në shfaqjet skenike, me emrin e Zadejës lidhen melodramat: Ora e Shqypnisë”, “Hijet e Zeza”, “Ruba e Kuqe”, “Rrethimi i Shkodrës”, “Shpella e Bogdanit” (ende e pagjetur).

Kush ishte Ndre Zadeja? Lindi në Shkodër, më 03.11.1891. Më 25.03.1945, vet i 14-ti ekzekutohet nga komunistët me pa të drejtë, diku mbas varreve të Rrmajit. Ekzekutohet “Poeti i Amëlsisë”. Vdiq në moshën 54-vjeçare. Ishte 45-vjeç, ku u shfaq melodrama “Rozafa”; pa folur për melodramat e tjera e për dorëshkrimet e gjetura dhe, ende, të pagjetura.

Dom Ndre Zadeja la një opus shkrimor të gjerë, ku janë përballë njëra-tjetrës: e njohura dhe e panjohura. Në dy shkrimet (analizat) që u bënë për melodramën “Rozafa” gjejmë të përbashkët këto dukuri të rëndësishme, analitike, mirëdashëse e mirënjohëse: - Kohën e jetoi si meshtar e si artist. - Gjurmët vlerore duhet t'i kërkojmë e t'i zbulojmë e më pas t'i analizojmë. - Tek artisti, për kontributet e tij nuk duhet të ketë “heshtim” (fjalë që e përmend njëri nga artikullshkruesit).

Dom Ndre Zadeja duhet të njihet, sepse më shumë njihet trashëgimia e pasur shkodorane dhe panteoni i kulturës shqiptare. Ndre Zadeja ishte poeti i dritës që mund errësirën. Për këtë thënie mjafton të lexoni melodramën “Rozafa”.

Shkodër, më, 22. 12. 2023



Qamil Buxheli ka qëndruar përherë ëmbël në kujtesën time. Ndofta se rrënjën e kishte nga fshati Pandalejmon, pra nga Saranda prej ku edhe unë isha. Por nuk ishte aspak kjo kryesorja. Kjo ishte, le ta quaja, "aroma" që krijonte tek unë prania e tij duke e rritur simpatinë time për të. Kur e kisha parë për herë të parë, teksa shkoja në revistën "Ylli" në vitin 1971, ku Qamili ishte kryeredaktor, më pat mbetur në mendje buzëqeshja e tij e veçantë, e hapur, ato dy pullat në faqe që i jepnin hir. Seç kishte diçka si një nuancë ironie për gjithçka e për gjithkë, gjer dhe për veten, ky Qamili ynë. Sytë përherë i ndrisnin. Humori buiste aty. Fliste butë, ëmbël, dhe ëmbël... I dorëzova një shkrim timin për një komedi, në mos gaboj e Molierit, dhe mrekullisht ai e botoi që atë numër. Si s'dudentë e rishtar i kritikë që isha asoherë, ai më dha një palë krahë si të Ikariut dhe më tha: "Fluturo, o djalë, dhe ti në qiellin e bukur të letërsisë!" Më pas më botoi edhe dy artikuj të tjerë. Qamili e dinte se unë ishte nga Saranda. M'u prezantua se edhe vetë ishte nga Saranda, nga fshatrat e buta e me portokalle të Çamërisë. Kur e pash më vonë Pandalejmonin e tij, atë fshat të vogël kredhur në gjelbërim ullinjsh, me shtëpitë dykatëshe të pastra, me oborret, rrugicat, pemët frutore, më pat lënë një përshtypje të veçantë. S'di përse atë fshat të vogël e përtshyeja në mendjen time vetëm me Qamil Buxhelin. Më shumë mbase me urtësinë e tij dhe atë mirësi që i buronte syve të qeshur, të butë, të butë... dhe prapë të butë.

Paçka se Qamil Buxheli ishte një personalitet i letërsisë shqipe, me të isha ndërjerë përherë mirë. Vetvetja. Ky shkrimtar i shquar nuk e donte "autoritetin". Satirist i guximshëm, i rrallë në sojin e vet, tejet sqimatar ndaj fjalës dhe artit, aq i butë sa dukej së jashtmi, aq trim ishte në gjithë letërsinë e tij: tregimet, monologjet, romanet, publicistikën. Sidomos m'u bë i dashur dhe i afërt, kur në provimin e "Fjalës artistike" në Institutin e Lartë të Aeteve zgjodha si student të interpretoja pikërisht një nga tregimet e tij, "A doni më për Belulin", nxjerrë nga vëllimi me tregime "Faraonë dhe firaunë", botuar më 1969. Kaq shumë u shfrytëzuan tregimet e këtij libri nga ne, studentët e aktrimit të asaj kohe, sa rrallë ndonjë libër ishte pëlqyer aq. Mjaft prej tyre ishin përshtatur sakaq për skenë dhe me kohë ato u luajtën gjerazi në teatrot e estradave shqiptare si: *A doni më për Belulin*, *Ndodhi në plazh*, *Faraonë e Firaunë*, *E ëma e Zeqos*, *Kameleoni*, *Lum është Lana* etj. Qamili kishte hir e sqimë në të shkruar. Ndihej kudo kultura, leksiku, cilësia. Ndonëse e kisha lexuar vonë romanin e tij të parë "Kali i mbretit dhe kalorës të rinj", botuar në vitin 1960, pasi asaj kohe ishte i ndaluar, e kisha përpirë. E kam ende në kokë atë uverturë trimërie dhe atë aventurë njerëzish që digjeshin për vendin dhe lirinë e tij. Qysh aty u ndje një shkëputje e letërsisë së tij nga ajo që zakonisht bëhej gjithandej. Ishte i shkolluar në Institutin e Letërsisë "Maksim Gorki" në Moskë, nuk qe pak.

Qamili e bartte mbi shpinë vendlindjen e tij, fëmijërinë e kaluar në Pandalejmon, dy vitet në shkollën fillore në Markat dhe tre vitet e tjerë në Sarandë. Gjimnazin e mbaroi në Gjirokastër. Pastaj erdhën kohërat e vështira të Luftës dhe ai mori pjesë me armë në dorë, u zgjodh madje në forumet e rinisë antifashiste, komisar i një njësi partizan dhe në luftën e Mezhgoranit shkroi vargjet e njohura mbi vdekjen e Asim Zenelit, e cila u muzikua dhe u këndua nga basi i mrekullueshëm shqiptar Mentor Xhemali (*Një zë po del nga gryka e Mezhgoranit...*). Edhe pse u zgjodh në forumet e larta të Rinisë, karrierën e tij politike ia ndërprente mediokrit, dinakët, të pabesët dhe të dhunshmit. Mbase arsyeja kryesore ishte shpirti i tij i hapur, dituria, kultura, leximet, çka përfaqësonin një rrezik për kastën e lartë politike të vendit, e kredhur në egërsi, urrejtje dhe më pas në padituri proverbiale. Por them se pati fat që

Në 100 vjetorin e lindjes

Qamil Buxheli – më e bukura mendje e humorit

Nga Josif Papagjoni

nuk e vijoi atë karrierë. Mendhapja e tij do të mbyllej si në një pus vetmie dhe stresi, ndërsa lexuesi do të humbte një nga penat e arta të letërsisë që sfidonte kohën dhe kodet e saj të hekurta. Do të ishte harruar dhe sot askush, as unë e shumë të tjerë, nuk do të kishim dëshirë të shkruanim me qejf diçka për të, domethënë për letërsinë e tij prej "klasi".

Inteligjent siç ishte, krahas si gazetar, kryeredaktor i gazetës *Rinia*, redaktor i *Zërit të Popullit*, kryeredaktor i revistës *Ylli*, Qamil Buxheli e pati shpirtin e vet përherë te letërsia, më së shumti ajo humoristike. Pse mos ta themi që ishte më cilësori dhe më i epërmi i kësaj letërsie. Pëllumb Kulla në një nga shkrimet e tij për Qamilin, edhe pse vetë është nga lëvruetit më të talentuar e më të begatë të saj, e çmon atë si "shkrimtarin më të shquar në gjininë e humorit në letrat shqipe... një vëzhgues i mprehtë, gjahtar i thekur i pjesës qesharake të jetës shqiptare, që ai e shquante më shpejt e na ftonte të hidhnim vështrimin tonë mbi të... qe ai që shtroi shinat e para të një traseje të gjatë, të një humorit të paparë ndonjëherë: aq dinamik, aq i zhërvjelltë, aq i tejshprehur, modern dhe thellësisht popullor".

Ajo çfarë e mbresonte njeriun në letërsinë që Qamili bënte ishte shpirti i tij i lirë, fluturak, ajo ironi e sarkazëm që ai e derdhte falë një cilësie letrare që binte në sy. Ndihej "qejfi" i të shkruarit të tregimeve dhe romaneve prej tij, ndihet ngarendja, gazmendia, çka dëshmon për atë shkoqitje të vetvetishme të humorit, atë shpengim dhe lirshmëri, atë gjendje hareje brenda vetes/me veten/të tjerët, pa të cilën humorin nuk bëhet dot. Më tutje ti shquan atë cirk ngjarjesh e kundërtish komike që i bashkangjitet asaj trumbe karakteresh, ca tallës e ca të tallur, ca të gjymtë, të budallallepsur dhe ca mendjemprehtë, leqendisës, të cilat e bëjnë lexuesin që të ndjehet rehat me veten teksa shfleton veprat e tij. Mbaj mend se kur kam lexuar librin e tij me tregime "Një ndodhi në plazh" qeshja me vete rrugëse si budalla, kaq të forta ishin mbresat e ndodhive dhe personazheve të tij në atë plazh ku shkonin mijëra vetë,

të veshur e të zhveshur (sigurisht plazhi i Durrësit). Një galeri e vërtetë karakteresh, ku humorin lëvizte aq bukur në shpengimin e vet, te fjalët dhe dialogët humoristikë, te situatat e krijuara, me njerëz nopranë e të çuditshëm, snobë dhe të paditur, zyrtarë me huqe e katundarë me një thes turpesh e paragjykimesh. I gjithë ky vëllim ka në thep të hostenit një shoqëri dhe një Shqipëri që ecte jo pa vështirësi në rrugën e kulturimit të saj, një Shqipëri ende e vjetër, ende fshatarake, ende nën trysinë e normave mesjetare të trashëgueshme.

Shteti e shihte shtrembër Qamil Buxhelin dhe pas ndalimit të komedisë "I pazëvendësueshmi" (1973) e dëbuan nga Tirana; për 11 vjet rresht punoi në rrethin e Elbasanit si pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani". Ndonëse i larguar nga kryeqyteti, pas shembjes së diktaturës ai asnjëherë nuk kaloi në qëndrime mburravece, duke i rënë gjoksit për "ndëshkimin", por mbeti një vlerësues objektiv i historisë, i jetës, sa i diktaturës aq dhe deformimeve të demokracisë. Letërsia humoristike rierdhi tek ai në një tjetër optikë estetike.


...Mbaj mend një udhëtim të paharruar nga Tirana në Fier, kur Pëllumb Kulla kishte krijuar një shfaqje gjithë humor me krijimtarinë e tij. Isha i interesuar të dija për veprat e kritikuar të tij dhe biseda rrodhi vetiu. Qamili më shpjegoi se drama *Rrugë të tërthorta* (1966) ishte kritikuar drejtpërdrejt nga Ramiz Alia për gjoja demotivimin e "njeriut socialist" dhe sjelljen e një fryme deheroike, për mungesën e optimizmit të kërkuar, të solidaritetit si dhe dëshirës së rinisë për jetë më të rehatshme larg zonave të vështira etj. Pra ky partiak kërkonte gënjeshtrën, jo të vërtetën që Qamili kishte treguar aty. Po i njëjti fat e kishte ndjekur edhe dramën *Dueli* (1963), e cila e zhvendoste konfliktin nga ballafaqimi fizik e me armë të ballafaqimi shpirtëror midis një partizani dhe një ushtaraku të lartë gjerman, të cilin ai po e dorëzonte si rob luftime në bazën partizane për ta gjykuar. Kur e kisha lexuar këtë dramë në faqet e revistës "Nëntori", përveç letërsisë së shkrifët të saj, më pat mbresuar posaçërisht thyerja e



klishe letrare të socrealizmit bardhë e zi, duke shteguar drejt një forme e strukture dramaturgjike origjinale, që e sfidonte skematizmin e kohës, me një vështrim nga përbrenda njeriut. Shkrimtari kridhej në motivet psikologjike të heroit, luhatjet dhe dilemat e tij të shoqëruara me ngulmin dhe stoicizmin, dhe sillte përplasjen e vullneteve të kundërta midis robit dhe triumfatorit, pushtuesit dhe luftëtarit, sfidës dhe sfiduesit. Më grishte ideja sfiduese se jeta ishte më e shtrenjtë se çdo ideal, sidomos në rrethanat e mbijetesës. Me siguri është elementi a trajtesa e parë e deheroizimit të personazhit në letërsinë shqipe të realizmit socialist.

Më kujtohet fare mirë komedia *I pazëvendësueshmi* (1973), përshtatje e romanit *Kur qesh tërë qyteti* (1970). Shfaqja u dha 7 herë dhe bëri bujë në kryeqytet. Mund të them se e njihja mirë tekstin, e doja dhe qeshja me shpirt. Pata shkruar një artikull në gazetën "Bashkimi" për të me aktorët e mrekullueshëm Kadri Roshi, Sulejman Pitarka, Roland Trebicka, Roza Anagnosti etj., si dhe regjinë e Piro Manit. Theksoja se vepra sillte hapur dhe me guxim realitetin e deformuar e të korrumpuar të kohës së diktaturës, satirën ndaj kultit të individit, fiktivitetit, mbyntjen e nisjativës, konkurrencës dhe frymëmarrjes së lirisë. Këto metaforizohen nën një vështrim grotesk, duke aluduar për atrofizimin e institucioneve të shtetit. Qamili nuk kishte harruar të më falënderonte. I tillë ishte ai: sa një mendje e ndritur e pjellore, aq dhe një njeri i thjeshtë që dinte të respektonte dhe t'i inkurajonte të rinjtë. Në një bisedë që pata bërë me Qamilin vite më pas, të cilën e kam botuar në monografinë time "Poetikë regjisoriale" kushtuar Piro Manit, prej mendimit të tij ndër të tjera dua të veçoj:

"...Do të kesh parasysh Qamil, më tha Pirrua, se ne do të kemi probleme me këtë komedi. Pse, do të më pyesësh ti? Sepse ne themi, gati troç: "Do të bëhesh president se s'ka, or byazer, do s'do ti; dhe po u bëre, ose do të vdesësh president, ose do të likujdohesh". Kishte dy rrugë: e para, që të triumfonte e mira (pra të gjendej një këngëtare e mirë dhe shtëpia e kulturës së rrethit të fitonte



në festival vendin e parë), dhe e dyta që ne s'do kemi një "dolcis in fundo", pra një supertalent, prandaj do të presim Uçin, që ka rënë në letargji, gjersa të zgjohet. Domethënë, nuk shikohet fare mundësia e një zëvendësuesi, e një talenti të ri, veç atij që ishte, të vjetrit, të pazëvendësueshmit. Goditej utopia absurde, e cila shprehej me idenë që Uçi të flinte deri sa të zgjohej në komunizëm?!... Ne mund të paguanim për këtë edhe një "haraç", por boshtin e veprës nuk duhet ta dëmtonim, duhet ta shpëtonim. Dhe unë e dija se cili ishte "haraçi". Këta xhahilë në shtëpinë e Kulturës (pra në shtetin shqiptar të asaj kohe) ishin të mendimit se talente të reja nuk ka dhe s'gjenden, sado të kërkosh tutje-tëhu. Kurse ne, për të futur një element realist, por edhe një nëntekst, thoshnim se talente ka, por ju s'i njihni, s'i shikoni; ose s'doni që t'i njihni dhe t'i shikoni. S'vonoj dhe partiakët e lartë të asaj kohe e pezulluan shfaqjen. Domethënia e saj politike dhe aludimi për udhëheqësit e përjetshëm, "të pazëvendësueshëm", u kap menjëherë. Mua më thirrën në zyrat e larta të partisë e të qeverisë dhe ma thanë troç: "Çdo të thuash ti me fjalët që ke shkruar në komedi se "ka vetëm një diell tek ne, dielli që na rri në kokë tërë ditën dhe ai na mërzhitet ndonjëherë"? Kush na mërzhitet kështu? Armiqtë mërzhiten dhe pëlcastin nga zilia. Dielli ynë është ai, Enver Hoxha. Është dhe do të jetë gjithmonë Ai..."

Sipas meje, Qamil Buxheli mbetet autori më cilësor i humorit, shkrimtari që përdori mjeshtërisht groteskun, hiperbolën, si askush tjetër më parë; ai që e nxori humorin nga bejtet dhe folklori dhe i dha një gjuhë moderne, të kulturuar, të denjë për një letërsi elitare. Ai dinte të përdorte mjeshtërisht situatat me tejzmadhime dhe ndodhi të çuditshme, ku lëvizte absurdja dhe paradoksalja, kalimet në ekstremet e mundshme e qesharake të sjelljes së karaktereve, logjikën e tyre të atrofizuar, ngaherë tejet i kujdesshëm për gjuhën, selitës cilësor dhe i përkushtuar i saj. Në humorin e Qamilit nuk shihje kurrë banalitete, sharje, fjalë të pista. Sa i pastër ishte, sa sqimatar!

Unë i kam lexuar thuajse të gjithë librat e Buxhelit, nja dy syresh shkrimtari m'i ka dhënë me dedikim. E çfarë mos të pëlqej nga krijimtaria e tij? *Një ndodhi në plazh*, tregime humoristike (1962), që shënjuan një cilësi të re në letërsinë tonë, krejt tjetër? Po novela *Komandanti dhe ushtari* (1968), e mbushur me shpoti për njerëzit e budallallepsur e të ndërkrjer. Këtu, madje, ndihet ndikimi i Hashekut me romanin "Ushtari i mirë shvejk", të cilin ai e adhuronte. Te *Stafeta e kuqe* (1969), Qamili stigmatizon me guxim gjithë shtrëmbërimet populiste të kohës. *Karriera e zotit Maksut* ishte një roman satirik gjerësisht i komentuar për kohën, i cili u bë dhe film nën titullin *Historiani dhe kameleonët*. Shikoni se çfarë rrengu të pastër komik përdori shkrimtari: derdimenë të politikës, sa herë ndërron pushteti, po aq herë dridh e spërdridh b... Edhe Zoti Maksut kërkon të hiqet, pas pilafit, si një trim, i ndëshkuar dhe i burgosur nga regjimi të cilit i ka shërbyer, andaj dhe kapet fort nga hekurat e qelisë dhe nuk do që të dalë prej andej. Pak njerëz ka sot të tillë, karrieristë të çmendur e të pafytyrë që mbërthehen fort pas kolltukut qeveritar, dridh e spërdridh, veç të rrinë në pushtet, s'ka rëndësi kush ishte e kush vjen, s'ka rëndësi ideali, morali, dinjiteti!...

Pastaj erdhën librat *Kameleoni në hall* (1978), pasuar nga novela *Perënditë bien nga fiku*, (1979), vëllimet *Abeli, unë dhe Paganini*, satirë e humor (1984), *Maratona e vdekjes*, roman (1983), *Pjesë të zgjedhura* (1992). Në këto vepra ti sheh Shqipërinë dhe shqiptarët e projektuar në marëzitet e tyre, jo më shumë politike sesa ato morale dhe karakteriale: njerëz që ndërrojnë shtatë lëkurë si gjarpri, kameleonë të karrigeve dhe posteve, "Abelët" e munguar, katundarë dinakë që duan të përfitojnë, nihilistë që mohojnë çdo gjë në vendin e tyre dhe e bëjnë zi e më zi, plaka të zgjuara që shpotisin nusët e hazdisura, tufa budallenjsh, mburraveçësh, "komandantësh", me fjalitë e mërzhitshme mbushur me slogane dhe mburrje.

Pas vitit 1991 Qamil Buxheli e ktheu sarkazmin e tij tashmë ndaj deformimeve që vëreheshin në ndërtimin e një mendësie të re demokratike, duke fshikulluar me guxim jo vetëm mbetjet e djeshme politike, por dhe gjithë atë skorje që po prodhonte qeveria e re e quajtur "demokratike". Ndër veprat e bukura që edhe sot nuk e heq nga mendja qe libri me tregime *Dostojevsk nuk kemi, idiotët sa të duash* (1997). Si përherë, edhe këtu më pat lënë mbresë sqima e tij letrare, kultura, përzjerja e njohurisë me humorin, sarkazmi dhe satira që djeg e përvëlton, pakënaqësia e shkrimtarit ndaj zvetënimeve morale e politike të njerëzve, deformimet e demokracisë, tundimi dhe fuqia prishëse e parasë. Më vonë erdhën librat e tjerë të tij si *Nusja nga Evropa* (2002), *Amanetet e Kasandrës* (2003). Qamil Buxheli i ishin dhënë shumë çmime e dekorata, ndër to Çmimi i Republikës, urdhëri "Naim Frashëri" i klasit të parë, titulli *Mjeshtër i madh i punës*. Në memorien e letërsisë shqipe ai mbetet nga ndriçimet më të forta të saj, ndërsa në mendjen time, përveç kësaj, edhe si një burrë i urtë çam, me sytë e ëmbël, ato dy dy gropëzat në faqe tek qeshte, fytyrën e tij me dritë, fjalën e mençur si një urtan, sjelljen e butë, të butë... dhe të butë...

(Vijon nga faqja 5)

artistike e vargjeve të saj, më ka lënë pa gjumë, duke më risjell, si asnjë libër tjetër për Epirin dhe Çamërinë, viset këtej dhe përtej lumenjve Kalama dhe Akeron, Janinën, qytetin aq shumë të pranishëm në epikën dhe lirikën çame dhe rrëfimet e të parëve të mi. Janina, epiqendra ku zhvillohen ngjarjet e poemës së Haxhi Shehretit, kryeqendra e Shqipërisë së Poshtme, lidhet pazgjithmërisht me historinë e Çamërisë dhe kapedanëve të saj trima. Dhe jo vetëm me të, por edhe me viset e tjera të Shqipërisë që nga ato të Jugut e deri në skajet më veriore. Dhe jo vetëm me Shqipërinë, por edhe me Greqinë fqinje, historinë dhe kulturën e saj.

Poema "Alipashaiada" dhe libri i mrekullueshëm i Irakli Koçollarit, zgjoi shpirtat e të parëve të mi levendë dhe krenarë, rizgjoji krenarinë time dhe mallin për ato vise, ku vazhdojnë të jenë rrënjët e mia, rrënjët e traditave, kulturës dhe një trashëgimie që nuk do të shuhet kurrë. Do mjaftonte t'u sillja në kujtesë lexuesve të "Alipashaiadës" titujt e disa pjesëve të kësaj poeme, si "Me të marrë urdhrin perandorak, Aliu nis drejt Ohrit kundër Mahmut Pashës", "Beteja e Ohrit", "Fitore e shkëlqyer e Ali Pashës dhe disfata e Mahmut Pashës së Shkodrës", ku morën pjesë, nën komandën e Pashait telepenas, dymijë çamë me Brahim Demin dhe Mahmut Dajlanin e Konispolit, për të cilën Haxhi Sheriati shkruan:

*Brahim Demit çoi shëndet lajm edhe Mahmut Dajlanit
Dymijë vetë menjëherë në Trikalë të mbrij karvani
Se një trim nga Çamëria është vërtet trim sa për dy
Në Trikalë i pret Aliu do bëhet batërdi.*

.....
*Edhe çamët që nuk mbahen ngjajnë të gjithë si luanë
Ku nuk shkuan si petrira, sytë mbi ta vajzat lanë.*

Ose kapituj të tjerë: "Vijnë çamët"; çamët përgjigjen, "Ali Pasha u përgjigjet çamëve", "Çamët e rrezikuar bllokuan limanët dhe njoftuan Ali Pashën në Vidin". "Gjenerali Roze i dërgon letër çamëve"; "Përgjigje e çamëve për gjeneralin Roze", "Përgjigje prevezarëve dhënë Ali Pashës", "Përgjigje e Hasan Çaparit dhënë suljotëve", etj, etj.

Kujtesa çame, eposi i Çamërisë, çuditërisht ka fiksuar shumë bëma nga periudha e Ali Pashë Tepelenës, duke filluar që nga femënia e tij:

*Hanko Pashë, Hanko nure,
lumthi ti ç'fëmijë zure
Hanko kur bëre Alinë,
Vallë ti moj, ja dhe gjinë?
Apo mos ta kanë rritë
Tij ato zërat e malit...*

Në të gjejmë Hasan Çaparin, një nga krerët më të njohur të Çamërisë nga Luarati i Margëlliçit, që me urdhër të Ali Pashë Tepelenës, në krye të një fuqie vullnetarësh, mori pjesë në luftën për çlirimin e Prevezës, në vitin 1807, Elmas Pronjon nga Paramithia, Ali Farmakun, Marko Boçarin, ose Marko Çamin, Foto Xhavelen, Ferim Çamin besnikun e palëkundur deri në vdekje të Ali Pashë Tepelenës, Vasiliqinë e bukur, Fuat Pronjon, Dalanejtë e famshëm të Konispolit etj, si dhe mbi të gjitha Janinën, që kënga çame e quan "Janinë çerek Stambolli", Mesolongjin, Sulin, Pargën, Prevezën, Paramithinë, Filatin, Zallongun dhe "Valen e Zallongut" etj.

Si përfundim, ka të drejtë Prof. Irakli Koçollari, që folklori shqiptar dhe ai grek, kanë rrokur hapësirat epike shqiptare dhe janë një thesar për kulturën e dy popujve tanë fqinj. Haxhi Shehreti ka lëvizur në këto hapësira kulturalisht të pasura dhe "Alipashaiada" nuk ka lindur në vakum.

3

Ndoshta nuk ishte rastësi që tekta meresha me leximin ose këndimin e "Alipashaidës", siç e përdorte këtë fjalë në vend të fjalës lexim, Prof. Dhimitër Shuteriqi, ju riktheva poemës "Iliada" të Homerit, këtë kryelibri të gjitha kohërave. Ajo nis me vargun emblematik:

Këndo, hyjneshë, mërinë e Akil Pelidit.

Kështu hapet sipari ose më saktë porta e një prej dramave më të mëdha të njerëzimit, që ka ndikuar aq shumë në psiqikën e popujve, si dhe në kulturën, artin, letërsinë e mëpasme greke, ballkanase dhe asaj botërore. Vargu i mësipërm vjen nga shek. XII para Krishtit. Zemërimi i Akilit, siç kanë venë në dukje homerologët, përbën episodin e asaj lufte dhe jo dhjetë vitet e Luftës së Trojës. Jemi në vitin e fundit të kësaj lufte dhe ajo zhvillohet vetëm 51 ditë. "Iliada" përshkrohet nga një frymë heroike: Klithma luftëtarësh, hingëllima kuajsh, beteja të përgjakshme, kufoma, vaje tronditëse... Studiuesit nënvizojnë "monumentalitetin në përshkrimin e ngjarjeve". Te "Iliada" elementi luftarak është pëlhura mbi të cilën u kompozua një kuadër kaq i pasur e madhështor i jetës. Tablot e luftës vijnë njera pas tjetrës me skena preke nën muret e Trojes të rrethuar (Spiro Çomora, parathënie e botimit të dytë i ripunuar i "Iliadës", Tiranë 1979). Ajo mbyllet me kujën e Andromarkës dhe më pas të Hekubes: "Hektor, o biri i nënës!" dhe vargjet:

Kështu fund morën gjithë salikimet.
Për nder të madhit Hektor kuajshaluesit Poema



"Alipashaida" ose "Kronika e një lindje të përgjakur" nis me këto vargje:

*Unë, Haxhi Shehreti, tërë këto vargje radhë,
Nëpër xhepa ende mbaj qindra, mijëra që s'janë parë*

Është vetë poeti që qetësisht, pa mëri, hap portën dhe lexuesi më pas do të zhytet në një botë, ku shpalosen kronika sa heroike, aq të përgjakura, të mbushura me lavdi, lufta, ultimatum, e rrafshime fshattrash, koka të prera, vaje. Me të drejtë Irakli Koçollari shkruan: "Hapësirat e kozmosit gjeografik të Alipashaidës" janë të pafund, gati të pamata, ato shtrihen dhe kapërcejnë horizontet të mjegulluara, përtej, në kontinente, Afrikë, Azi, Europë e më gjerë, drejt vendeve të njohura dhe të panjohura, në gryka, shtigje, qytete ku jehonin zërat dhe britmat e luftës, apo në sallonet ku gatuhej politika dhe diplomacia europiane, ku vendoseshin fate popujsh, ndërtoheshin aleanca apo nënshkruheshin aktet kapitullndit të fuqive të mëdha ushtarake. Nëpër vargjet e saj vrapojnë, ndeshen, flirtohen, rrëzohen dhe përgjaken personazhe të nacionaliteteve të ndryshëm... Hapësirat e saj bote kishin në qendër të tyre një burrë, që thirrej Ali Pashë, që po ndryshonte shumë çka nga një traditë shekullore mesjetare, që po rrezonte kufij dhe mite..."

Poema e Haxhi Shehretit ka një frymë të spikatur monumentaliteti, e denjë për t'u radhitur në krahë të disa kryeveprave të letërsisë botërore që nga "Iliada" e këtej. Ajo nuk mbyllet me kujën e Adromarken apo të Hekubës, por me kujën e Vasiliqisë të bukur si ill, siç thuhet në të folurën e Çamërisë dhe me polifoni kujesh të Labërisë e më tutje, më në Veri të trojeve shqiptare, me gjamën e marësorëve dhe më në Jug të Jugut, në Epir, me të klarat, himnet e çamëve dhe meloditë në klarino të grekëve.

Dhe ndërsa mbyll faqen e fundit të këtij libri të rrallë, shkruar nga Irakli Koçollari "ky arkeolog real i kulturës shqiptare" (Teodor Keko), nuk e di pse më vinë si jehonë e largët e dy shekujve më pare, vargjet e fundit të Haxhi Shehretit:

*Kurrë, askush nuk e pandehte se do t'mbërrinte në këtë ditë
Kokë e prerë larg të çojnë në Stamboll tek osmanllitë.*

Është një dhimbje përtej dhimbjes e poetit, që përjetëson me vargjet e tij luanin e Janinës. Është edhe një brengë e poetit që nuk arriti t'i bënte nderimet e fundit njeriut që i shërbeu me besnikëri dhe përkushtim të skajshëm.

Ka kaluar mesnata, kur përfundova këtë shkrim. Në Tiranë bije shi ndërsa në Veri borë e madhe. Librin "Ali Pashaida" e vendos në një nga raftet e bibliotekës, për ta rihapur nesër dhe ditët në vazhdim. Ndoshta nuk është rastësi që e vendos në krahë të "Iliadës". Ndoshta jo, them me vete, ndërsa vështroj edhe libra të tjerë. Biblioteka është një lloj kabineti magjik... Duhet të hapim librin që shpirtat të rizgjojnë. Nesër metereologët kanë thënë se do jetë kohë me diell. Më mirë të ishte me shi, them me vete, kur të rihap faqet e "Alipashaidës". Në shi shpirtat rizgjojnë menjëherë, thonë mistikët. Nesër do të rizgjojnë shpirtat e "Alipashaidës". Nesër shpirti i poetit Haxhi Shehreti do të zbresë në viset e mia të Epirit. Dhe bashkë me ne të gjallët, Irakli Koçollarin dhe mua, do na çojë në Janinë. Po në Janinë bije shi? Eh! Prap m'u kujtua Borgesi i madh dhe dy vargjet e tij:

*Në ç'të djeshme, në ç'oborrë të Kartagenës, bie ky shi?
Hap perden e dritares dhe vështroj shiun e Tiranës. Dhe si në jerm them vargjet:
Në ç'të djeshme, në ç'oborrë të Janinës, bie ky shi?*

Romani shqiptar lindi - në dy anët e Adriatikut - në letërsinë e Shqipërisë dhe në letërsinë e diasporës arbëreshe si *roman historik*. Ky lloj ka qenë i pari i letërsisë shqiptare në të dyja format e veta: roman pseudohistorik ose me sfond historik dhe roman i mirëfilltë historik me në qendër figura historike.

Romani shqiptar lindi me romanet e arbëreshit Santori "Sofia Kominate", "Ushitari shqiptar" dhe me romanet e shkrimtarit verior Nikaj "Marcia" dhe "Shkodra e rrethuese". Po duhet thënë se romanet e autorit të parë, ndonëse jo me pak vlera ideore dhe estetike, nuk i arritën publikut, as atij të bashkësisë arbëreshe për të cilën synonte autori, as atij të atdheut të origjinës që do ta zbulonte një shekull më vonë.

Romani historik shqiptar lindi i shartuar me romanin sentimentalist dhe me romanin social.

Historikisht u zhvillua më tepër si roman *i intrigës* dhe - në sasi më të paktë si roman *i personazheve*, duke nisur nga shekulli i nëntëmbëdhjetë dhe duke përfunduar në fazën e tij të parë me romanet e viteve 30-të, asnjëri prej të cilëve nuk arriti ndonjë thellësi të veçantë filozofike apo psikologjike.

Romanet historike të pasluftës - të mbyllura në kornizën e realizmit socialist, po me elemente të realizmit kritik - vazhduan traditën e përqendrimit të *intriga* dhe, më pak, te personazhet. Pati një përpjekje të pagoditur për të vizatuar figurën e Skënderbeut, çka do të sillte një pasurim relativ, në romanet e viteve 60-të, konkretisht të viteve 1967-1968 nga autorët Gjergj Zheji ("Muret e Krujës") dhe Lavdi Hakui ("Trimat e Skënderbeut").

Romani "Kështjella" i Kadaresë, botuar më 1970, e theu për herë të parë traditën e krijuar, duke u përpjekur të jepte *filozofinë e historisë*, problemin e forcave lëvizëse, problemin e raportit të udhëheqësit me popullin, problemin e motiveve të thella që nxisin popujt për në luftë.

Ky roman, nën guackën e realizmit socialist fshihte elementë të realizmit kritik dhe - risi për t'u venë re - të modernizmit. Këto elementë të fundit çuditërisht i shpëtuan syrit të Argusit të censurës që u verbua nga mburoja nacionaliste.

Në këtë roman me një përmbajtje të thellë filozofike dhe një skemë objekti që thyen rregullat tradicionale, gjejmë gjithashtu personazhe, po paradoksalisht, jo nga kampi i popullit që lufton, po nga kampi armik. Pra, në plan të parë, u vu dobësia që e brente superfuqinë armike, ndërsa problemi i heroizmit të popullit shqiptar që luftonte për lirinë dhe identitetin e vet, si dhe udhëheqësit që i shpreh ato aspirata u zgjidh kryesisht në plan simbolik nëpërmjet figurës simbol të kështjellarit.

A ishte kjo zgjidhja më e mirë? Kjo mbetet e diskutueshme. Sidoqoftë ishte një *zgjidhje*. Dhe autori e realizoi më së miri në plan estetik. [Në atë kohë nga mungesa e përvojës, kemi mbajtur një qëndrim tepër kritik ndaj formës që i dha autori idesë së vet krijuese, formë që s'na dukej plotësisht e përshtatshme. Tani, po e korrigjojmë atë gjykim të nxituar].

Kadareja na ka dhënë një varg personazhesh tepër të realizuara nga kampi armik. Ndofta më e fuqishmja nga ato figura personazhesh është figura e antagonistit të Skënderbeut, Tursun Pashës. Nëpërmjet kësaj figure për herë të parë në romanin historik shqiptar tregojë respekt për figurën e armikut, i cili nuk demoralizohet, as karikaturizohet, po pasqyrohet në mënyrë të denjë si një kundërshtar i mençur dhe trim, veçori që

Romani "Kështjella" i Kadaresë dhe kthesa që solli në romanin historik shqiptar

Prof. Dr. Klara Kodra

përdoren në valencë negative.

Duke mos e ulur figurën e armikut lartësohej edhe më qëndresa e shqiptarëve. Le të vërejmë që tundimit për të karikaturizuar figurën e armikut nuk i ka bërë ballë as Leon Tolstoi që të "Lufta dhe paqja" e vizaton figurën e Napoleonit me përmasa të zvogëluara, si karikaturë.

Figura e Tursun Pashës është një figurë komplekse dhe bindëse, figura e një njeriu ambicioz, të gatshëm për të rrezikuar në maksimum, mjaft i mençur për të përdorur çdo mënyrë për të arritur fitoren mbi shqiptarët nga armët më të fuqishme dhe të stërholluara në mjete më dredharake si privimi i kështjellave nga mjetet e domosdoshme të jetesës si uji ose përhapja e sëmundjeve me anë të minjve, mjet që si bumerang mund të bjerë mbi ushtarët që e përdorin.

Mençurinë Tursun Pasha e shfaq

edhe në marrjen e këshillave nga bashkëlufetarët, një formë "demokracie" e çuditshme kjo dhe e pazakonshme për atë kohë, por që i nënshtrohet qëllimit kryesor.

Gratë e haremit, Tursun Pasha në përputhje me kohën i sheh si pronë të vetën, nuk kujdeset për ndjenjat e tyre, madje është gati të përdorë edhe dhunën ndaj tyre (- Ai vetë i rrahu të dyja me kamxhik përpara syve tanë gjersa u ra të fikët - thotë njëra nga gratë e haremit për dy nga shoqet e tyre).

Megjithatë, ka një fije ndjenje njerëzore, dëshiron për të lënë një pasardhës, mundësisht djalë. (- Në qoftë se ai - tregoi me gisht barkun e saj nën këmbëshën e hollë - do të jetë djalë, ti do t'i vesh emrin tim).

Kjo figurë negative është plotësisht bindëse drejt në fundin e saj me vetëvrasje kur arrin sigurinë e disfatës.



Figura të tjera të realizuara nga kampi armik janë kryeveqilharxhi, kryemekaniku, kronikani, arkitekt Kaurri.

Kryeveqilharxhi është pasqyruar si i vetëkënaqur dhe i pajisur me një lloj filozofie për luftërat. Duket sikur ka një farë mëshire për fatin tragjik të ushtarëve, po është një lloj ndjenje "nga lart". Kryemekaniku është një figurë që mund të konceptohej në plan moral në kohë dhe regjime të ndryshme, figura e shkencëtarit që e sheh shkencën si qëllim në vetvete, duke pranuar edhe përdorimin e saj për qëllime çnjerëzore. Një shkëndi humanizmi shfaqet tek ai kur ai përpjeket të pengojë linçimin e ndihmësit të vet nga ana e ushtarëve që e quajnë përgjegjës për disfatën dhe vrasjen e shokëve të tyre, një skenë kjo tej mase tragjike që të sjell ndërmend një skenë analoge të "Lufta dhe paqja" ku tradhtari i supozuar Vereshagin luan rolin e dashit të kurbanit, duke u masakruar nga turma e egërsuar.


Kronikani është një figurë e goditur intelektualit oportunist që shpreh idenë e *rishkrimit të historisë* nga më të fuqishmit, fitimtarët e radhës. Ai kërkon të asistojë në luftë, po është kuptimplotë fakti që i shmanget rrezikut, sapo i jepet rasti. Ai kultivon miqësinë e atyre që kanë pushtetin si kryeveqilharxhi, po dridhet vazhdimisht në shoqërinë e tyre se mos u zgjon zemërimin.

Lufta midis "të diturve" dhe "të paditurve", që e përshkon romanin në plan dytësor dhe që kritika e atëhershme nuk e vlerësoi është një luftë analoge me luftën midis "të aftëve" dhe të "paftëve" për të cilën më vonë Kadareja me intimitetin e shkrimtarit do të bëjë aluzion te romani "Dimri i vetmisë së madhe" dhe që ishte, në fakt, si e përmend edhe shkrimtari, një nga luftërat më të ashpra në socializëm që paradoksalisht përfundonte shpesh në fitoren e "të paftëve".

Kjo linjë e lidh romanin "Kështjella" me aktualitetin.

Në roman ka edhe një linjë që nënvizon edhe më tragjizmin e luftës, linja e viktimave të pafajshme të kësaj lufte përmes figurave të grave nga të dyja kampet kundërshtarë, figurës kolektive të grave të haremit të Tursun Pashës që zërthehet mandej në figura individuale të veçanta si Exheri që është ende shumë e re dhe naive dhe ka një koncept romantik të jetës që do të bjerë në kundërshtim me fatin e saj dramatik, humbjen e fëmijës të palindur, Ajseli që ndriçohet përmes dashurisë së mallëngjyeshme për të bijën; nga ana tjetër grupi i vajzave shqiptare që bien robëresha dhe bëhen pre e epshit të pamëshirshëm të ushtarëve otomanë.

Në këtë veper të Kadaresë afirmohet edhe niveli i lartë i dinjitetit dhe lirisë që



gëzonin gratë shqiptare para pushtimit otoman, dëshmi e nivelit evropian të arritur nga Arbëria e atëhershme përmes këndvështrimit të çuditur të armiqve të cilëve gratë dhe vajzat shqiptare u ngjajnë si qenie enigmatike dhe të pakuptueshme ("Ato rrinë me meshkujt sy në sy. Bile bisedojnë me ta dhe qeshin... Të bukura dhe të bardha... Ato janë si mjergulla që lëviz dhe ti zgjat dorën ta kapësh, por në dorë s'të mbetet asgjë.

Edhe veshjet i kanë në ngjyrën e mjegullës. Të bardha, të bardha, me ca shirita të kuq e të zez... Sytë e tyre dinakë me të cilët ato, gjer tani, shikohen lirisht me meshkujt...").

Në roman, krahas konfliktit qendror politik ndriçohen edhe konfliktet psikologjike midis ambicjeve dhe zilive individuale të personazheve. Vetë Tursun Pasha gjendet në një situatë të skajshme ku mund të ngjitet lart ose të rrokulliset poshtë.

Zëri i kështjellarit sjell lirizmin në vepër përmes disa intermexo-ve që pasojnë njëra-tjetrën dhe shprehin mendimet dhe ndjenjat e të rrethuarve.

Figura e Skënderbeut, e papranishme fizikisht në roman ndriçohet në dy këndvështrime. Në fillim pasqyrohet përmes optikës së armiqve, tmerrit që u frymëzon atyre dhe që rrjedh si rrymë e nëndheshme në tërë veprën. Gjithashtu ajo figurë çmitizohet, rrëzohet miti i një pamje fizike të veçantë apo ai i një force apo qëndrese fizike të jashtëzakonshme ("Nga pamja ishte i zakonshëm ... fliste me zë të ngjirur dhe shallin me të cilin kishte mbështjellë grykën, nuk e hiqte as gjatë bisedimeve").

Së dyti, kjo figurë ndriçohet përmes zërit të kështjellarit që shpreh tërë besimin e të rrethuarve - simbolikisht të tërë popullit - të udhëheqësi që drejton luftën dhe që do t'u japë fitoren.

Është kuptimplotë që ai thirret me emrin e origjinës "Gjergj" të cilit i shtohet një pronësor shumë shprehës "ynë".

Idea qendrore e veprës e shprehur në forma të ndryshme është qëndresa e një kombi të vogël kundër një superfuqie, e një kombi lufta e të cilit është e motivuar (për liri politike e sociale dhe identitetit) dhe e bashkuar nën udhëheqjen e një prijisi të mençur dhe gjenial, në antitezë me përçarjet e ndryshme që e brejnë kampin e armikut.

Në një variant të mëvonshëm të romanit shprehet edhe valenca fetare e kësaj lufte, mbrojtja e krishterimit që e lidh kombin shqiptar me kulturën europiane dhe e bën mbrojtës edhe të kësaj kulture.

Motivi i *shiu* në roman është simbolik dhe i *dykuptimtë* meqenëse njërs palë i sjell fitoren, tjetrës i sjell disfatën. Në këtë motiv mund të shihet edhe prania e elementit të lashtë kozmogonik *ujë*, shenjë purifikimi dhe bekimi.

Ky është edhe një motiv që përsëritet në shumë vepra të Kadaresë për të nënvizuar tragjizmin e luftërave, tragjizmin e fatit historik të kombit shqiptar dhe tragjizmin e jetës njerëzore.

Ky tragjizëm i shkrirë me heroiken tingëllon në fjalët e fundit të kështjellarit që e mbyllin denjësisht veprën "Ne nuk do të lemë pas statuja dhe kolona madhështore. S'patëm kohë dhe, me sa duket, në pushimet midis rrebesheve që do të vijnë, s'do të kemi kohë t'i bëjmë ato. Në vend të tyre po lëmë këta gurë të rëndë muresh që po i lag këtë mëngjes të vrenjtur ky shi i luftës".

Me elementin ujë bashkohet elementi ajër. Mbi kështjellën e gurtë që rëndon shpaloset me tërë gjerësinë e vet qielli. "Qielli ynë i madh".



NURIE EMRULLAI

dy tregime

RRUGA PRANVERA

Vjeshta filloi të hyjë në zemrën e të gjithëve, ngadalë n'fytirën e saj ravijëvizohet jeta. Këlthitjet e pulëbardhave mbushin qiellin teksa marrin fluturimin drejt tij e sikur duan ta shpojnë. Qielli gati të lëshojë stuhinë, apo gjithë ato pulëbardha që iu kansën pafundësisë së tij. Gjatë këtij shtatori çfarë s'ka ndodhur brenda kësaj rrugice e cila është pagëzuar si Rruga e Pranverës... Vendi është ndarë në dy faltore, njëra anë i bie zotit në gjunjë, tjetra anë ngre duart lart dhe midis ujit, Zoti bën not. Këtu për çdo natë ndodh nga një histori e zakonshme, ndonëse dritaret e shtëpive rrinë mbyllur dhe unë s'kam parë asnjë njeri që të di saktësisht se ç'histori mund të mbajnë shpinat e tyre.

Nga askundi më ra të jetoja me një plakë, së cilës iu kujtua për rrënjët e saj vetëm kur më takoi mua. Nga gjuha shqipe mban mend vetëm ca fjalë të këngës "Vaj, vaj, vaj gishtat me kajmak, o moj goce vogël..." por, nuk ankoem, sepse ishte ajo që më vonë më takoi me Mohsen Namjoo... Ajo është e ftohtë. Si të thuash nuk ka frikë nga vetmia. Ndaj unë, meqë ndodhem në shtëpinë e saj, përpiqem që për të, të jem sa më pak e dukshme. Ajo shqetësohet për mua, më vjen nga pas që të shikojë nëse jam aty apo kam dalë dikund, ndërkohë unë bëj lëvizjet e mia, kur ajo del në ballkon që të pi cigare, atëherë unë shkoj në banjo, kur ajo del të bëjë pazar unë shkoj të lahem dhe kur ajo fle, unë marr për të ngrënë shpejt e shpejt. Më ngjan se bëj jetë miu, gjithë këta muaj të gjatë...

Ajo fle me orar, përkundër meje që jeta ime është në përmbytje... Sonte përsëri i ra alarmi për ta kujtuar që të pijë barnat para se të flejë. Në orën njëzet e dy e dyzet e pesë minuta piu barnat, derisa duke u zvarriutur shkon që të mbushë ujë. Në orën njëzet e tre e dhjetë minuta shtrihet për të fjetur. E

kuptoj që atë e zë gjumi, kur thërret me zë "Baba, baba, pritëm..." i del theksi i bukur, një gegnishte e *ambël*. Pasi thërret kështu shumë herë do të fillojë këngën e saj "Vaj, vaj, vaj..." që e di të gjithën dhe qesh me të madhe...

U bë ora tre e mëngjesit. Ajo tashmë fle e qetë. Macet bëjnë sfilatë në ballkon, ecin duke parakaluar njëra-tjetrën dhe afrohen bri dritares sime sepse ende e kam dritën e dhomës ndezur. Ora vajti katër dhe tashmë nuk ndodh asgjë e jashtëzakonshme. E njëjta e mërkurë përsëritëse vjen midis jave. Në orën pesë të mëngjesit bie telefoni i saj. Nuk është alarmi, por është telefonatë. Aq e gjatë që pritja nëse dikush do t'i përgjigjej asaj drejt telefonate...

"Alo" - thotë ajo me një frikë përzier me përgjumje.

Një alo kërcënuese dëgjohej nga ana tjetër. *Çfarë veshësh ka nata!*

"Por, mos më kërkoni para se nuk kam ku të t'i gjej. Nuk kam, nuk e di pse s'kupton sa herë të kam thënë."

"Unë po vij atje."

"Si, nënën tënde nuk beson kur të thotë se nuk ka? Ç'bën kështu?! Mos eja, nuk kam ku të të gjej para. Pastaj, pse e le punën, e braktise familjen..."

Por, sinjali kishte rënë...

Hapa të rëndë dëgjohej teksa ngjisnin shkallët dhe frymëmarrje e rënduar kaplon hyrjen... mban të ngrirë gjithë rrugën Pranvera.

Dikush po i bie ziles aq gjatë sa arrij të mendoj se si gishti i tij është mpirë nga trusja me forcë e ziles dhe stuhia ka mbaruar dhe pulëbardhat kanë nisur përsëri rrotullimet e tyre rreth qiellit...

Ora gjashtë... dikush po troket me shumë forcë në derë... macet përcjellin dashnorët e tyre, erë duhani dhe afshi lanë pas. Ora gjashtë e dhjetë minuta, dikush është te dera.

Në gjashtë e tridhjetë minuta bie alarmi

për pirjen e barnave. Dy këmbë zvarriten. Dy të tjera lënë shenjën.

Është mesi i javës dhe unë tashmë duhet të flej...

I mistershëm mesi i javës si poeti, vend ka për të gjithë, por s'pranon asnjë në vetminë e tij.

PRINCESHA E PESHQVE

Dikur... dikur mund t'jetë një kohë shumë e largët, por, jo dhe aq e largët, pasi si princeshat, si vetmia i takojnë kohës së përhershme, pra të tashmes.

Dikur jetonte një princeshë e quajtur Kica. Pallati i saj i largët që vendosur mbi një kodrinë, me pamjen më të bukur që mund të imagjinonte dikush. Si me lindje të dielli, ashtu dhe me perëndimin e tij, aty krijoheshin aurat më magjike të universit. Pas vdekjes së prindërve, ose braktisjes së saj, Kica jetonte tashmë e vetme. Sot e kësaj nuk pati as mundësinë më të vogël që të dilte jashtë atyre mureve, se shtëpia e saj gjithnjë ruhet nga dy desh me brinj magjike, të cilët ishin rojet e familjes tashmë breza e breza. Nga jashtë gjithë njerëzit e dinin këtë lloj historie, madje pretendonin se brenda pallatit fshihet aq shumë ar (si në çdo përrallë që na është treguar deri më sot). Por, askush nuk hamendësohte se brenda saj ndodhet një vajzë e bukur. Për Kicën nuk dinte njeri se jetonte aty. Por herë pas here vinte një lloj vale me zëra se aty jeton një vajzë e bukur, dikush thoshte me ftohtësinë më të madhe se ka vdekur, por njeri nuk guxonte të afrohej e të ngjiste atë kodër. Thoshin dhe për këtë ishin mëse të bindur se kush kishte hyrë brenda asaj porte nuk ishte parë që të dilte jashtë.

Kica nuk dinte të fliste, përveç një mërmërimë që e këndonte thujse pa e hapur gojën fare, nuk e dinte prej ku i kishte mbetur kjo mërmërimë, por ne e dimë se ishte kënga me të cilën nëna ia këndonte para gjumit. Brenda dhomës së saj tashmë gjendet një vrimë e madhe, e cila ngjan me një lloj gremine, që shtrihet në sipërfaqen më të madhe të dhomës, tashmë aty nuk ka mbetur asnjë orendi tjetër përveç shtratit, këmbët e së cilit ditaditës janë më pranë greminës.

Dikur mbante mend Kica se ajo greminë që veç një vrimë e vogël, që kjo kishte filluar ta gërryey me thonjtë e saj të imët. Ajo filloi ta gërryente gropën se u mu aty rrinin rrezet më të forta të diellit dhe Kica mendonte se mund ta ruante dritën aty. Ma vonë ajo gropë filloi ta zgjerojë veten e filloi të mbushej me ujë, e me ujin erdhën dhe shumë peshq me ngjyrat nga më të jashtëzakonshmet, që i ngjanin perëndimit të diellit. Kur qielli ishte i kthjellët mbi pus reflektoheshin yjet me pesë cepa të cilët futeshin nga një e plasaritur e çatisë.

Ajo filloi të jetë më pak e vetmuar. Peshqit e ushqenin atë, ajo i rriste dhe i ushqente ata, duke mërmëritur vazhdimisht melodinë e gjumit, më pas i mbyste veç për të trazuar qetësinë e asaj kodre.

Në cepin më të largët të dhomës luhatej një këmbanë, së cilës Kica i binte sa herë që hija shkëputej prej trupit të saj. Dhe lutej për dritën e së nesërme... nuk e dinte derisa do të zgjaste kjo as nuk e dinte se prej kur kishte filluar...

Disa duar kërkojnë brenda pusit diçka që jetonte kohë të gjatë aty, peshqit a princeshën.

Edhe sot e kësaj dite nuk dihet nëse ajo vrau vetminë a vetmia vrau atë.

Një vepër epokë në të cilën janë shkruar për tridhjetë vite portrete e karaktere nga më të ndryshme. Individualitet i veçantë i "zonave" më të thella të humorit shqiptar, i kinokomedisë dhe karikaturës shqiptare.

Bujar Kapexhiu, autori i qindra e mijëra karikaturave të epokës moderne, aktiv edhe sot në të gjitha revistat e gazetave të kohës, në botimin "Variacione" i është kthyer viteve të para e të hershme (1962) deri në vitin 1990.

Në hapësirën shqiptare tashmë komunikimi përmes gazetave përkatëse të humorit mungon. Dikur ishin "Hosteni". Dhe në Kosovë "Thumbi". Në to vihej në thumb dukuritë e shoqërisë. Në elaborimet e Tij Bujar Kapexhiu portretizoj karakterin një art i cili kishte veçantitë krijuese që arriti në përmbajtje të lartë artistike.

Fillimi, dialogu në një film dhe rrëfime

Derisa studiuesja e letërsisë Floresha Dado librin e fundit i ka vënë titullin "Figura- Personazh që "shihet" përmes fjalës", veprën "Variacione" (botim i UET Press) të Bujar Kapexhiut në të cilin mbizotërojnë figura-portret do ta quaja "Portret-personazhe përmes vizatimit (ilustrimit, karikaturës)".

Autori rrëfen nisjen dhe rrugëtimin e karikaturës, nga dërrasa e zezë në klasë, në gazetën e murit të shkollës deri tek botimi në shtypin periodik, nga revista "10 korriku" te "Hosteni" dhe shfletimi i revistës hungareze "Lúdas Matyi", nga aktori Taqo (te filmi "Furtuna") te profesori Kujtim Spahivogli dhe profesori i të folurit skenik Mihal Luarasi.

Për rëndësinë e artit të karikaturës autori thotë se "vonë kuptova se nuk qe e lehtë që të merresh e të krijosh në artin e karikaturës, të trajtosh një problem, një fenomen, një dukuri, dhe si krijues të japësh një mesazh. Pikërisht e qeshura është serioziteti i krijimit komik." (faqe 18) "Këmbëngulja, studimi e talenti rrugë e krijimtarisë për stil original

LIBËR ENCIKLOPEDIK I KARIKATURËS SHQIPTARE

KARAKTERET E PORTRETEVE NË VIJËZIME KRIJUESE ARTISTIKE

nga Enver S. Morina



e të veçantë", thotë autori.

Humori e satira domosdoshmërisht duhet të jetë socialiste. "Nuk mund të buzëqeshje apo të qeshje në formë dekadente, perëndimore, kapitaliste." (19)

45 vite më parë me 12 prill të vitit 1976 është dhënë premierë filmi "Fijet që priten" realizuar nga regjizori Muharrem Fejzo, me skenar (ekranizim dramaturgjik i novelës "Fundit i një brengje") te Neshat Tozaj.

Po sjell këtu një fragment nga dialogu mes dy karaktereve kryesore të këtij filmi Marko Rovinës (interpretuar nga Kadri Roshi) dhe Sami Amenit (interpretuar nga Reshat Arbana) për të venë në përbalje me një gjykim dhe pasqyrim të guximshëm të realitetit nga pikëvështrimi i sotëm:

-Si ma gjete adresën!?

-Ne nuk flemë si ti! Më duket se ke filluar të trembesh!

-Është tmerrësisht vështirë! Ju nuk mund t'i imagjinoni dot gjyqet që bëhen këtu! Kam frikë, se ndonjëherë, do t'më vije radha edhe mua.

-Gjepura. Ti je i mençur dhe ke ditur t'maskohesh shumë mirë. Kisha shumë të drejtë unë atëherë.

-Ë Zot, sa kam frikë!

Këtë dialog edhe mund ta kemi nënkuptuar apriori në kontekstin e një filmi të Kinostudios të asaj periudhe. Krijuesi Bujar Kapexhiu në "anën tjetër" thotë se "humoristët e karikaturistët ishin opozita e parë në atë kohë." (142) afër përngjasimi me intrigën tematike dhe në kontekstin e kohës fjalia "Ju nuk mund t'i imagjinoni dot gjyqet që bëhen këtu!" tregon një realitet që për rrëfimtaret postkomunist do të ishte "lëshim" përmes vrimës së gjilpërës. Në analogji më këtë Bujar Kapexhiu e thotë përmes shpjegimit të kundërt "Në vendet kapitaliste" si një aureolë e alibi të gjendjes së kohës.

Në "ndërrhyrjet" e autorit në libër vjen rrëfimi për takimin me Anastas Kondon dhe dhuratat nga Kujtim Buza. E të tjera.

Kinematografia, portreti i kineastëve dhe filmi

Në tematikën e gjerë thumbuese te "elaborimeve" mbi "VARIACIONE MBI TEMËN" (Kopertina Hosteni, ZYRTARË, FSHATI, Xhaz, Puna, Kritika, A&a, Vepra dhe redaktori, Pema e vitit të ri, Kravata, POLITIKA, ART dhe SPORT) një vend

të veçantë zë kinematografia, portreti i kineastëve dhe filmi.

Bujar Kapexhiu për herë të parë aktor e hasim në filmin "Duel i heshtur" në bashkëinterpretim me të njohurit Ndreka Luca, Rikard Ljarja e Reshat Arbana. Ishte vetëm 23 vjeçar.

Derisa në filmat e parë ("Duel i heshtur", "Gjurma" e "I teti në bronx") ishte aktor i karaktereve serioze, në filmin e vetëm të mëpastajmë si aktor "Dy herë mat" (1986) film në të cilin ishte regjizor e skenarist, ishte aktor komik.

Krijimtaria filmike e Bujar Kapexhiut ka vijëzime të çuditshme. Me kapërcime. Nëse krahasojmë rrjedhat e hijezimit "tjetër" nëpër librit "Variacione" duke lexuar kujtimet dhe rrëfimet stampojnë që Bujar Kapexhiu në "rini", në vitet 60-ta ishte aktor, në "pjekuri" në fillimvitet e 70-ta ishte punëtor krahu dhe në gjysmën e dytë të viteve 70-ta autor i filmave vizatimor në Kinostudio dhe në "pleqëri" në gjysmën e dytë të viteve 80-ta regjizor a skenarist i kinokomedive "Dy herë mat" (1986), "Tela për violinë" (1987), "Stolat në park" (1988) dhe "Edhe kështu, edhe ashtu" (1989).

Triptik ilustrimi "Për ata që flasin në



Xhanfize Keko

"Qortimet e vjeshtës"



Sulejman Dibra

Kristaq Dhama



Bujar Kapexhiu - "Dy herë mat"... përballë kupës

kinema" mjaftë domethënës dhe dramatik. Nga imazhi aktorsk tek atentati në shikues. (172)

Ilustrime, kupat tematike dhe barsoletat

Komunikimet dhe semantika e bashkëpunimit mes mesazhit krijues të filmit dhe përkushtimit kinematografik si realitet tej "plakës xhiruese" e shiritit të celuloidit (192-194): Dhimitër Anagnosti dhe "Lulëkuqet mbi mure"; Pirro Milkani, Violeta Manushi e Raimonda Bulku dhe "Zonja nga qyteti"; Viktor Gjika dhe "Njeriu me top"; Muharrem Fejzo e Robert Ndrenika dhe "Mësonjëtorja" (Regjisori: Këtëj roli ti hash edhe mishin edhe kockat.);

Sulejman Dibra e Krista Dhama dhe "Qortimet e vjeshtës"; Xhanfise Keko dhe fëmijët.

Gjithashtu vjen për lexuesit "Mirush Kabashi dhe muza" pastaj gërshetimi i bashkautorit në vete dhe shikuesi në kinema dhe tetë ilustrime në rrjedhën e një bashkëshortësie në mes artit skenik dhe kinematografik "Teatri dhe kinemaja një "Histori pa... harmoni". Një tjetër krijim që ka të bëjë me aktrimin është "Portreti i aktorit" në katër pamje gjestikulative: Lirik, Dramatik, Melankolik dhe Tragjik. (220)

Riedukimi i artistit? Klasa punëtore jep shenjën pozitive. Bujar Kapexhiu emërohet regjisor në studion e filmit vizatimor në Kinostudio.

Një kapitull ("Festivali i filmit: KUPA"), më plot domethënie qoftë nga realizimi ilustrativ qoftë nga mesazhi që jep përmes fjalëve, është një ndërlihdje kuptimplotë: Albert Xholi "Fillim i vështirë" (...pa kupë), Kujtim Çashku "Të pafuarit" (...për kupë), Esat Mysliu "Hije që mbeten pas" (...kupës), Bujar Kapexhiu "Dy herë mat" (...përballë kupës), Fehmi Hoshafi "Në emër të lirisë" (... dhe jo të kupës), Spartak Pecani "Të mos heshtësh" (... kur është fjala për kupën), Esat Ibri "Asgjë nuk harrohet" (... kur s'merr kupë), Rikard Ljarja "Kur hapen dyert e jetës" (... pranë kupës), Mark Topallaj "Guri i besës" (... por jo i kupës), Sajmir Kumbaro "Rrethimi i vogël" (... me kupa), Mevlan Shanaj "Të shoh në sy" (... moj kupë) dhe Vladimir Prifti "Dhe vjen një ditë" (... pa kupë).

(Faqe 259-271)

Në tematikën për kinemanë dhe filmin autori sjellë për lexuesit edhe gjashtë barsoleta.

Në fund mund të themi që "Variacione" është një vepër jetësore e fazës së parë të krijimtarisë së karikaturës së Bujar Kapexhiut. Rikthimi tek kjo periudhë e gjatë dhe me plot sfida sikur hijeshon edhe krijimtarinë kinematografike e anasjelltas duke nënkuptuar një autobiografi të krijuesit me një shtrirje shumëdimensionale në gërshetim sinkronik e diakronik 30 vjeçar Falem'nderit Bujar për këtë vepër!

Janar 2024, Prishtinë

IN MEMORIAM

A LODHET FJALA E ADEM GASHIT?

nga Ditar Kabashi

EDHE LODHET FJALA

U lodh dhe fjala, u ngrys, u mpak dhe streha e poezisë më shiun s'ia pret, kush e mendonte të vyshkur një zambak në një kopsht a yrt që mbet?

Kush e mendonte se në tryezë një mizë është më sovranë se ti, se dorë e padukshme hedh një shtizë dhe të godet shitueshëm në ijë.

Dhe thua: punë që ndodhin, ligje jete, dhe e ndien si sosesh nga pak, veçse papritmas një qenie tjetër përbrenda të shfaqet dhe fëmijë dhe plak.

Edhe mund të lodhet fjala, ja u mpak dhe në murin e poezisë ndien drithërimë, po në grahmat e fundit shpërthen sakaq fontanë dashurie me ritëm e rimë.

Kjo është një nga poezitë që parapëlqej në opusin letrar të Adem Gashit. Andaj e kam lexuar në mbrëmjen letrare të realizuar për nder të veprimtarisë së këtij poeti, në korrikun e vitit 2022, gjatë Panairit të Librit në Prizren.

Qysh moti kemi qenë miq virtualë në Facebook, sikurse shumica e miqësive të sotme, për aq sa mund të quhen të tilla. Nuk qemë takuar ndonjëherë, deri më atë ditë përvëluese verore. Teksa po pija kafe në një lokal që e kisha zgjedhur duke gjurmuar hije, e pyeta shokun tim nëse personi që po rrinte i vetmuar në një tavolinë matanë ishte shkrimtari Adem Gashi. Shoku im pohoi pa një siguri të madhe. U mata ta shqetësoj apo jo dhe në

fund fare vendosa t'i afrohem. Mirëdita, jeni ju Adem Gashi? – iu drejtova. Ngriti kokën për të më parë qartë dhe tha po. A mund të ulem nja dy minuta me ju? – vazhdova. Patjetër, tha - urdhëro. Ato dy minuta u kthyen në njëzet minuta, e mund të bëheshin edhe më shumë, sikur të mos më priste shoku. Në krye të herës i tregova që më pëlqenin poezitë e tij, në këtë kohë kur secili mendon se shkruan poezi, dhe se veçan i admiroja kompozitat gjuhësore që i formonte mjeshtërisht.

Në bisedë e sipër dolëm të njohur. Eh, Kosova është e vogël, konstatoam në fund. Me mirësjellje u interesua për familjen time. I tregova për humbjen e babait në kohë të afërt dhe për gjyshin që kishte qenë arsimtar. Nisi të më pyeste më hollësisht për ta. Cili Xhafer, i gjati e pedanti që ka pajtuar gjaqe? – më pyeti çuditshëm. Po, - i thashë, e keni njohur? Në atë çast iu mbushën sytë, i hoqi syzet dhe nisi t'i fshinte ato. Pleqëria, tha. Pleqëria po më bën më të ndjeshëm, më fal. Unë shtanga dhe vetëm arrita t'i them se pleqëria për të duhej të ishte e largët. Me pjesën e prapme të dorës i fërkoj faqet. Unë jo vetëm se e kam njohur gjyshin tënd, - vijoi sqarimin, por kam qenë mysafir në shtëpinë tuaj. Kjo punë i ka mbi pesëmbëdhjetë vjet.

Tutje e ftova të vinte mysafir në Panairin e Librit në Prizren për të diskutuar për krijimtarinë e vet letrare para audiencës simpatike që zë vend mbrëmjeve buzë Lumbardhit, në ambient të hapur. Pranoi duke shprehur kënaqësinë. Disa javë më pas nisi Panairi. Në ditën e paracaktuar erdhi liriku Adem. Bashkë me Osman Gorancin e bëmë një përrurim të këndshëm, sa poetik po aq miqësor. Meqë ata të dy ishin shokë të vjetër, evokuan kujtime të ndryshme. Unë, ndërkaq, u mora më tepër me pjesën

letrare dhe i deklamova disa poezi të bacës Adem.

Pas programit shkua të darkonim dhe gjersa kalonim në sheshin e stërbushur të qytetit, në Shadërvan, plot veta na ndaluan për t'u fotografuar me të birin e tij, Dardanin, i cili është aktor. Eh, thoshte baca Adem – më shumë po e njohin djalin se mua. Po në këtë fjalë të tijën nuk gjente vend xhelozia, porse një admirim prindëror.

Në edicionin vijues të Panairit në Prizren, më 2023, në mesin e shumë mysafirëve ishte një shkrimtar tjetër nga Prishtina, i cili kishte ardhur i shoqëruar nga Adem Gashi. Këtij të fundit do t'i ketë pëlqyer atmosfera e atyshme një vit më parë dhe shi për këtë nuk kishte dashur të humbiste mundësinë të vinte prapë, kësaj radhe si dëgjues i kujdesshëm. Meqenëse unë gjendesha jashtë vendit, nuk kisha mundur të jem pjesë e organizimit të këtij edicioni. Arrita veçse në atë mbrëmje dhe u ula në rreshtin e fundit. Me t'u kryer programi, u takova me bacën Adem, fjala e parë e të cilit ishte: *për besë, në çastin që erdha pyeta se ku është Ditari dhe m'u prish qejfi kur më thanë që nuk je këtu. U gëzova që të pashë e të pres ndonjë ditë në Prishtinë.*

Ajo ditë nuk erdhi. Sot e nesër, koha kaloi dhe ne u trishtuam në një ditë janari kur lexuam lajmin se Adem Gashi ka ndërruar jetë. Vetë ai, prej kohësh, na e kishte zbuluar fytyrën e çastit të kobshëm, në vjershën e titulluar "po e zëmë...", kur kishte thënë:

lexoja, po e zëmë, kot se ishte një çast i lig, i kotë siç e këtitillë, fundja edhe vetë kjo botë

Dhe si të donte të linte një përhëndetje të përjetshme, me idilin e vet për vargun autokton e origjinal, në poezinë "Me të dashtë", i dha udhë edhe këtij sëmbimi:

Në këtë botë gjithçka mund të ndodhë siç këndon dhe zogu i këngës në ëndërr,

i lirë.

Se, për t'u thënë, vetëm një herë thuhet: Lamtumirë!

Adem Gashi! Ty, që nuk t'u lodh fjala kurrë, lamtumirë!

25 janar 2024



Foto nga Fahredin Spahija

PYLLIT TË ËNDRRËS

Humbe si ajo mëllenjë Çepuri
pyllit të dendur të ëndrrës

Hijes së Madhe as dritë e hënës nuk shihet
e le më gjurma jote
ai kaçurrel i dredhur që lëshohet tatëpjetë
fytyrës së bardhë të mollës

Kot endem në atë maje të moçme ilire

Vetëm eshtra të fshehur
nën shtresa të paprekura dheu
dhe ëndrra
ëndrra që kanë humbur udhën mijëra vjeçe
e shfaqen tash si copëza pamjesh
nëpër bebëza sysh Fushës së harruar të Dardhës

Tej lumit që bart ndotjet tona
tej atyre bjeshkëve që s'u gëzuan ende
këndon n'heshtje,
këndon pa zë ai zog me kokë jeshile
me flatra fshehur nënsqetullave të mia
e ti
ti fshihesh natë pjesë të paprekur prej gjuhës ime
fshihesh e ruhesh për një stinë tjetër
e për një kohë që si sot
do t'mungojë edhe nesër

Po unë s'ndalem

Udhëve kryq do t'u bie
udhëve e përrënje
do dal dhe në qytete prej betoni
ku zhurmë makinash e njerëzish t'humbur
në tymëra e gazëra që djegin pa pra
zverdhën e tretën për një fjalë goje e një të ecur andej
kah trete
se s'ke ku shkon përtej meje
përtej kësaj rrënje të moçme epshi

Tek unë do t'kthehesh kur veç hije t'kem mbetur
veç emër i pritjes së pasosur
rrënjësor thellë asaj zemre
që ma ruan një hapësirë të blertë
e një stinë çfarë e dua
ku mëllenja ndalet pa drojë e shuan etjen
për vete e për mua
buzëve që zdrisin nën hijen e syve të tu
pyllit të dendur të ëndrrës që mbi mua rritet

(6 shkurt 2018)

I TRANDUR PRAPË NGA E NJËJTA ËNDRËR

(Varianti final)

Ëndrra që nuk mund ta harroj Ti je
s' di pse të kërkoj kahdo kaq etshëm
stinëve me diell moteve të qullura me shi
duke ecur kah ti këmbët sa nuk më ranë
n' kashtë e n' dru t' thatë fjeta i lodhur udhësh
duke të ftuar për ditë e duke të pritur çdo natë
thoshe je veç fjalë për ndjenja më qortoje
kur fshehurazi lëshohem drejt teje ngadalë
shpirt-trazuar si unë e qetë nuk ndihesh
sa në dritare sa te porta kund nuk zë vend
të gjitha rrugët e mia trupit tënd përfundojnë
dhe ato shtigje të pashënuara në hartë
të kam bartë pjesëve të qenies sime
nën hije të syrit me buzët prej loti
stinëve që ndërroheshin pa më gjuhëzuar
s'jam penduar hiç pse t'u fala njëanshëm
larg skenës aktron shtiresh së jashtmi
nuk të afron kush si unë nuk të mirëpret
ëndrra që s'mund ta pushtoj qëllove

Sabit Rrustemi

BRENDA NJË
GRIMCE QË
DRITHËRON

Poezi



në natën më të thellë më zgjove sa herë
atë kohë e sot kah ti hapëroj si i përhëtur
digjem moteve për të parë e rrallë të takoj
i zhgënjyer kthehem veten s'e gjej kund
gotave pa iu ra në fund dehëm e zhdehem
i trandur prapë nga e njëjta Ëndërr
askënd tjetër si Ty s'e desha Zemër

(14 shkurt 2018)

ATO FAQE STINËSH QË BLEROJNË

Ka trokitur po ende nuk ka zdratur
dita që t'solli në jetë
zemër

Çeli sytë
ta shoh atë qiell bote
si shndrit brenda teje

Ndizi buzët me pak gaz
ato faqe stinësh që blerojnë

Lëshoje Trupin kah unë
të ta pres e prek me k'to duar
mos e thyej

Çastin që shfaqet krejt papritur
ndjeje
shijoje

Qoftë dhe vetëm një herë

Brenda një grimce që drithëron
është vetë jeta

një bimë që kurrë nuk thahet
as kur bëhemi një me tokën
as kur tresim qiejve shpirttrash

Ditën që t'solli në jetë
e ndjej edhe kur s'të shoh
përmes këtij ajri më ngroh dhe tash

(9 mars 2018)

AJO HËNË ME FYTYRËN TËNDE

(Variant final)

Tërë ditën rri hapur
syri rojtar i shtëpisë

As e luan qerpikun
për pluhurin e të lehurat e gardhit

As kur fryn nuk mbyllet
s'thyhet se sipër ka ngujoren

Tërë ditën e lume
atë vashë me f'tyrë prej hëne pret
kur del prej udhës malit
kah lugina e gjatë e dhembjes
prej udhës kroit
kah rogat e verdha të vetmisë
prej shtegut t' kopshtit
kah blini i përjetësisë

E gojën s'e hap as syrin e mbyll

Krejt çka ka për të thënë
me heshtje e qanë
pazëshëm në brendi
si ai qarri i moçëm aty për bri

As natën nuk mbyllet hapur rri
kthjelltësi i duhet shtëpisë e freski
një puhi me dashuri

Tërë natën e lume pret
për ta parë në ëndërr
atë vashë hëne tek përvidhet pas lisash
varet e pret n' kurorë degësh
hapin që nuk niset
dorën që nuk zgjatet

Heshtja na ka mbërthyer

Kurdo që nisesh kah unë
në ëndrrën time trokit

Në çdo kohë do ngrihem
ta marrë me të mirë
qenin e shtëpisë

Ajo hënë me fytyrën tënde
qetas përvidhet prej pas kodre
i vë në gjumë lisat
e hyllet kah porta

Po porta
vetëm kornizë ka mbetur
krimbat e bluajtën në mungesën tonë

Ajo fytyrëhëne e ngrirë
mbin në prag stinës që vjen
për t'ma falë të egrin trëndafil

(20 gusht 2018)

VETËM LE TË VIJË

E prisja fluturimin e saj drejt meje
si grishë si mëllenjë a si stricë

E kisha admiruar me ditë e net
me mijëra e mijëra vjet
ushqyer i kisha sytë
me bukuritë e saj

Ajo
si një dashuri që përndizet me pak
fluturoi gjetkë
ra atje ku nuk e arrij
në një planet të humbur

E nuk është Atlantidë
as Trojë e djegur e lëvruar

Fushës së Mëllenjave kohë pas kohe vegon
me qafën e bardhë zgjatur kah unë
me syrin shqiponjë
më shpon

Oooh
ç'e dëshiroj ç'e pres
atë frymë hyjnore shpirtëdëlirë
atë njomësi që shton jetë

Vetëm le të vijë
ajo flakë zjarri që shkrin
gjuhë e përndezur që ëmbëlson
shenjtëri të cilës i falem në çdo kohë

Për hir të dashurisë që s'shuhet
gjithë torturat e pritjes
vonesat
mungesat
e heshtjet
i qofshin falë

(5 nëntor 2018)

ËNDRRA E NESËRME QË E DESHA SOT

Luginave ku prehet në dysh
kurrizi i k'tij Mali t'Moçëm
shprushet Etna
nga vullkane të fjetuna trubullohet Kroj

Një Mjellmë e Bardhë e Ujërave të Kaltra
më përfton syve e m'trazon n'Rrajë t'Çepurit

Dallgë të furtunta zjarresh
përplasen mbi Trojën e Lashtë
e mbi mua
sa herë të kujtoj e nuk të kam

Fat a Kob ishte ai Çast që u njohëm
në një fund mali e një fund stine
skaj Jonit të përtërishëm

Nuk ish ai Yll i largët
me mijëra vite drite që më digjte
as ai zjarr i pashuar luftërash
që ende flakëron nëpër kohë

Shikimi yt prej Mona Lize ish
ndezës e flakëruës si tash
që m'i zjarrmon ndjenjat deri në hi

Kot thyej udhën kah Syri i Kaltër
a gjarpëroj Jonit për dritë hëne

Vetëm ndizem e përndizem më shumë
asaj pyllnaje ngjyrë qumështi
hapësirës së mëndafshhtë të qenies sate

(18 - 19 dhjetor 2018)

Ylli Pango

DY TREGIME

I GJITHË MJERIMI I ASAJ BOTE...

...Zysha Lia Ha-Ha. Më elegantja ndër zyshat e gjimnazit. Fine. Me naze. Me poza. Me zë të përkëdhelur. Martuar me një burrë me biografi të mirë. Me një punë përkatësisht vetëm për biografi të mirë. Shumë të mirë.

Mërmëritej se kishte edhe të dashur.

Jo, jo ishte thjesht flirt. Kështu së paku e emërtonte i dashuri. Një mësues nga ata që e thërrisnin presor. Fliste, (-sipas nesh, nxënësve), rrjedhshëm anglisht. Natyrisht pa qenë kurrë në Angli. Mos e fol, në Amerikë. E kujt i shkente mendja, madje as ëndrra, të kish shkelur ndokush pranë nesh ndonjëherë...

Ajo zysha dukej, a sillej, sikur të ish lindur në një diku të ngjashme me Romën a Parisin e përfytyrimeve tona vorfnore. Në pamundësi kontakti real, në vendet e humbura, kish së paku në imagjinatë, njerëz të tillë. Si punë mbetje "të fillimeve të asaj bote të egër". Ku ta dish ç'gen trashëgonin së largu në kohë.

Zysha ishte instiktivisht përbuzëse a e neveritur ndaj qenieve të dobta.

Si i tha motrës për mua kur e takuam rastësisht rrugës: "Pse kaq i verdhë, pa mish, pse nuk e shëndoshni pak?" Motrën e kish nxënëse. Unë isha ende një çerr i vogël në fillore. Vërtet i dobët e i zbehtë. Motra u mek. "Poshtëruese" e risolla unë më vonë në kujtesë. Pa ja gjetur tamam shprehjen në fjalë ndjesisë së atij çasti...

...Ai yni, ish aso kohe. Gjimnazi më i vjetër a më i vetëm i qytetit. Kështu quhej. Mbante emrin e qytetit, si i vetmi i tij.

Më vonë i vunë emrin e një heroi që nën zë thuhej se e kish vuarë Tarras Komandanti. Pseee?

A sepse ish më i ditur se komandanti, a se dhe ky dashuronte po atë çupë. Atë që mori Tarrasi, më vonë, për grua

Gjithsesi kujt dyshonte, i thuhej nën zë: "E pse nuk i shkon kurrë Tarrasi vizitë te shtëpia familjes së krye-heroit, ndërkohë që viziton të tjerë e të tjerë çdo vit". Disa nga këta që flisnin nën zë, shumë shpejt hynë e nuk dolën më nga burgjet...

...Bota e re e së ardhmes" veç të tjerësh, mbante në survejim edhe ndoca tipa si zysha, dashnori a edhe burri i saj. Seç linin një përshtypje a dukeshin siç thuhej, si biçim "borgjezësh". Ky i shoqi, mes nesh qurrashëve të vegjël të shkollës, thuhej se kish parë botën. Kur fliste me shokë rrëfente për mrekulli qytetesh si Buenos Aires (ah Buenos Aires...!), Oh, Ajri i mirë i mëngjesit...ç'qytet)...Rio de Janeiro, (ky lumë janari), e deri për Antibe që përzejhej edhe me Antile, për Romë, Paris...Nice. Lexonte shumë e përfytyrimin e kish të ndezur. Kish qenë veç një herë në Prishtinë, me do pedagogë të tjerë...

Veç imazhit "borgjez" para syve tanë, kishte dhe diçka që i bënte të dukeshin si ndryshe. Ishte i jati i burrit të zyshës. Imazhi i tij: Ishte anëtar partie i orëve të para, nëpunës i lartë i partisë në qeveri e deri në lidhje me shokun e rëndësishëm X. Çoç ishte...Por kishte dalë edhe disa herë jashtë. Me "Jashtë" aso kohe nënkuptohej jashtë shtetit, një jashtë aq e madhe, e paarritshme, me J të madhe. Ata shiheshin mne aq admirim...Ndonëse kur ktheheshin nga jashtë, nëpunësit e asaj kohe, deklarorin se të dilje "jashtë shtetit" ishte vërtet si të dilje jashtë në një WC të pisët. Aq të ndyrë ishin ato vende. Këto thuheshin në rathë të gjërë publikë, natyrisht. Në rreth të ngushtë, kur s'e mbaje dot gojën e flisje si i magjepsur, flitej ndryshe. E po të të rastiste shoku a dëgjuesi spiun (jo rrallë), e mbyllje ciklin në W.C e burgut.

...30 vjet më vonë, në demokaturë, u hap edhe për të lënë pas dynjaje, bota. Ishin fillimet. Atëhere, n'ato fillime, rastisi të udhëtonim në një avion me çiftin e fisëm të së



shkuarës. Zysha më pa shkarazi. Nuk më njohu. A ndofta nuk e lidhi dot pamjen time prej meso burri me kostum, me atë djalin e vogël anemik, vëllanë e vogël të njerës prej nxënësve të trembura të dikurit...

...Ndalua në Romë, prej nga unë tranzit drejt Strasburgut e edhe ata tranzit për s'di se ku. Tek bëheshim gati të linim avionin, ajo pat mbetur ulur, me rryp sigurie mbërthyer e s'po dinte ta hapte e nuk po i shqitej dot. E i shoqi që përpiquej ta ndihmonte e nuk mundej dot as ai (si ish "çliruar", vetë vallë?)...Pastaj e kuptova... Ai po i thoshte të kalonte rrëshqanthi, poshtë rrypit të sigurisë, se ndofta ish mbërthyer keq ajo kapësja e nuk hapej. A thua të kish kaluar vetë ashtu ai burrë, e nuk e pata vënë re. Kish gjasë se pat qenë gjithmonë mashkull i shkathët e i zoti...E vijonte të mbetej. Se dukej të ish dhe udhëtimi i tyre i parë me avion...

...I kisha sërish përpara tek kalonin kontrollin e bagazheve të dorës e atë trupor. Po prisja rradhën pas tyre e po shihja tek u "fusnin duart" kontrolluesit, e ata për tu treguar sa më të bindur, (a ashtu mendonin se duhej), i ngritën duart jo anash, por lart...Sikur po "dorëzoheshin". Sikur luteshin, kërkonin falje: "Kontrolloni, kontrolloni ju lutem...Na bëni ç'të doni". Ishin aq të bindur...të përkorë...

...E ashtu vazhduan me duart lart edhe pas kontrollit e nuk po i ulnin duart as kur mbaruan kontrollin, e vazhduan ashtu më tej, derisa kontrollorët zunë e qeshën (ndofta edhe i morën për aktorë komikë), e u thanë: "Qetësohuni zonjë...zotëri...në rregull...ulini duart..."

...Ah të isha piktor. Tabloja: Izolimi. I gjithë mjerimi i asaj bote. Mpiksuar në një çift ex-modern. 45 vjet mbrehur, edhe ata, në qerren e një kohe që shkente pas...

"FOL PËR VETE"

(fjala magjike)

Ishte rreth të 50-ave, gjithë energji. Kur i fliste ndonjë moshatar për pleqërinë që po afronte, ja priste:

"Fol për vete"

Kur kapërceu 60, e i thoshin "hyre në moshën e tretë, po afron pensioni", bërtiste akoma më fort: "Fol për vete"

Kapi 70 e akoma më fort i çirrej, i ulërinte kujt do që ja kujtonte: "jo po mosha...jo po sëmundjet...jo po.."

"Fol o vlla për vete..."

Sa herë i përsëriste ato fjalë "magjike", ndjehej sikur rinohej sërish. Kish bindjen që kish gjetur formulën e përtjetësisë (askujt nuk ja thoshte)...Fjalët-Çelës: "FOL PËR VETE"

...Kapi 80, ndofta 90 pranvera e dimra. A ndofta më pak...Kapi dikur gjithsesi edhe ai shtratin. Mbi kokë të shtratit, një mik 80-90 a diku aty rrotull...shumëvjeçar. Po na i jep gajret e po e ngushëllon, njeriun që po ikën...

E po i thotë mbi kry t'shtratit:

"Epo mosha...miku im... avash-avash...si gjithë të tjerët..."

...Ja pret i shtriri me rënkim:

"Fol ore për veeete..." dhe aty për aty e jep edhe shpirtin...

Pat besuar fort te fuqia magjike e asaj fjale.. Që gjithmonë e thosh sikur bënte shaka por dhe e ndjente si të vërtetë kur ja thoshte bashkëmoshatarit:

"Fol për vete..."

Ama gjithmonë thosh si fshehuraz veç me vete: "S'jam si ty...or joo...jam i ri...plak i dreqit".

...Nuk pat gabuar me fjalët magjike as kur dha shpirt Se edhe miku ju përgjegj:

"Dhe prapë ke të drejtë, miku im i vjetër...për vete fola... se ti ike miku im...e unë jam ende gjallë...me të fundmë kapitull timin, ende të hapur...atë që tashmë ti e mbylle"

Të flasësh për poezinë moderne nuk do të thotë të nisësh vetëm nga një pikëpamje historike, domethënë relative, për të shënuar në evolucionin e gjinisë veprat dhe autorët që thjesht u përkasin kohëve të fundit. Në këtë kuptim *modernia* nuk i kundërvihet të moçmes, por i kundërvihet *klasikes* apo tradicionales. Pra, moderniteti përkufizohet si një shkëputje e qartë dhe e vullnetshme nga e kaluara. Bodleri është i pari që e ka konceptuar dhe e ka shprehur kuptimin e kësaj shkëputjeje. Bashkë me të dhe duke filluar nga ai, poezia franceze u çlirua përfundimisht nga rregullat që dukej sikur i kishin përcaktuar përgjithmonë natyrën dhe idealin e saj. Sigurisht, nuk është fjala për të mohuar përtëritjen e konsiderueshme të frymëzimit që kishin sjellë romantikët, por këtyre të fundit u kishte pëlqyer të qëndronin brenda kuadrin formal që kishin trashëguar, dhe u kishte munguar qëndrimi kritik ndaj shkrimeve të sentimentalitetit, duke e merituar qortimin që u ishte bërë, se ata e ngatërronin shprehësinë poetike me ligjërimin në vargje. Edhe Bodleri është romantik, i fundmi i romantikëve, “në pikën më të skajshme të Kamçatkës” të kësaj lëvizjeje, sipas shprehjes ironike të Sen-Bëvit (Saint-Beuve). Megjithatë tek ai, në shohim nismëtarin e një ndryshimi themelor të poezisë që punën me ligjërimin nuk do ta ndajë nga sugjerimi i përvojës jetësore, që madje do ta lidhë po aq ngushtë ndjeshmërinë me ligjërimin sa dhe ligjërimin me ndjeshmërinë. Batuta e famshme e Malarmesë (Mallarmé): “Poezia nuk bëhet me ide, por me fjalë”, në fund të fundit është veçse formula e mbrame e asaj fitoreje të re të shprehësisë fjalësore, pionieri mendjendritur i së cilës ka qenë Bodleri. Në këtë mënyrë u hodhën themelet e poezisë moderne si “një lojë supreme”, siç ka thënë përsëri Malarmeja në kuptimin e fismë të fjalës *lojë* si manifestim i lirisë dhe i trillimësisë së kulluar.

Në qoftë se themi se ky konceptim i ri për veprimtarinë poetike sjell me vete një lloj prirje drejt anës ludike të të shkruarit, le të kemi parasysh më shumë qëndrimin e rreptë për gjërat më të qenësishme, për çka dha prova Bodleri, i cili mbetet një mësim autenticiteti dhe vërtetësie që do të mundohen ta ruajnë të gjithë pasuesit e tij të mëdhenj. Në këtë kuptim, sigurisht Bodleri mbetet klasik, çka si të themi përbën një kontradiktë, një kontradiktë pjellore. Në të vërtetë kur i referohet Malerbit (Malesherbe) si një mjeshtër, kur thotë se i admiron “vargjet e tij simetrike dhe të mbushura me melodi”, kur i kthehet formës së vjetër të sonetit për ta përdorur për nevojat e tij, duke vepruar kështu, hovjet e ndjeshmërisë së tij tejet të madhe ia nënshtron sfidës së mjeshtërisë, sfidës së Fjalës dhe të Jetës, aftësisë së poetit për ta shndërruar si një alkimist i hollë plumbin e pavlerë të realitetit të dhimbshëm në arin e Ideale.

Duke qenë romantik për nga frymëzimi dhe ndjeshmëria, klasik për nga përkujdesja për formën, çfarë e bën Bodlerin të jetë poeti i parë modern? Ai është modern pikërisht për këtë bashkim që nuk është një amalgamë eklektike, por që përfshin në vete vullnetin për ta tejkaluar traditën, duke ruajtur mësimet e saj më të çmuara, në emër të një kërkimi që është i etur për të vërtetën e Qenies. Kur ky kërkim ngulmues, dramatik, i dhimbshëm e urdhëron të zhytet « Në fundin e të panjohurës për të gjetur diçka të re! » (Udhëtimi).

Por sa më i madh, sa më tërheqës të jetë ngashnjimi i misterit, aq më i fortë dhe më i tendosur duhet të jetë vullneti për të nxjerrë së andejmi të fshehtat e njohjes. Asnjëherë nuk është ngulmuar sa duhet për të vënë në dukje rolin që luan vullneti si forcë e qenësishme në ndërmarrjen bodleriane. Ndonëse shpeshherë kjo forcë dështon, mposhtet, “avullohet” për shkak të dredhive të fshehta të Satanait, prapëseprapë ajo e gjallëron veprimtarinë krijuese të poetit dhe i shtyn synimet e tij drejt ideale. Ajo e ruan nga vetëkënaqësia, të cilës i lëshuan pe aq e aq krijues që i paraprinë romantizmit dhe e nxit të ballafaqohet me mendje të kthjellët me gjendjen e tij të mjeruar. Pra, te *Lulet e së keqes*, mund të shohim se si shtjellohet një “tragjedi e vullnetit” që i jep tërë kuptimin e saj përkujdesjes që ka treguar Bodleri për ndërtimin e kësaj përmbledhjeje.

Modern për nga ambicia e tij për një tejkallim të vazhdueshëm të përvojës së fituar, Bodleri është i tillë dhe për nga vëmendja që tregon për të dhënat e pandërmjeme të së tanishmes së jetuar, drithërimat intime të së cilës i paraqet me intensitet. Në këtë pikë, është e udhës të bëjmë një paralelizëm

SHARL BODLER (Charles Baudelaire), THEMELUËS I POEZISË MODERNE

Prof. as. Dr. Anton PAPLEKA

midis veprës së tij poetike dhe shkrimeve të tij estetike, meqenëse siç thotë vetë Bodleri, është e nevojshme që çdo poet të jetë njëkohësisht edhe kritik. Vlerësimi i saktë që i bën krijimtarisë së tij, jo vetëm manifestohet në mënyrë të shkëlqyer në gjykimet që jep për shkrimtarët dhe artistët e tjerë, por këto gjykime përbëjnë një doktrinë të vërtetë estetike, të pasur e koherente që ka si bosht pikërisht nocionin e *modernitetit*: “Moderniteti është kalimtarja, ikanakja, tërësia, gjysma tjetër e së cilës është e përjetshmja dhe e pandryshueshmja.” Pra, pa e bërë *tabula rasa* të kaluarën, pa hequr dorë nga vlerat e përhershme të idealit artistik, Bodleri e fton çdo krijues të tregohet i ndjeshëm ndaj kohës së tij, të reflektojë ato gjëra që nxitin kureshtjen dhe pasionet e bashkëkohësve të tij, të kuptojë lëvizjen e historisë në epokën që rron dhe që i sjell pjesën e tij të imazheve dhe të ndijimeve origjinale. Originaliteti është një përbërës thelbësor si dhe një kriter i modernitetit. Duke u shkëputur nga kanonet akademike për “të natyrshmen” dhe për “gjasësinë”, Bodleri pohon: “Gjithmonë e bukura është e pazakontë”. Natyrës, të cilën ai e kishte urreyer njëqind herë si vendi i mëkatrënies dhe si burim i mëkatit që rëndon mbi njerëzimin, ai

i kundërvë atë që është artificiale, produkt i qytetërimit, krijim i pastër, i vullnetshëm, që njeriu e ka plotësisht në dorë. Pra, qyteti do të jetë dekori më i përshtatshëm (par excellence) i modernitetit dhe moda e veshjes do të jetë lëkura e re, me të cilën mbështillet njeriu për të simbolizuar autonominë e tij estetike. Hero i modernitetit, *dandy* manifeston “epërsinë aristokratike” të mendjes së tij duke e çuar deri në pikën më të lartë stërhollimin, madje sofistikimin e kostumit të tij, por në mënyrë më të përgjithshme ai synon ta ndërtojë tërë jetën e tij si një vepër arti, si një sfidë demiurgjike ndaj fataliteteve të natyrës.

Kështu mund të themi se vepra e Bodlerit, fener ngashnjyes që nuk ka reshtur së përdhuri ndjeshmërinë tonë në misteret e ekzistencës, përfshin hapësirën ku kryqëzohen dy botë, e lashta dhe e reja. Kjo vepër kërkon që vëmendjen tonë ta përqëndrojmë në të me një intesitet edhe më të madh, ngaqë ajo nuk është voluminoze. Përsa i përket krijimtarisë poetike, ajo është përfshirë në përmbledhjen *Lulet e së keqes*, të cilës duhet t’i shtojmë veprën plotësuese të domosdoshme dhe posaçërisht moderniste *Poema të vogla* në prozë. Tërësia e këtyre teksteve nuk përbën një vëllim të madh, por shkëlqimi që vjen prej



tyre, ka një dritshmëri të papërsëritshme.

E botuar për herë të parë më 1857, përmbledhja *Lulet e së keqes*, në të vërtetë është vepra e një jete. Poemat e saj më të hershme i përkasin vitit 1845 dhe Bodleri do ta plotësojë dhe do ta pasurojë derisa të vdesë. Aty janë mbledhur e janë përsosur në zjarrin e fuqisë së fjalës tërë personaliteti i tij, të gjitha përvojat e tij krijuese, që nga më të zymtat deri tek ato më ngazëllueset. Ky pasazh i famshëm nga një letër që i ka shkruar noterit të tij, Ansel (Ancelle), hedh dritë mbi gjerësinë dhe autenticitetin e sipërmarrjes së tij: “A duhet t’ju them juve që nuk e keni vënë re më shumë sesa të tjerët, se në këtë libër mizor, unë kam vënë tërë zemrën time, tërë dhembshurinë time, tërë fenë time (të maskuar), tërë urrejtjen time?” Pra, është fjala për shprehjen e një përvoje të jetuar në të gjitha aspektet e saj, që nga ato me fisniket, deri tek ato më poshtërueset, deri në atë pikë sa atë mund ta shikojmë si njëfarë autobiografie poetike, por ajo është një shprehje që zotërohet nga autori, siç e dëshmon përkujdesja për ndërtimin e librit, të cilin Bodleri e ka pohuar me ngulm: “E vetmja lëndatë që pres me gjithë shpirt për këtë libër është që njerëzit ta vënë re se ai nuk është një album i thjeshtë, se ai ka një fillim dhe një fund.” Shumë bojë ka rrjedhur nga penat e kritikëve për të vërtetuar këtë ambicje. Ndoshta është e kotë të kërkojmë në detajet më të vogla që flasin për vazhdimësinë nga një poemë në tjetrën, provën e një renditjeje të rreptë, por së paku bie në sy se pikërisht orientimi i një fati e përcaktonte ndërtimin e përmbledhjes në gjashtë pjesë, veçoritë përkatëse të të cilave e meritojnë të vihen në dukje.

“*Splini dhe Ideali*”, pjesa e parë që pa pikë dyshimi është më e pasura dhe veç kësaj ka më shumë tekste, shpreh në mënyrë më të shkëlqyer tragjedinë bodleriane të “postulimit të dyfishtë”, fetar dhe mistik drejt të Mirës dhe lumturisë shpirtërore, sensuale dhe satanike drejt të Keqes. Aspirata drejt Idealit qoftë kur i drejtohet Qiellit (*Ngjitja në qiell*) apo kur synon të mbërrijë në një vend imagjinar “luksi, prehje dhe kënaqësi” (*Ftesë për udhëtim*), qoftë kur ngjizet me nostalgjinë për një parajsë të humbur (*Jeta e mëparshme*), “Moesta et errabunda”, bie ndesh me përgënjeshtrimet mizore të realitetit, burim i përhershëm mizorie, dëshpërimi, ankthi, i asaj ndjenje pafuqie dhe kotësie, të cilën Bodleri e përmbledh me termin anglez « spleen » (splin). As Bukuria, as Dashuria, ndriçime dhe bunaca në këtë mynxyrë të errët, nuk të japin mundësi të shpëtosh për një kohë të gjatë nga realiteti. Në qoftë se arti është “dëshmia më e mirë / Që ne mund të japim për dinjitetin tonë”, gjithashtu ai është dhe një “dënesë e zjarrtë” (*Faret*). Përsa i përket dashurisë, ajo na bën të përjetojmë një sfilite të pashërueshme midis tërheqjes së epshit me zhgënjimet që sjellin kënaqësitë trupore, dhe adhurimit të gruas së idealizuar që e bën atë të paarritshme. Në tërësinë e poemave për dashurinë, kanë pandehur se kanë dalluar tri cikle që u përkasin tri grave që ka dashur Bodleri: Zhanë Dyval (Jeane Duval), Mari Dobrën (Marie Daubron) dhe zonja Sabatié (Sabatier). Por në vend që të merremi me këto konsiderata biografike paksa të kota, është më mirë që në këto poema të vlerësojmë praninë e anëve të ndryshme emblematike të Gruas: sensuale dhe ephndjellëse (*Floknaja*), engjëjlore dhe e admirueshme (*Rikthyeshmëria*), joshëse dhe keqbërëse (*Qiell me re*). Cilatdo qofshin burimet e artit dhe të dashurisë, hovjet e tyre të brishta vetëm mund t’i lehtësojnë përkohësisht vuajtjet tona (*Himn për bukurinë*). Gjithmonë del fitues *splini*, duke i dhënë kësaj pjesë të parë të përmbledhjes

BAUDELAIRE

Parathënia nga Ismail Kadare

Brenga e Parisit

Përktheu nga origjinali
Besiana Kadare



Onufri

Onufri

një tonalitet që gjithnjë e më tepër të kujton sëmundjen dhe vdekjen. Siç e kanë vënë re, orientimin e kësaj pjesë e kuptojmë nga titulli i saj i përbysur: (*Ideali dhe splini*). Ëndërrimeve të ndryshme, tablove farfuritëse të fillimit, megjithëse edhe ato i brente një shqetësim i shurdhër (*Harmonia e mbrëmjes*), u zënë vendin makthet, llahtaria dhe rënia shpirtërore. Janë të gjithpranishme imazhet e vdekjes që shumëfishohen në një rrjet shumë të ndërlikuar obsesionesh rrëqethëse. Varre, burgje, dimra, kafshë të lemerishme të shtynjë të mendosh për pashqitshmërinë e një fati të pamëshirshëm. Vetë qielli nuk është më një hapësirë ku shpirti mund të shtrihet pafundësisht, por ai është një "kapak" mbytës që zhduk çdo shpresë. Kambanat, zëri i fesë, bien vetëm për të lajmëruar vdekjen. Element i një biografie poetike, pjesa e parë është e tillë edhe ngaqë ajo na bën ta ndiejmë në mënyrë progresive peshën e Kohës, të lodhjes, të sëmundjes dhe të plakjes, por nga afati i pashmangshëm i vdekjes, nga "e pandreqshmja" është e kërcënuar jeta e çdo njeriu. Lidhur me këtë vullnet të Bodlerit për të qenë koherent, është domethënës fakti se cikli « *Splini dhe ideali* » mbyllet me poemën "*Sahati*", i cili e shoqëron me tiktakun e tij mizor ikjen e kohës.

Në pjesën e parë, motivet që e kanë frymëzuar Bodlerin, janë huazuar nga tematika tradicionale, meqenëse për të qenë të saktë, shprehjet dhe imazhet e splinit përfshihen në vazhdimin e romantizmit "të errët", ndërsa në pjesën e dytë "*Tablo pariziane*", në mënyrë të vetëdijshme ai merret me jetën moderne dhe me dekorin e saj të privilegjuar, me Qytetin, sikur të ishte fjala për të gjetur aty një strehë që së paku të krijon iluzionin se mund t'u shpëtosh ligjeve të pamëshirshme të natyrës. Poema e parë e kësaj pjesë "*Peizazh*", është dëshmia më e mirë për kalimin e tij në anën e modernitetit për konceptimin e një estetike të re. Arave, korijeve, rrëqeve e liqeneve, pyjeve dhe maleve të poezisë tradicionale, ua zënë vendin çati dhe tymtarë, rrugë dhe oborre, uzina, ura dhe shtëpi të mbledhura grumbull në metropolin industrial për një mizanskenë të re të fatit të njeriut. Rrëmuja, zhurma dhe tymi, të gjitha çrregullimet që shkaktojnë vesi dhe mjerimi, sigurisht krijojnë aty një atmosferë të dëshme, por sa domethënës ku "gjithçka bëhet alegori". Kritiku që nxjerr në shesh arkaizmin e shijeve estetike të bashkëkohësve të tij, këtu bashkohet me poetin që e vë veten në zemër të modernitetit në lëvizje. Në qoftë se ka një harmoni më të madhe midis tij dhe këtij kuadri të ri, prapëseprapë Bodleri nuk bie viktimë e mistifikimit të progresit. Qyteti shpalos para nesh pamje mizore : pleq, të sëmurë, të verbër, lypës, prostitutat janë aktorët e trishtuar, të cilët përfaqësojnë tragjedinë që luhet aty. Vetë dashurinë, tundimet e së cilës janë të pranishme kudo në turmë, njeriu e përjeton në një çast shkrepimtar, në një takim që zgjat fare pak (poema "*Një kalimtareje*"). Duket se në poemat e kësaj serie, Bodleri ka ditur të thyejë kallëpin e vjetëruar të imazheve tradicionale dhe ta lidhë poezinë me realitetin që evoluon, tharm i përvojave që përtërihen vazhdimisht.

Katër pjesët e fundit nuk janë aq të pasura dhe ky çekuilibër relativ duket sikur e hedh poshtë kujdesin që mendojmë se ka treguar autori për ndërtimin e tërë përmblendhjes. Megjithatë secila prej tyre ndihmon për krijimin e atmosferës morale të së tërës. Më tepër sesa nga cilësia e poemave të saj, seria "*Vera*" përligjet si sugjerim për ta kërkuar shpëtimin të "*parajsat artificiale*", për prestigjin e të cilave Bodleri ka folur me ngulm gjetiu. Mitit të lashtë të dehjes dioniziane, me karakter frymëzues dhe krijues, i mbivihet diçka më trashanike, kërkimi i shfrenuar i një balsami të harresës nga ai që e di se, para fatkeqësisë absolute, namatisjet abstrakte të urtësisë janë qesharake. Zhytja në zvetënimet seksuale që ndeshen te *Lulet e së keqes*, titull i veçantë i pjesës së katërt, nuk është refleks i një dëshire për t'i skandalizuar luresit, siç kanë gjykuar në mënyrë absurde puritanët hipokritë të Perandorisë së Dytë. Turpet e mishit aty janë veçse ana e kundërt e një dëshire të dëshpëruar për lumturi. Te "*Revolta*" arrin kulmin qëndrimi sfidues, të cilin Bodleri e kishte shprehur në pjesën e parë të përmblendhjes, në poemën (*Don Zhuani në ferr*). Në qoftë se deri tashti, satanizmi ishte përjetuar si një tundim i kundërshtuar dhe i luftuar, tash e mbrapa ai ekzaltohet si përpjekja e fundme e të dënuarit :

"O Satana, ki mëshirë për mjerimin tim të gjorë ..." (*Litanitë e Satanait*)

Duke pranuar konceptimin kristian për universin dhe për fatin e njeriut, - ai ka qenë ithtar i filozofisë së Zhozef dë Mestrë (Joseph de Maistre), apostull i reaksionit katolik dhe monarkist pas Revolucionit, - kundërvënien midis të Mirës dhe të Keqes, Bodleri i çoi deri në skajshmëri, deri në caqet e një manikeizmi që njeriut i ofron vetëm mundësinë e një faljeje të pakuptueshme, e cila nuk ka gjasa të ndodhë.

Përmblendhja mbyllet me serinë "*Vdekja*" por, për çudi, në vend që ta shtojë shprehjen e rënies shpirtërore, ajo përcjell shpresën se shpirti merr hov duke menduar për këtë "udhëtim të fundit". Në të vërtetë, vdekja i jep kuptimin e fundmë jetës dhe e njëjta ngjitje në qiell i bashkon të tre këto figura ideale : dashnorin, varfanjakun dhe artistin, martirizimi i të cilëve e shpëton fatin e njeriut. Pra, mendimi për vdekjen ballafaqohet në këtë përjetim të mbramë si gur prove i aventurës njerëzore, përmes një përshëndetje kryelartë:

Vdekje, kapiten plak, erdhi koha, të ngremë çengeljin ! (Udhëtimi)

Nga rravgimi nëpër këtë libër, mund të krijojmë vetëm një vizion të përmblendhur rreth sipërmarrjes bodleriane. Veç kësaj, çdo poemë është një botë më vete, një copendium (përmblendhje e shkurtër) i ndjeshmërisë njerëzore. Kur lexuesi e merr në duar këtë vepër, për të përfutur tek ai një ndjesi përsosurie, ndihmojnë edhe pasuria e fjalorit, trajtat e sakta sintaksore, eleganca dhe eptueshmëria e ritmit, magjia e muzikalitetit. Disa dhjetëvjeçarë më vonë, një ndër përkrahësit dhe ndër përfaqësuesit më të shquar të "poezisë së kulluar", Valeria (Paul Valéry), do t'i bëjë këtë homazh: "Në përmblendhjen *Lulet e së keqes*, nuk ka as poema historike, as legjendë; nuk ka asgjë që mbështetet te një rrëfenjë. Aty nuk të sheh syri tirada filozofike. Aty nuk nxjerr krye fare politika. Aty përshkrimet janë të rralla dhe gjithmonë domethënëse. Por aty gjithçka është magji, muzikë, sensualitet i fuqishëm dhe abstrakt... Luks, prehe dhe kënaqësi." Por kjo përsosuri nuk është as e ftohtë e as e ngrihtë, përkundrazi në të ndihen të gjitha vrullet e zemrës e të shpirtit. Tërë origjinaliteti i Bodlerit qëndron pikërisht tek ekuilibri i tendosur midis shtysave (impulseve), drithmave të ndjeshmërisë dhe shprehjes së saktë, të zotëruar shumë bukur. Një origjinalitet ideal që hedh një themel të ri, që ndërton një model estetik për tërë poezinë moderne, siç bëri Malerbi (Malherbe) për poezinë klasike.

Në qoftë se duam ta vëmë në dukje më saktësisht mjetin e veçantë për ta kristalizuar këtë origjinalitet të Bodlerit, atë do ta gjejmë te përdorimi i metaforës. Më shumë sesa alegoria, për të cilën ka një parapëlqim që e thotë hapur, por që mund të na duket një procedim arkaik që i përqs në mënyrë shumë skematike një imazh dhe një ide, metafora është figura e privilegjuar e shprehjes poetike të *Lulet e së keqes*. Tërë kuptimin dhe tërë karakterin pëllor, teorisë së bashkëpërkimeve ia jep pikërisht metafora. Kur nuk arrihet realizimi estetik, kjo e fundit mund të kthehet në një spiritualizëm të dyshimtë. Mirëpo, duke thurur vazhdimisht një rrjet jehonash midis ndijmeve që kanë origjinë të ndryshme dhe duke çliuar të gjitha fuqitë e Imagjinatës, "mbretëresha e aftësive mendore", e cila i mundëson këto përqsje të pavëna re dhe origjinale, ky parim i bashkëpërkimit na jep mundësi të rigjejmë "unitetin e thellë e të errët" të botës apo së paku të përvojës sonë. Në krijimtarinë e Bodlerit, metafora nuk është më e izoluar as e ngjitur si një zbulim apo një ilustrim i thjeshtë. Ajo përfshihet në një lëvizje apo më mirë i heq udhën kësaj lëvizjeje për rikrijimin e botës reale sipas ndjeshmërisë sonë, me anë të një rrëshqitjeje, të një lidhjeje zinxhir të imazheve që kanë një fluiditet pothuaj muzikor, mund të themi "muzikë imazhesh". Nuk është diçka e rastit, në qoftë se Bodleri e përmend teorinë e tij të bashkëpërkimeve kur flet për muzikën e Vagnerit (Wagner) te *Kuriozitetet estetike*: "Ajo që do të ishte vërtet befusuese, është që tingulli nuk do të mund të sugjeronte ngjyrën, që ngjyrat nuk do të mund të na jepnin idenë për një melodi, që tingulli dhe ngjyra do të qenë të pazonja për të shprehur idetë, meqenëse gjërat gjithmonë janë shprehur përmes një analogjie të ndërsjellë, qysh nga ajo ditë kur



Zoti e krijoj me anë të fjalës botën si një tërësi komplekse dhe të pandashme".

Ka rrezik që të mbetet një keqkuptim, i cili është bërë shkas që shumë lexime moderne të hyjnë në një rrugë pa krye. Ka prirje për ta konsideruar këtë përmblendhje si një objekt të kulluar estetik, duke lënë mënjanë perspektivën e saj morale. Në gjykimin e tij, të cilin e cituam më parë, Valeria nuk i shpëton këtij verbimi apo kësaj pakujdesie. Përkundrazi, në një listë syrealiste të autorëve që përmenden në *Manifestin e parë*, Bodlerit i atribuohet titulli "syrealist në fushën e moralit". Vlera estetike apo morale, a mund të shpëtohen këto dy orientime themelore të vepërës dhe a mund të shpërfillen njëra apo tjetra? Në kundërshtim me këtë, simbolizmi i "luleve të së keqes" vendos midis tyre një lidhje të plotë. Alkimi e fjalës, poezia e Bodlerit është dhe alkimi shpirtërore që i shndërron në bukurie edhe manifestimet më të ulëta të poshtërsisë dhe të mjerimit njerëzor që megjithatë vihen në dukje nga vetëdija dhe nga brerja në ndërgjegje. Evoluimi i idealeve dhe i dokeve rrezikon të na bëjë më pak të ndjeshëm ndaj anëve demaskuese të vepërës, duka na çuar deri në një mosnjohje të asaj ngarkese sinqeriteti që Bodleri ka dëshiruar të shprehë në të. Ajo që ai e quan mëkati, e keqja, përthirret që i drejton Satanait, që nganjëherë mund të na duken si dashamirëse, sidoqoftë dëshmojnë për mendjekthjellësinë e tij para thellësive të maskuara të natyrës sonë, të cilat artisti jo vetëm nuk duhet t'i mohojë, por duhet t'i shohë pa i dridhur qerpiku. Tonet e tij më patetike, a nuk i ka arritur Bodleri përmes ballafaqimit të dhimbshëm midis dëshirës për të qenë i lumtur dhe mendimit të ngulmët, sado objektiv qoftë ai, që ka për mëkatin, midis idealit të bukurisë dhe ndjenjës së tmerrit që është shpërndarë kudo? Kështu, duke iu drejtuar një qenieje të paidentifikuar, por që mund të jetë jeta ose Njerëzimi, ai ka të drejtë të thërrasë në një varg të tillë të skicës që do t'i shërbente si epilog i librit *Lulet e së keqes*:

Ti më dhe baltën tënde, me të bëra flori.

Libri *Poema të vogla në prozë* është një pjesë plotësuese e domosdoshme e përmblendhjes *Lulet e së keqes* për vlerësimin e origjinalitetit poetik të Bodlerit dhe të modernitetit të tij. Përtej kundërvënies së dukshme midis vargut dhe prozës, gjirja poetike midis këtyre dy veprave është sinjali i metamorfозës shumë të rëndësishme që do të ndodhë në poezinë franceze në fund të shekullit me shpikjen e vargut të lirë dhe në mënyrë më të përgjithshme, me të drejtën që fituan përfundimisht poetët për të qenë të lirë të zgjedhin mënyrën e tyre të shprehjes.

Gjithçka që është shprehur në vargje mund të shprehet në prozë dhe anasjelltas, apo më mirë, veçoria e poezisë nuk do të kufizohet më me një detyrim formal të pararendosur, por sipas frymëzimit, ajo mund të shpaloset në të gjitha mënyrat e mundshme të ligjëritimit. Në qoftë se për të bërë dallimin midis këtyre dy veprave të tij, Bodleri mbështetet ende te kjo kundërvënie shekullore, por ai është i pari që e kapërceu atë, duke treguar se proza mund të rivalizojë me vargëzimin në shërbim

të së njëjtës ndjeshmëri dhe me efekte që, ndonëse janë të ndryshme, kanë një fuqi të barabartë përjetimi. Pa dashur të themi se Bodleri ka qenë i pari që e ka demonstruar karakterin poetik të prozës - mund t'i gjejmë paraardhës të mëdhenj si Rusoi (Rousseau) apo Shatobriani (Chateaubriand), megjithatë duke iu referuar burimit të cituar prej tij, librit *Gaspari i natës* të Aloizius Brertranit (Aloysius Bertrand), duhet të pranojmë se ai është i pari që ka formuluar projektin e shkoqitur (explicite) për të shkruar në "një prozë poetike, muzikore, pa ritëm e pa rimë, mjaft të rrjedhshme dhe mjaft të hallakatur për t'iu përshtatur lëvizjeve lirike të shpirtit, valëzimeve të ëndërrimit, tronditjeve të forta të ndërgjegjes."

Pra, duke qenë muzikore, proza e librit *Poema të vogla* krijon dhe bart imazhe, është "muzikë imazhesh" dhe natyrisht është vazhdimi i ciklit "*Tablo pariziane*" të përmblendhjes *Lulet e së keqes*. Një vazhdim i dyfishtë, meqenëse Bodleri kishte menduar të bënte një botim të ilustruar të kësaj përmblendhjeje, duke i shkruar mendja te gravurat e Merionit (Meryon) dhe te botuesi Hecel (Hetzl); nga ana tjetër, ai është mëdyshur për një kohë të gjatë për t'i vënë titullin *Poema të vogla në prozë* apo *Splini i Parisit*. Pra, uniteti midis këtyre dy përmblendhjeve është i dukshëm, ca më tepër se Bodleri e ka shprehur shpesh dëshirën që ato të jenë "vazhdim" i njëra-tjetrës. Madje disa poema në prozë janë si përshtatja e barasvlerësit (ekuivalentit) të tyre në vargje në përmblendhjen *Lulet e së keqes* (*Ftesë për udhëtim, Muzgu i mbrëmjes*). Në mënyrë më të përgjithshme, shumë tema janë të përbashkëta: magjia dhe zvetënimet e Femrës, ideja e ikjes së Kohës që nuk të shqitet nga mendja, ëndërrimet nostalgjike për lumturinë. Megjithatë, po të kemi parasysh tematikën e re dhe të veçantë që sjellin këto *Poema të vogla në prozë* ku mbizotëron dekorimi i Parisit, risia e kësaj vepre del në pah dhe e ilustron më së miri nocionin e modernitetit. Si njeri që i njeh shtresat e ndryshme të popullsisë, në këtë libër, Bodleri i jep jetë një morie personazhesh që përfaqësojnë disa anë të prizmit të fatit të njeriut bashkëkohor. Varfanjakë e lypës, vejtash dhe pleq, punëtorë dhe prostitutat, akrobatë dhe marrokë e mbushin me mjerimin e tyre të shumëfishuar këtë kuadër njëherësh të neveritshëm e madhështor ku, më shumë se kurrë, pasuria e fyen fatkeqësinë. Duke qenë vetë personazh i kësaj komedie satanike, Bodleri paraqitet në skenë si vëzhgues i vëmendshëm, si artist zemërdhembshur apo sarkastik dhe ndoshta si moralist. Duke u nisur nga disa vëzhgime apo nga një anekdotë, disa tekste shtjellohen si fabula apo si mite duke e ilustruar për mrekulli konceptimin e tij alegorik për ekzistencën (*Secili ka kimerën e vet*).

Në krijimet e librit të tij *Poema të vogla në prozë*, të cilat qëndrojnë midis përshkrimit thujse gazetaresk të një kronike të zezë dhe shprehjes së një lëvizjeje të kulluar të ndjeshmërisë, midis të rëndomtës dhe sublimes, midis piktoreskes dhe përditësisë banale, Bodleri shpalos tërë paletën e "një piktori të vërtetë të jetës moderne".

Një diell i shkëlqyer janari. Ne udhëtojmë drejt Prezës. Hera e parë që shkel aty. E kam parë dhe kam ndier një lloj krenie për lartësitë sesi na sheh, me një lloj mendjemadhësie. Po edhe vendosja aq mbizotëruese gati mbi aeroport është sfiduese. Preza fërgëllon. E di. E ndiej. Duke hyrë nëpër kthesat drejt mendjemadhësisë së saj eksituese, duke kaluar burimet, rrugën e bukur, kalanë që vështron gjithçka në mënyrë sfiduese, takimi me Zotëri Kujtim Xhepa, një mësues i vjetër dhe po ashtu, duke pasur pranë edhe piktorin Buron Kaceli, duhet të dëgjoja se ku do të dilte edhe mësuesi i dikurshëm i këtij vendi, Shefqet Billa (bashkë me të edhe Billa e famshme!), i cili, nuk di pse i ka hipur të mendohet thellë këto ditë... Preza s'e kishte ndier fare ajrin e natës së kaluar dhe shihte me sytë e kalasë së saj, si përpara pasqyrës, ndalet një çast dhe i hedh vetes një vështrim mekanik. Pastaj, si monton instinktivisht një buzëqeshje në fytyrë, bën poshtë herë nga Palaqi dhe herë nga Ahmetaqi. Madje, ky i fundit, atje në këmbë të kodrave ka shpallur pavarësinë...

- Çfarë të ka bërë përshtypje në Prezë në fillim kur erdhe mësues matematike në gjimnaz? - pyes Shefqetin. Ai nuk ma zgjat shumë dhe thotë:

- Tri gjëra: Nuk gjeta asnjë copë letre nëpër rrugë, as sot nuk gjen, jam i sigurt. E dyta nxënësit lexonin shumë libra dhe e treta bënte dhe bën verë të mirë. Enol. Prodhim Preze.

- Po emri?
- Emrin ta shpjegon Kujtimi.
Ndërkaq Nefaili që bënte fotografitë, mbante si përveshur një buzagaz të lehtë ironik.
- Nuk jam kompetent, thotë Kujtimi, por e prera, pres, janë rrënja e tyre.

Një grup vajzash të shkollës veshur bukur, ndonëse thjeshtë, duke sjellë pranverë, aq më tepër nën këtë diell të mahnitshëm, gati për të çelur mimozat e bymyera nga trallisja. Një plakë e imët tek të shtatëdhjetat, me një përzemësi tepër të këndshme, një ëmbëlloshë, që i ruante ende tiparet, na përshëndeti gati të na përqafoje, duke vënë re se Preza rrallë buzëqeshte. Më tej një burrë i pashëm e shtatëdhjetë, i zbrazët dhe serioz, me një lloj ngjashmërie të çuditshme me ish-mësuesin e shkollës, pastaj një grua në moshë, pak e kërrusur, e cila, me një hir të përsosur, mbante një fustan me shall të bardhë, mbushur me pika të kuqe. Kishe dëshirë të endeshe nëpër rrugët e Prezës, sidomos për mua që isha aty, për të hyrë në thelbin e gjërave. Sëmundja e ditës? Dihet: shpopullimi i tmerrshëm. Në gjendjen civile kemi 7200 vetë, thotë Kujtimi. Edhe kur e dëgjojnë pak më tej një grup burrash me pamje serioze, zotërinj pa dekorata, disi fytyrëzbehtë e të heshtur, kurse më tej akoma ishte një grup tjetër, të rinj me mjaft energji, midis të cilëve binin në sy dy vajzat kameriere të lokalit të kalasë. Pastaj aty vinte edhe zëri i hoxhës në xhami, përshëndetja me përkulje të thellë e Nefailit, vilasi me pamjen e ankthshme të një të dashuruar, mu për shkak të diellit, na mbushi me tjetër shpresë...

Shkolla dhe biblioteka e saj me tendencë për të qenë e komunitetit dhe e shkollës, por pa ngarkesën e duhur me libra! Atëherë ky vendim i çastit vjen në kohën e duhur. Do të vijin librat për pak ditë. Librat i dhurojmë ne, një botues dhe një tregtar i madh, një ish mësues matematike, duke e mbajtur librin dhe matematikën në një peshë të ekuilibruar dhe me një dashamirësi të thekshme.

- Tek Enol, aty do ta mbajmë frymën!
Enol është kantina e verës dhe restoranti. I mbushur me lule dhe diell, me foto të mbretit dhe diku edhe ajo e kryeministrit, me një hije sigurie të vetë bujtinës, ndonëse pa libra.

- Po pse edhe libra do të kemi në bujtina?...
- E vendosëm, - i thashë Shefqetit të Billës, Qetit, si një çështje pune për të nesërmen, duke ecur rëndë-rëndë, me duart pas shpine, të bezdisur fort nga veshjet e rënuara të cilat po na i hiqte dielli.

Në janar nuk ka si dielli. Ka një dritë të çuditshme. Si nuk pamë një panel diellor, të cilët në vendet tona përplot diell janë bërë modë.

- Po ne pse s'kemi?
- As kemi dhe as kemi për të pasur, derisa edhe diellin duan ta monopolizojnë dy-tre

PREZA FËRGËLLON E EMOCIONUAR NË DIELL

Reportazh nga Xhevair Lleshi

vetë. Dihet, është e thjeshtë: diellin na e ka falur Zoti, le ta shfrytëzojmë këtë pasuri të jashtëzakonshme, me potencën tonë, me ndihmën e shtetit, të bankave dhe të njerëzve të iniciativës private për të qenë në krye të progresit.

- Po, dielli është pasuria jonë dhe zhvillimi ynë!

- E? Po paret a nuk do t'i nxjerrim nga dielli? Mikpritësit tanë dhe të diellit po ashtu, në këmbë pranë derës, ia kishin dalë të përshëndesnin çdo të porsaardhur, ndërkohë që mbanin gjallë bisedën me grupin e personave me pamje serioze, me atë afshin dhe të folurën e vet me gjallëri prej banori të Prezës. Ai u shtrëngonte dorën, u drejtonte fjalë dashamirëse e të ëmbla. Astrit Subashi. E veçantë ishte buzëqeshja e tij, me një fytyrë të vogël, me një pamje tërheqëse, ulej e përkulej tërë nderim, por, në krejt personin e tij hollak, dinak e bardhosh, ajo çka dallohej më mirë, ishte njolla e hijshme e shallit kamerieror në brez e që të binte fort në sy.

Sapo miqtë vunë këmbë brenda, menjëherë u ndje të ngrihej një mërmërimë admirimi dhe mahnitjeje. Sikur hyri e gjithë Preza të qe dyndur, ashtu siç është, vërtet hyjnore. Mbi pjesën e poshtme të Palaqit, zbuluar nga një tunikë dielli të shndërruar në të gjelbër të çelët dhe rrethuar me një garniturë e madhe vjollcash, ku disa buqeta, lidhur me varg dredhësh fiksojnë një kohë të çuditshme. E tillë ishte luginëza me brezare dhe vreshti përballë diellit.

Me krahët e zbuluar te shpatullat, Preza e re dukej sikur kishte dalë krejt lakuriq nga këllëfi i saj prej tyli nën rrezet e diellit, si një nga ato nimfat që dalin prej përrënjev të shenjtë; me qafën e bardhë, liqenet e krijuar si ai i Shargës, së arratisur në Vorë, me trupin e zhdërvjellët, teksa dukej se është aq e lumtur prej gjysmë lirisë së vet, saqë vështrimi pret gjithmonë që të shohë pak e nga pak ashtu siç është dashuruar marrisht me trupin e saj. Edhe Preza kështu ndihet. Krehja e flokëve të saj të bukur e të verdhë, të mbledhur në formë kaskë, në të cilën zgjatet një degë dredhke, mbajtur nga një nyje vjollcash, bën të rritet edhe më shumë lakuriqësia ndaj rrezeve të mahnitshme të diellit, duke zbuluar qafën e bardhë të hijezuar lehtazi nga fije floku të cilat ngjanin si fije ari. Në çdo rrugë, në çdo mur, në çdo dritare. Qafa e Prezës stoliset me një gjerdan përplot kthjelltësi të mrekullueshme, kurse në ballë i bien ca fije argjendi stërpikur me diamante. Dhe ec të mos e duash Prezën...

Të ftuarit e sotëm në Prezë kishin nxituar për të zbritur aty, ndaj dhe gulçonin pak.

Sytë e saj, të cilët dimri tenton t'i mbushë me hije, picërrohen përpara atij fluksi të beftë drite, duke i dhënë disa fytyrave mëdyshëse e të pasigurta si prej miopie, e cila ia shton edhe më shumë hirin e saj rrëzëllor.

Me ta vënë re, mikesha Enol ngrihet menjëherë, vrapon drejt Prezës dhe ia shtrëngon fort të dyja duart dhe, duke e përpirë me sy nga koka të këmbët, mërmërit me një zë të butë:

«Preza e ka kombinatin e prodhimit të energjisë diellore dhe eolike, nga më të mëdhatë në vendin tonë. Shiko sa faqe kodrash vriten nga dielli dhe era i rrëmben kokën. Këtu janë dy perëndi, njëra dielli dhe tjetra era që na puth në ballë. E si të mos ndihemi aq të pasur? Ne jemi kanakarët e diellit dhe të erës...»

Pastaj dreka. Po çfarë dreke se! Vera një mrekulli, gatimi prej fisnikësh...

- Ne të Enolit e kemi kuzhinierin me trashëgimi *Dajti*, jo të malit por të hotelit aristokratik!

U pa një lëvizje e madhe ku të gjithë të ftuarit shkonin për t'u përshëndetur me bukuroshen e diellit, siç e kishin bërë zakon ta



thërrisnin mes tyre. Dielli i bukur i janarit ua shtrëngon dorën pothuajse të gjithëve, pastaj përqafoje, duke ndenjur në këmbë, i buzëqeshur, duke dhënë përshëndetje majtas e djathtas, duke ngritur lehtë krahët e bukur, përpara rrethit të atyre mbushur plot kureshti, ndërsa ia ngulnin sytë gurëve të çmuar që iluziononte dielli dhe erashka e erës me bizhutë në ballë dhe që ua trazon qetësinë dhe përmbajtjen e mirësjellë, kujtdo mysafiri në mënyrë më të të zakonshme, duke mos i rezistuar dot tundimit, që herë afrohet, pa ia shqitur sytë diellit dhe herë largohet duke ndier një nuancë xhelozie.

- Kjo qenka Preza, gjerdan qytetarie, me rrugët pa një fill letre, me ujën më të mirë e të shëndetshëm, me erën që i mban sytë sa nga mali edhe nga deti. Apo jo?

Buron Kaceli bën një shenjë pohuese. Atëherë miqtë nuk i kursejnë komplimentet për portretin e Shefqet Billës dhe i derdhin lumë lavdërimit. Preza u mbush me libra, u bë magjepsëse, hyjnore; më pas u lëshuan për të folur, me një admirim plot zili, për shijen që lë pas libri në bibliotekë dhe nëpër raftet shtëpie, por edhe duke u shprehur të pakënaqura që këto vajza të bukura prezake, që hiqnin prej vetes gjërat më të bukura, e që së shpejti nuk do të kishte më diamante as për bukuritë e vërteta. Duket i kishte rrembyer dielli dhe era (edhe energjia diellore dhe ajo eolike!) që të ndienin nëpër lëkurën e tyre të ethshme e të famshme, që ndoshta do t'u pëshpëritnin në vesh skandalet e tyre fisnike.

Mirëpo, grimasat në fytyrën e Prezës e tradhtonin, duke zbuluar një lloj kënaqësie të thellë, të fshehtë. Dhe zinte të vështronte me bisht të syrit dy sipërmarrësit e bujtur në fshat, të cilët qëndronin disa hapa më tej, këndshëm mbështetur pa tekllif te supet e diellit, duke i folur me zë të ulët, sikur të qe shok i tij, duke vënë buzën në gaz, gjithnjë të përmbajtur. Ndërkohë bisedat fituan gjallërinë e tyre, përplot ëndje që gjatë momenteve të qetësisë, ndiheshin, prapa mureve, zhurmat e lehta që madhërisht e dalëngadalë, të krijojnë gjendje artistike prej të ftuarish, përpara të cilëve të gjithë bëhen urë me një përlulësi të madhe. Pas tyre vijin të ftuarit e vërtetë, njëri pas tjetrit, dhe, në fund fare, Shefqeti, Buroni dhe Kujtimi, po edhe unë me Nefailin, duke tundur krahët dhe gëzimin e tyre të brishtë. Ndoshta fajin e kishte vera...

Dhe, në atë orë, në fakt, në mes të diellit të mahnitshëm të janarit, me një tonalitet disi të errët (dhoratë përvëluese!), i cili mbyty zhurmën e hapave, tryeza jonë, e rrethuar rreth e rrotull prej karrigeve me shpinëza të zeza, ngjanin si një altar, ku, përmbi bardhësinë e shndritshme të mbulesës, lodrojnë xixëllimet shkëlqimtare të kristaleve diellore prej Preze dhe janari. Domosdo, sytë nuk kishin si të mos ktheheshin nga dielli dhe vetë Palaqi që shkëlqente dhe s'kishin si të mos mbushej me

atë magji mahnitjeje. Një diell i pashfrytëzuar, që po të na dëgjonte do të varte buzët prej mërzisë, por ama një diell i bukur ndrinte në faqet e tij të gdhendura dhe zinte belin, duke u bërë një grup qeniesh mitologjike që rrëmbejnë disa nimfa, kurse sipër grupit tonë, si mysafirë të Prezës, kësaj natyre të paimagjinueshme e me plot kulturë mjedisore dhe prej librash natyrisht, duke dalë nga një bri i gjerë, një buqetë e madhe me lule natyrore, ja tek na varet përsipër. Në të dy skajet, ndodhen edhe vazo me lule, që lidhen me grupin qendror dhe që secili është bërë plotësisht një qenie mitologjike që vrapon, duke mbajtur në njërin nga krahët e tij një rreze dielli, kurse në tjetrën erën me shumë degëzime, duke shtuar ndriçimin e rrezatimit të fuqishëm...

Midis tyre, të sapo të ftuarit, që u buzëqeshin miqve në krah të tyre, futen brenda, mezi arrijnë të përmbajnë një lloj lumturie të ëmbël. Lulet hedhin një lloj freskie në atë ajër paksa të ngrohur, ndërkohë ndihen sesi kundërmimet e ëndshme enden të përziera me aromat e luleve të freskëta. Por është edhe aroma e athët e agrumeve, mu në kohën kur mysafirët gjejnë shëndetet, librat, emrat e shkruar në anën e prapme të kartëvizitës, ndjen një zhurmë të lehtë që vjen si pëshpërimë nga lart, si dhe ngjeshur brenda shpirtit me bardhësinë e tyre qumështore, duke shtuar më tej edhe vegimin e tryezës së shtruar me rreze dielli të janartë dhe me klithma të buta ere që vijnë nga deti deri mbi Ishëm...

Dhe dreka merr udhë mes buzëqeshjesh të ëmbla, që s'shterojnë, majtas e djathtas, të shkëmbyera me njëra-tjetrën, në një gjysmë heshitjeje, që thyhet vetëm nga tingëllimi i butë i zërit të autorit të këtyre radhëve prej romanit të tij «Tërbimi», mbushur edhe me shurdhërinë e vërtitjes së hareshme të pirunëve.

Enoli i Qemal Alushit, pronarit të kantinës dhe të bujtinës, na bëri t'i kryejmë detyrat e qëndrimet më serioze prej miqsh, përveç aktivizimit dashamirës të gjithçkaje tjetër, përgatitur mbi tryezën e shërbimit, ku bënin ngadalë xhiron prapa të ftuarve të ulur në tryezë, duke mbajtur një pjatë plot diell në njërin dorë dhe duke u dhënë me një shqiptim me gjysmëzëri titullin e librit më të ri. Të tjerët hedhin verën Enol, kujdesen edhe për kanat e verës, për ndërrimin e pjatave që bëhej kujdeshëm e ngadalë, në mënyrë që të qeshurat të mos arrinin të bëheshin më të mprehta, përndryshe dielli i Prezës do të mërzitej keq. Dhe s'ka më keq se zemërimi i diellit...

Dhe ja, dielli, ulur në mes të tryezës, në të djathtë tonë, ndërsa në të majtë zonjat *erë* dhe *amë*, tani në pension, paksa i dobët, por me rëndësi, të cilin Shefqeti, Buroni, Nefaili dhe Kujtimi, ulur përballë, i drejtohej me një zë ledhatar, rrëfimit të legjendës së diellit dhe të erës mbi Ishëm, në grykën e Vajes, zënë vend mes personazheve më të shquar të kësaj dreke.

Atëherë besimi duhet të dalë fitimtar.
- E sa banorë ka sot Preza? - s'u mor vesh se kush pyeti.

- Epo, do ta themi me hamendje, sepse edhe 'Istati' nuk na ka dhënë asnjë shifër. Po, ja aty tek tremijëshi të themi...

- Mos! Më pak se gjysma...

- Ehu! Po ikin njerëzit babale!

- Babale?

- Lëre mo, gaztrole!

Në të dy ekstremet e tryezës, mund të shikoje drejt Prezës dhe kalasë së saj, ku lodron dielli, ngatërruar me zërin e hoxhës, të cilin e ndihmon të shumëfishohet fuqia e elektricitetit, hedhin ca vështrime si të dëshpëruara në të djathtë, të cilën, me sa dukej, nuk po e përballonim dot. Pak e nga pak, zunë të shpërthejnë në të qeshura me zë të lartë. Që nga ky moment nisnin edhe zhurmat e gëzueshme të një hareje që absolutisht s'përmbahej dot më tej. Gëzonim ne, me siguri që gëzonte edhe Preza.

Sidoqoftë, Buron Kaceli me mirësjellje u ngrit e tha:

- Do ta kemi kënaqësinë ta shohim edhe herë tjetër diellin e Prezës! Në përfundim do ta kem gati peizazhin e këtij vendi të mahnitshëm e magjik!

U larguam nga Preza, nën hijen e fërgëllimës së saj për diellin e janarit.

DY NETË PARA SE TË FESTOJA 72 VJETORIN

ulur këtu në një natë zhegu përvëlues,
ndërsa
pi një shishe kabernet shavinjon
pasi kam fituar 232 dollarë në garat me
kuaj.
nuk kam shumë gjëra për t'iu thënë, veçse
po të mos ishte kjo këmba ime e djathtë,
kaq e pabindur,
nuk do të ndjehesha ndryshe nga sa jam
ndjerë
30 apo 40 vjet më parë (dhe për më tepër
tani kam më shumë para dhe mund
të siguroj një varrim
dinjitoz) gjithashtu
ngas makina më të mira dhe
nuk ngarkoj më
thika automatike.
jam ende në kërkim të një heroi, të një
heroi model
por nuk kam gjetur asnjë.
nuk jam më tolerant ndaj Humanitetit
nga çkam qenë ndonjëherë.
nuk jam i mërzhitur me veten, përkundrazi
gjej forca
për të qenë i vetmi që rikthehet
në kohët e
krizave.
kam qenë gati për të vdekur me dekada të
tëra dhe
ushtrohesha dhe përsosësja
për fundin,
por bën kaq shumë
nxehtë sonte
dhe nuk arrij të mendoj aq shumë, por
ky kabernet i shkëlqyer
është i mjaftueshëm për mua.
nganjëherë nuk e besoj as vetë
si kam arritur gjer këtu
ky duhet të jetë një lloj mallkimi perëndie
kthyer në mrekulli!
vetëm një tjetër djalosh plak
duke pasqyruar forcën
duke buzëqeshur pak
ndërsa qytetet dridhen dhe dora e tij e
majtë
ngrihet
mund të shtrëngojë
diçka
reale

KANCER

gjysmë njeriu dhe askund
vetëm fillikat
dëgjoj si rroposet
kështjella brenda meje

i ngecur
në orën
më të errët

humba dhe
lojën e fundit

tani
zgjatem
drejt

kockave
dhe heshtjes

PLAK

jam plak por nuk e ndiej
ende
jam si një tank
që shkel me rrapëllimë
mbi mutin
e grumbulluar
prej kohësh
dhe vazhdimisht
ai mut
fizik dhe shpirtëror
shtohet dhe bëhet mal
ne vazhdojmë të ndotim



dhe stratosferën
mbeturinat hapësinore
notojnë
rreth e rrotull
poshtë
lart
aty
këtu

kujtoj gjyshen time
tepër të moshuar
nje masiv mishi i padobishëm
me sy të vdekur
dhe me një mendje
të mbushur
me mut

ajo më shkaktonte lodhje
isha i zhgënjyer
teksta e shikoja
ashtu

unë jam ende mish i lakmuar
më ndjekin qentë e zinj të vdekjes
më kafshojnë thembrat
janë kaq të mërzhitshem dhe
s'më ndahen kurrë

kur të më vënë poshtë
ata do të festojnë
trofenë
e përpjekjeve të tyre.

vajza të reja
prej vendeve
të largët
do të më
qajnë
dhe kjo është
një e drejtë e tyre

dhe ferri do të jetë për mua diçka e re dhe
interesante

MENDJA DHE ZEMRA

pashpjegueshmërisht ne jemi vetëm
përgjithmonë vetëm
dhe ishte menduar
të ndodhte kështu
nuk ishte menduar
të ndodhte ndryshe
dhe kur beteja e vdekjes të fillojë
gjërat e fundit që dua të shoh
janë:
një unazë fytyrash njerëzore
që më vjen rrotull
miqtë e mi të vjetër

ata më të mirët
dhe muret e vetvetes
s'dua tjetër të pranishëm

kam qenë vetëm, por rrallë
i vetmuar
e kam shuar etjen
në pusin e vetvetes
dhe ajo verë ishte e mirë
më e mira që kam shijuar ndonjëherë dhe
sonte
i ulur
ia ngul sytë errësirës
dhe i kuptoj më në fund;
errësirën dhe dritën
dhe gjithçka
midis

paqja e zemrës dhe mendjes
vjen
kur ne kuptojmë
ç'është ajo;
ka ekzistuar
dhe më parë
në jetën tonë të çuditshme
në lojën e kotë
të ditëve
merrni ç'të merrni
nga gëzimi
dhe gjithçka tjetër
lëreni pas

mos qani për mua

mos u trishtoni për mua

lexoni
çkam shkruar
pastaj
harrojini
të gjitha

pini nga pusi
juaj
dhe filloni
përsëri

POEZI E VJETËR

kjo është një poezi e vjetër
e një djaloshi plak.

keni kaq kohë
që e keni dëgjuar

jam ulur këtu
sërisht
i dehur

tavlla plot

shishe rreth e rrotull

poezi të shpërndara
në dysheme

ndërsa nata shkon drejt agimit
unë bëj të njëjtën punë
shtyp e shtyp
me gabime
dhe

bulkthat kanë kohë
që flenë

baret
janë mbyllur
gjithashtu

Li Po duhet t'i ketë kaluar
të gjitha këto përvoja
si unë

përsëritje, Li Po, ti
provues i krisur
i barërave dehëse
bota vazhdon të jetë
e mbushur plot
me zemërim
dhe
dëshpërim mbyttës

ti e dije mirë ç'duhej bërë
me poezinë
i vije zjarrin
dhe e lije të lundronte
poshtë në lumë
ndërsa perandori qante për këtë
humbje

(por ti dhe unë
e dimë fare mirë
se kjo është
pjesa më e natyrshme
e kësaj loje)

dhe ky çast është
tani
dhe
për fat
kam një pije
atje majtas
në dysheme
midis poezive
përmes tymit
bie mbi tavell
bytha më digjet
vetullat më përzhiten
kërcej jashtë
marr tjetër drejtim;
koktejl poezia!

dhe më vjen një zë
nga muri ngjitur
" TË QIFSHA TY
ME GJITHË MAKINËN E SHKRIMIT"

janë të shumtë
pacientët
që më shajnë kështu;
është ora 3:45 e
mëngjesit

por unë nuk ndalem
duke shtypur
kam për të shijuar
dhe këtë pije
të fundit,
sepse prej kohësh
e kam mundur vdekjen
të paktën
10.000 herë.

departamenti i policisë së Los Angelesit
një tjetër
problem

Gabriel García Márquez: Ndoshta e kanë marrë si shaka të hidhur, apo të ëmbël... por besoj se *Njëqind vjet vetmi* është një *vallenato*¹ 450-faqëshe. Dhe e them shumë seriozisht. Estetikat janë të njëjta, koncepti është i njëjtë, burimet janë të njëjta: historitë e pazakonta që kanë humbur, kanë humbur në harresën popullore. *Dashuria në kohërat e kolerës* është një *bolero*² 380-faqëshe dhe e kam shumë seriozisht. Kur askush nuk e dinte se ç'ishin këngët vallenato, kujtoj, atëherë kur isha fëmijë e shkoja të dëgjoja firzarmonicistët e ardhur gjatë festivaleve, pasi kjo është origjina e muzikës vallenato... ishin muzikantë endacakë të cilët udhëtonin nga një qytet në tjetrin, duke kënduar për një ngjarje që kishte ndodhur diku gjatë. Ishin gazeta udhëtuese të shoqëruara me fizarmonikë.

Në fillim, çfarë më interesonte më shumë ishte historia që tregonin; muzika jo dhe aq. Por, më pas, për mua, historia, faktet – dhe jeta e rajonit – gjithmonë qe e lidhur me muzikën. Kam përshtypjen se nga të gjithë librat e mi, ai që i përmbledh më mirë Karaibet është *Për dashurinë dhe demonë të tjerë*. Te *Dashuria në kohërat e kolerës*, qyteti [që portretizonte] autenticitetin karaibian nuk është aq i theksuar [sa te] *Për dashurinë dhe demonë të tjerë*. Në fakt, nëse ka ndonjë libër timin në të cilin mund ta shohësh se si janë vërtet njerëzit nga Karaibet – një përzierje e shumë racave nga e cila ka dalë një kulturë e re – është ky libër.

Edhe pse *Për dashurinë dhe demonë të tjerë* është vendosur në Kartagjenë, Kolumbi, unë e shoh si shumë kubane, me eksperiencat dhe mënyrat e jetesës që ekzistojnë ende.

Nuk thuhet askund në libër se qyteti është Kartagjena – dhe nuk është thjesht rastësi. Më intereson pasiguria, doja vetëm ta qartësoja se libri zhvillohet në secilin qytet në Karaibe. Nuk e kisha trajtuar kurrë përbërësin afrikan të kulturës së Karaibeve aq pranë sa në këtë libër. Në Kartagjenë – për shkak të kushteve të veçanta të periudhës koloniale dhe kushteve shumë të veçanta të kolonializmit spanjoll – këto kultura nuk ngjiten, ose nuk u ruajtën aq mirë sa në Kubë. I gjithë informacioni që është në këtë roman nuk mund të ishte marrë vetëm nga Kartagjena... dhe ndoshta në asnjë qytet të vetëm në Karaibe.

Është një çështje që unë e ngre dhe që askush nuk dëshiron t'i kushtojë rëndësi, ama Karaibet nuk janë një zonë gjeografike, por kulturore. Nuk mbulon vetëm detin e Karaibeve. Për mua fillon nga jugu i Shteteve të Bashkuara – gjithë çfarë është Luiziana dhe Florida – dhe shtrihet deri në Brazilin verior. Nuk është një territor gjeografik, por një territor kulturor.

Kam marrë elementë të kulturës afrikane të trupëzuara në Karaibe

Në bashkëpunim me regjisorin e dokumentarëve Jon Intxaustegi, gazeta *El País* paraqet një pjesë nga një intervistë me fituesin kolombian të çmimit Nobel ku ai diskuton mbi muzikën, Karaibet, paratë, dashurinë, librat dhe idetë.

Një intervistë e pabotuar me

Gabriel García Márquez:

NDOSHTA MITET PËR MUA JANË MË INTERESANTE SE JETA IME

Fragmentet në vijim janë pjesë e një bisede me të gjerë me Gabriel García Márquez, të cilën e kam regjistruar më 6 maj 1994, në Havana, Kuba, me pjesëmarrjen e gazetarit të ndjerë Mauricio Vicent. Shkrimtari kolumbian, 67 vjeç në atë kohë, foli hapur, duke zbuluar plotësisht dhe emocionalisht veten e tij. Sapo ishte botuar romani i tij *Për dashurinë dhe demonë të tjerë*.

Në këtë intervistë – e pabotuar deri tani, dhe versioni i plotë i së cilës gjendet në numrin 117 të revistës kulturore *TintaLibre* – fituesi i Çmimit Nobel në Letërsi në vitin 1982, diskuton mbi muzikën, Karaibet, paratë, dashurinë, librat, dhe idetë.

nga Brazili dhe Kuba, dhe e gjitha funksionon si të ishte nga Kartagjena. Unë kam lindur në Aracataca – që është një qytet kolombian në brendësi, por jo dhe aq, prapëseprap është karaibian i pastër – dhe ky është një rajon jo vetëm i Kolumbisë por i të gjithë Karaibeve, kulturat e të cilit përcaktohet thelbësisht nga muzika.

Qyteti më karaibian ndoshta është Panama. Aty ku i ndien vërtet Karaibet është në Panama; e ndiej

ekologjikisht, e ndiej në mënyrën se si trupi im fillon të ndihet në paqe në mjedisin ekologjik të Karaibeve. Kjo më ndodh lehtësisht kur kthehem nga Europa, në ndalesën time të parë në Karaibe. Zbres nga avioni, marr frymë dhe menjëherë jam njeri tjetër. Besoj se kjo është diçka e pa studiuar mjaftueshëm: deri në ç'pikë është kushtëzimi ekologjik në jetën e qenieve njerëzore thelbësor.


A është e vërtetë se me pesot e para që fituat, bëtë në një udhëtim me anije në Karaibe?

Do të ishte e mrekullueshme të mblidhja të gjithë mitet që ekzistojnë për mua, sepse ndoshta janë më interesante se jeta ime!

A mund të jeni ju ai që i inkurajon këto mite?

Epo le ta shohim: teksa po shkruaja *Vjeshta e Patriarkut*, në Barcelonë, papritur qe një çast kur kuptova se e kisha lënë pas mjedisin tim ekologjik. Kishte gjëra që nuk i ndieja më: kisha harruar ngjyrën e detit, aromat. Zbulova se nuk mbaja mend gjëra të caktuara, gjëra të cilat më nevojiteshin për të shprehur realitetin. Emocioni, ndjesitë, vetëdija e nga vija nuk mungonte kurrë, sepse kudo që është shkrimtari, mban botën e tij; poeti e mban botën e tij dhe kudo që ta vendosin – në Polin e Veriut apo të Jugut – e mban brenda vetes. Por nuk mund të mbaja mend se si ishin disa gjëra: aromat, tingujt, temperatura. Është shumë e vështirë ta imagjinosh të ngrohtin kur është ftohtë, dhe anasjelltas.

U shqetësova shumë, sepse romani kishte ngecur. Kështu, bëra një pushim dhe shkova në një tur që më shpuri në Santo Domingo. Dhe nga Santo Domingo, shkova teposhtë gjithë harkut të Karaibeve deri në Kartagjenë dhe rimora çdo gjë që më duhej, gjithë karburanti që më duhej për të shkruar këtë libër. Nuk bëra asnjë shënim: ishte thjesht një çështje jetese, vazhdimësisë së saj, të vizituarit të çdo ishulli një nga një, pa bërë absolutisht asgjë përveçse thjesht të vështroja. Dhe nuk m'u desh të shpenzoja një vit për këtë: ishin tre ditë këtu, një javë atje. Kur u ktheva, libri rodhi deri në fund. Thjesht isha kthyer në thelbin tim. Por kjo është



Nga e majta në të djathtë, gazetari Mauricio Vicent, regjisori Jon Intxaustegi dhe Gabriel García Márquez, gjatë intervistës në Havana, Kubë, 1994.

1 Këngë popullore kolombiane.
2 Këngë romantike kubane.

ndryshe nga të harruarit... sepse nuk ndalon kurrë se qenuri andej nga je.

Dhe gjatë netëve tuaja në Barcelonë, çfarë bolerosh dëgjonit?

Dëgjoja disa bolero që nuk ishin aspak nga Karaibet: ishte Bach, prej një origjine po aq popullore. Në fund të ditës, e gjithë muzika — muzika kulturore dhe muzika popullore — kanë të njëjtën origjinë në këngë popullore. Ka një fotografi kompozitori hungarez Béla Bartok që është thellësisht prekëse: shfaqet me një nga ato fyejt cilindrikë, duke mbledhur rrëfime nga fshatarët e Transilvanisë, nga toka e Drakulës. Thuajse e gjithë muzika e tij ka atë origjinë popullore — ashtu si e Bach-ut, ashtu si vallenatosat, si dhe shumica e letërsisë së Karaibeve. Muzika, për mua, nuk është vetëm muzikë klasike apo vetëm popullore... vetëm [pasi dëgjoj shumë prej saj] filloj të veçoj zhanret që më pëlqejnë më shumë dhe ato që më pëlqejnë më pak. Por nuk mund të thuash se muzika klasike nuk është muzikë, apo se muzika popullore nuk është muzikë, apo se bolero nuk është, por cha-cha është. Besoj se të gjitha jane shprehi njerëzore me vlerë të madhe, sepse edhe ato më pak të pranueshmet kanë diçka në to. Nuk mund të shkruaj teksta dëgjoj muzikë, sepse në një pikë, interesohem më shumë në atë që po luhet se sa në atë që po shkruaj.

Muzika më prek më shumë se letërsia, ose mund të jetë se më pëlqen më shumë, apo se muzika e imponon veten e saj mbi mua më shumë se letërsia. Nuk e dëgjoj teksta shkruaj, por jam gjithmonë i zhytur në të, sidomos kur jam duke shkruar. Kur isha në Barcelonë — gjatë një hiatusi pas *Njëqind vjet vetmi* duke kërkuar për një udhë se ku të shkoja më pas — dëgjoja shumë muzikë. Gjithmonë kam dëgjuar muzikë — muzikë të kulturuar, mbi të gjitha — por jo në një mënyrë të organizuar. E kam dëgjuar siç më ka ardhur, nga do që të vinte. Në Barcelonë [në vitet '60], avantazhi ishte se mund të dëgjoje muzikë kudo, është një qytet jashtëzakonisht muzikor. Veçanërisht dëgjoja koncertin e tretë në piano të Béla Bartok-ut — i cili më pëlqen vërtet shumë — dhe e luaja shumë, sidomos në ditët kur po shkruaja *Vjeshta e Patriarkut*.

Kur u botua, qenë disa ekspertë — edhe në letërsi, edhe në muzikë — të cilët u përpoqën të më tregonin se, në njëfarë mënyrë, kompozimi, struktura e atij libri, ishte bazuar në atë koncert të Béla Bartok... megjithëse asnjëherë nuk e kuptova shpjegimin që më dhanë. Duhet të vrasësh mendjen se çfarë zhanri muzikor është *Për dashurinë dhe demonë të tjerë!* Nuk ia kam idenë, por ka gjasë që të ketë muzikën e vet. Ajo që doja [për romanin] ishte që të mos kishte asnjë mospërputhje. Që të ndodhë kjo, duhet të punosh katër vjet për një libër 200-faqësh, çdo ditë, duke u siguruar se nuk ka asnjë notë të papërputhur.

PO VJEN FUNDI

ora 2 e mëngjesit
në dhomën time të vogël
lë makinën e shkrimit
për pak kohë
ndez cigaren tjetër
dhe vazhdoj të dëgjoj
Bethovenin
në radio.
unë dëgjoj dhe dukem
kaq i çuditshëm
i plogët,
një genie parazite
mendjen e kam te një poezi tjetër
dhe tek një tjetër pas saj
dhe tek ushqimi i keq që ha
a s'është kjo
një mrekulli
në kohën që po më vjen fundi
si dikur
dhe tani
unë admiroj guximin dhe të pirët prej
sarhoshi
të kompozitorit
vdekur
mbi 100 vite më parë
kush është më i ri dhe më i fortë
ai është sigurisht
po dhe unë jam

shkëlqejnë shekujt
prej magjisë së rrallë
të krijesave hyjnore
që na shkëpusin prej të zakonshmes së
tmerrshme
dhe sëmundjeve të pashërueshme
që na rrethojnë

ndez cigaren e
fundit
kujtoj të gjitha orët 2 të mëngjesit
të së kaluarës sime
i nxjerr jashtë bareve
në kohën që mbyllen
i nxjerr në rrugë
(një zhgan i rreckosur
me vetmi fillikate
njerëz
ishim ne)
secili zvarritet në shtëpinë e vet
vetem

shumë më mirë është të jetosh
si unë
tani
të thuash
gjallë jam
gjallë
të dëgjosh për
optimizmin
mirësinë
shpresën
të mrekullueshmen
SIMFONINË E TRIUMFIT;
jetën e re.

NJË LETËR NGA HADI NË KUTINË TIME POSTARE

lexoj;
z. Chinaski, ne erdhëm për t'ju thënë nëse
jeni i interesuar për një drekë falas.
ne do të vimë përsëri
pasdite
do të sjellim ca birra.
tani është ora 14:00
presim telefonin tuaj nëse jeni i interesuar.

397 - 8211
Steve dhe Frank

PA PËRVOJË NË DASHURI

vajzë e vogël e zeshkët me
sy të ëmbël

po vjen koha
të përdorësh thikën
po unë s'do të frikësohem
s'do të bëj me faj
ty
po veten
ndërsa ngas makinën
përgjatë bregut
fillikat
shoh valëvitjen e palmave
të palmave të shëmtuara të rënda
të gjallët s'mbërrinjë
të vdekurit s'largohen
nuk të bëj me faj
e harroj thikën
kujtoj puthjet
buzët tona që s'dinin të puthnin
se s'kishin përvojë në dashuri
kujtoj ato çaste
si më dhe gjithçka që kishe
dhe unë
si të dhashë ç'kish mbetur
ende
kujtoj dhomën tonë të vogël
atë ndjesi delikate për ty
dritën në dritare
historitë e tua
librat e tu
kafenë tonë të mëngjesit
mesditat tona netët tona
trupat tanë që u derdhën së bashku
kur binim për të fjetur
rrymat e vogla, rrjedhjet
të menjëhershme dhe të paharruara
këmba jote këmba ime
krahu yt krahu im
buzëqeshja jote, ngrohtësia
jote
që më bëjnë të qesh dhe tani
vajzë e vogël e zeshkët me
sy të ëmbël
ti nuk ke thikë, thika është
imja
nuk po e përdor
ende

GJENIU I TURMËS

ka shumë urrejtje, pabesi, dhunë, absurditet
te njerëzit mesatarë
qenie të gatshme për te furnizuar ushtritë
në çdo kohë

dhe më të mirët në vrasje janë ata që
predikojnë kundër saj
dhe më të mirët në urrejtje janë ata që

predikojnë dashurinë
dhe më te mirët në luftë janë ata që
predikojnë paqen


ata që predikojnë zotin, kanë nevojë për
zotin
ata që predikojnë paqen nuk kanë paqe
ata që predikojnë paqen nuk kanë dashuri

kujdes nga predikuesit
kujdes nga të diturit
kujdes nga ata që gjithmonë lexojnë libra
kujdes nga ata që e urrejnë varfërinë
ose nga ata që janë krenarë për të
kujdes nga ata që shumë shpejt ju ngrenë
në qiell
dhe presin t'ua kthesh me të njëjtën
monedhë
kujdes nga ata që menjëherë ju censurojnë
se kanë frikë ngaqë shumë gjëra nuk i njohin
kujdes nga ata që kërkojnë t'i ndjekë turma
ngaqë vetëm nuk ndjehen të fortë
kujdes nga burri mesatar, kujdes nga gruaja
mesatare
kujdes nga dashuria e tyre, se dashuria e tyre
është mesatare
në çdo gjë kërkojnë mesataren

por janë gjeni në urrejtjen e tyre
ka shumë gjenialitet në urrejtjen e tyre për
t'iu vrarë
për të vrarë dikë
duke mos duruar vetminë
duke mos kuptuar vetminë
ata do të përpiqen të shkatërrojnë gjithçka
që ndryshon nga botkuptimi i tyre
duke mos qenë në gjendje për të krijuar art
ata kurrë s'do ta kuptojnë artin
dhe dështimin e tyre si krijues do ta
arsyetojnë
vetëm si dështim të botës
duke mos arritur të dashurojnë vërtet
ata do ta besojnë dashurinë tuaj të
gënjeshtert
dhe pastaj ata do t'ju urrejnë
dhe urrejtja e tyre do të jetë një kryevepër

si një diamant rrëzëllitës
si një thikë
si një mal
si një tigër
si një bar helmues

arti i tyre i mahnitshëm!



Para rreth një muaji në qendrën kulturore *Destil Creative Hub* në Tiranë u bë një bisedë e hapur mbi tablonë “Origjina e botës” e piktorit realist francez të shekullit të 19të Gustave Courbet. Shkas për bisedën e historianes së artit ishte reagimi i ashpër i qytetarëve tanë ndaj një vaje, e cila e kishte parë dhe e kishte fotografuar tablonë, që ndodhet e ekspozuar në Muzeun e Artit Orsey në Paris dhe e kishte postuar foton në faqen e saj në facebook. Piktura paraqet torsin e zhveshur të një gruaje dhe seksin e saj në plan të parë.

Përse këto reagime e mallkime të zemëruara të qytetarëve tanë ndaj vajzës?

Vajza, që postoi fotografimin e pikturës në facebook padyshim u nis nga fakti, që tablonë e shihte si vepër arti, pasi e kishte parë në një muze, për më tepër në një muze të madh si muzeu Orsey. Nisur nga ky kontekst kulturor, postimi i saj është krejt i pafajshëm.

Po publiku shqiptar nuk e ka edukimin artistik në nivelin e edukimit të publikut evropian, që të kuptonte se ishte konteksti kulturor, që e shtyu vajzën të fotografonte e të publikonte foton e tablosë. Megjithatë publikut shqiptar nuk i mungoi intuïta, e cila e ndihmoi të dallojë një nudo nga një paraqitje pornografike, ndonëse i mungoi mirësjellja të komentonte si qytetar.

Për të qënë më e qartë për lexuesin, në fillim dua të tregoj, në atë që do shkruaj më poshtë, se si u edukua syri im për të parë sot “Origjinën e botës”, për të dalluar një nudo, një vepër arti, nga një trup lakuriq.

Nisa studimet në Institutin e Arteve në Tiranë, sot Universiteti Arteve, pasi mbarova gjimnazin. I vetmi libër arti që kisha parë deri atëherë kishte qënë një katalog me peizazhe natyraliste të një piktor natyralist rus, ndikimin e të cilit m'u deshën vite ta fshij nga kujtesa. Në orën e vizatimit në atë shkollë pashë për herë të parë një grua të zhveshur, një grua që gjithë hir hiqte rrobat e trupit në sy të njëzetë e një studentëve dhe u dhuronte peizazhin e bukur të trupit të saj. E shihja me ndrojtje modelin, e shihja me turp. Për herë të parë pashë djem, që preknin format e trupit të një gruaje të zhveshur me delikatesë, si të preknin një vepër arti.

Ajo që shtrihet para meje qe njeriu i parë i rritur, i veshur vetëm me lëkurën e vet. Pamja e asaj gruaje të zhveshur ishte një goditje e fortë në themelin e edukimit tim, i cili kishte aq shumë fjalë, aq shumë gjeste të përcaktuara si “Turp”. Atë ditë nisa të mësoj si duhej të shihja. Ajo grua nuk ishte “turp”. Ajo dhuronte me bujari pamjen e një trupi njeriu, trupit të saj, për ne që donim të mësonim çfarë ishte «e bukur». Atë ditë nisi për mua një kthim i mundimshëm prapa për të ndërtuar një bazë të re edukate, sepse deri atë ditë më shumë më kishin mësuar si “të mos shihja”, sesa “si të shihja”.

Ngadalë nisa të kuptoj se është “vështrimi”, që paraprin kur shprehemi mbi kuptimit që kemi formuar për botën, për shoqërinë, për krijimin, që përcakton edhe identitetin e një vepre arti, edhe titullin e saj. Gjithashtu nisa të kuptoj se është edukimi i vështrimit tonë, që na bën të aftë të dallojmë një figurë lakuriq nga një nudo, që na ndihmon të përcaktojmë natyrën e një vepre në vartësi të një konteksti kulturor.

Vite më vonë, kur punoja në sektorin e studimit të Galerisë Kombëtare të Artit në Tiranë, pashë në praktikë efektin e gjestit të artistit francez Marcel Duchamp, i cili në vitin 1917 vendosi të ekspozonte në ekspozitën e parë të Shoqatës së Artistëve të Pavarur në Nju Jork një urinore, duke e thënë se “është zgjedhja e artistit, që edhe sendeve të zakonshme u jep dinjitetin e një vepre arti”. Artin e krijuar deri atëherë ai e quante një art të krijuar për t'i pëlqyer syrit dhe na mësoi ta përdorim artin t'i shërbejë mëndjes. Ai efekt që krijon konteksti kulturor, në të cilin vendoset objekti, kësaj here oborri i Galerisë Kombëtare të Artit në Tiranë, i shtyu një grup vizitorësh të huaj ta merrnin për «vepër arti» një buldozer

Si u edukua syri im të shohë sot tablonë “Origjina e botës” të Gustave Courbet

Nga Eleni Laperi

të vogël, të lënë në oborin e galerisë nga puntorët, që ato kohë po restauronin godinat e ministrive aty pranë. Vizitorët më pyetën se “cili ishte autori i saj”. Me sa duket ata tashmë e kishin mësuar se konteksti kulturor është përcaktues i asaj që shohim. Në një kantier ndërtimi ajo makineri do të ishte “mjet pune”; në përmasa të vogla në dhomën e një fëmije do të ishte “lodër”; në oborin e Galerisë Kombëtare të Arteve ajo ishte “vepër arti”.

Është ndoshta një hyrje e gjatë, por e pashë të nevojshme të tregoj se si u edukua syri im të shohë sot tablonë “Origjina e botës”, për të kuptuar atë që do shkruaj më poshtë.

Sipas pedagoges amerikane Beth Eck, është konteksti kulturor në të cilin është vendosur, që përcakton edhe kuptimin e figurës së zhveshur të njeriut. Në kulturën Perëndimore kontekstet e njohura janë: arti, pornografia, informacioni dhe qëllimi fitimprurës. Sipas Eck shekulli 21 mund të ketë krijuar kategorinë e katërt, nudon-mall, e cila përdoret për të tërhequr vëmendjen për qëllime fitimprurëse. Pra, mënyra se si ne i shohim sot gjërat, ndikohet nga mendësia e kohës, nga ajo që ne dimë apo që ne sot besojmë. Për shembull, për brezin tim një kala ishte vendi ku mbroheshin banorët prej sulmeve të të tjerëve; sot për fëmijët e qyteteve tona një kala është vendi, që vizitohet nga turistët.

Një sy i edukuar di të përcaktojë se cila

dhe çfarë është “vepër arti”, di të dallojë në se një figurë e zhveshur në një tablo është një nudo, pra një vepër arti, apo një figurë lakuriq, qëllimi i paraqitjes së të cilës anon nga pornografia. Është pastaj guximi qytetar që na shtyn të themi mendimin tonë, bazuar në fakte, por edhe të pranojmë kur gabojmë përballë fakteve të reja.

Ky guxim më shtyu të shkruaj përsëri për tablonë e piktorit francez Gustave Courbet, të titulluar, nuk di se se nga kush, “Origjina e botës”. Them përsëri, pasi për herë të parë kam shkruar për të në vitin 2014, kur në shtypin shqiptar u botuan disa shkrime për tablonë dhe për pronarin e parë të saj, pashain ekstravagant turko-shqiptar Halil Sherif Pasha. Më saktë, shkrimi im i atëhershëm ishte një lloj kundërvënies ndaj ekzaltimit nacionalist të pabazë për origjinën shqiptare të pashait otoman, i cili, sipas artikullshkruesve, duhej të na bënte krenarë ne shqiptarët e prapambetur, pasi duke porositur pikturën e quajtur sot “Origjina e botës”, ku është pikturuar vetëm një copë e trupit të një gruaje dhe seksi i saj, pashai ua kishte kaluar parizianëve, duke u treguar më mëndjehapur e me ndjenja më të stërholluara.

Për dhjetra vite piktura, tashmë e ekspozuar në muzeun Orsey në Paris, i kishte vënë në vështrësi historianët e artit, të cilët donin të përcaktonin cila kishte qënë modelja, që kishte pozuar për tablonë. Sepse tablosë i mungon portreti dhe në plan



të parë të saj është vetëm seksi i padepiluar i një gruaje. E që një studiues të kuptojë arsyen e krijimit të një vepre, për të është e nevojshme të ketë disa të dhëna. Gjëja më e thjeshtë për historianët ishte të besonin se torsi i zhveshur i paraqitur në pikturë i takonte modeles flokëkuqe irlandeze Joanna Hufferman, e cila ishte edhe e dashura e piktorit. Disa mendonin edhe se tabloja “Origjina e botës” ishte pjesë e prerë, me kërkesën e Halil Sherif Pashës, nga një tablo më e madhe, në të cilën tregohet trupi i plotë i modeles, që pozonte si një grua në ekstazë.

Dilemat vijuan deri në vitin 2018, kur historiani francez Claude Schopp deklaroi se kishte zbuluar në korrespondencën e Alexandre Dumas të Riut me shkrimtaren George Sand, se modelja misterioze, që pati pozuar për tablonë e porositur prej Halil Sherif Pashës kishte qënë e dashura e pashait, kurtizania Constance Queniaux. Pashai otoman kishte dashur të blinte vetëm atë copë të tablosë realiste, në se kishte qënë një tablo e madhe fillimisht, apo kishte porositur një pikturë ku paraqitej vetëm ajo pjesë e trupit të së dashurës së tij, ku përfshihej vetëm organi gjenital i saj i padepiluar.

Do ishte pak më i thjeshtë problemi i analizës, në se do pranohej dhe faktohej se piktura «Origjina e botës» ishte pjesë e një tabloje më të madhe, ku paraqitej figura e plotë e një gruaje të shtrirë. Kjo



do ta bënte më të pranueshme cilësimin e tablosë si shfaqje e përpjekjes së piktorit për të idealizuar një gjendje ekstaze të gruas, duke e bërë pjesë të listës së veprave të tij.

Lind pyetja: “Origjina e botës” është vepër arti erotike apo thjesht një tablo pornografike?

Përgjigjet që gjeta për pyetjen më forcuan bindjen për natyrën e tablosë, për arsyen e vërtetë të porositjes së saj, arsye që përcakton edhe gjininë e veprës si një tablo pornografike. Sepse pornografia e redukon figurën e gruas vetëm në paraqitjen realiste deri në detajet më të imta të organit seksual të saj. Arti erotik dhe pornografia ndryshojnë nga njëri-tjetri sepse ndërsa pornografia supozohet si degraduese, objektivizuese ose shfrytëzuese e figurave njerëzore që paraqet, në veçanti gratë, arti erotik respekton lirinë dhe thellësinë psikologjike të personazheve të paraqitura. Ajo që bëri Kurbe, pasi ia shiti veprën Halil Sherif Pashës, përpjekja për ta fshirë nga kujtesa e krijimtarisë së tij, tregon se edhe vetë piktori ndoshta e dinte, që vepra ishte kthyer në objekt pornografik, po ja që ky është edhe çmimi, që ndonjëherë paguan nevoja për para e një artisti. Një tjetër përgjigje për pyetjen është ajo që bëri vetë Halil Sherif Pasha: fshehja e tablosë në studion e tij.

Më ka ndodhur të shoh se si mosdija na shtyn t’i shohim gjërat në një mënyrë, e cila zbulon atë që nuk dimë. Duke u përpjekur të tregohemi më të ditur se të diturit, më mendjehapur se më të përparuarit, arrijmë në përcaktime të gabuara për atë që shohim. Do të thoja se ky është rasti i mungesës të qëndrimit kritik ndaj imazhit të tablosë “Origjina e botës” e piktorit Gustave Courbet. Qëndrimi ynë, me mangësi në fushën e njohjes nuk na ka lejuar shpesh të dallojmë se kur një nudo, qoftë ajo e pikturuar, qoftë e fotografuar, e kthen figurën e një gruaje në një trup të lakuriqtë, në një mall, në subjekt pornografik.

Para dhjetë vitesh unë “u sulmovat”, sepse dola kundër asaj që disa autorë e quajtën “krenari” për shqiptarët, sepse mohova “vlerat kulturore” të pashait osmano-shqiptar Halil Sherifit, edhe pse e shpjegova përse për mua ai nuk ishte më mendjehapur se parizianët e kohës së tij. Megjithatë duhet ta pranoj se u përballa me një “sulm elegant”, ndryshe nga reagimet që mori vajza shqiptare në postimin e saj në facebook. Si thashë më lart, e justifikoj veprimin e saj, sepse e krahasoj me qëndrimin e vizitorëve të huaj, të cilët e quajtën vepër arti buldozerin, që e panë në oborrin e Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë, nisur vetëm nga vendi ku makineria ishte lënë. Aq më e bindur duhej të ishte vajza shqiptare, e cila e pa tablonë të ekspozuar në një muze dinjitoz të Francës.

Nuk mungoi reagimi ndaj meje edhe në takimin në *Destil Creative Hub*, sepse e quajta “pornografi” tablonë pa portretin dhe vetëm me seksin e një gruaje, tashmë të cilësuar “kryeveprën e piktorit” prej disa kritikëve perëndimorë. Kësaj here nuk mungoi ironia. Dua të besoj se ironia e ndonjë teoricieni të periferisë nuk ishte nxitur nga dijet e teoricienit, po nga ideja se një studiuese e periferisë po “guxonte” të dilte kundër kritikëve perëndimorë të një muzeu të famshëm dhe “kryeveprën e Courbe-së” po e cilësonte si pikturë pornografike.

Jam mësuar me reagime negative, por tanimë kam mësuar edhe unë ta them mendimin tim, duke u mbështetur në faktet që gjej, ashtu si kam mësuar të pranoj gabimin, kur ndeshem me fakte bindëse. Kësaj here pyes: a mund të mendojmë se qëndrimi i kritikëve perëndimorë ka nuanca komerciale, për të mos dëmtuar të ardhurat dhe reputacionin e muzeut, të veprës dhe të piktorit të tyre?

Pse jo?

Në librin e tij “Ways of seeing”, John Berger, kur flet për vizatimin e Leonardo da Vincit “Virgjëresha me Krishtin, shën Anën dhe Shën Gjonin”, që ndodhet në Galerinë Kombëtare në Londër, thotë se galeria shet



riprodhime të kësaj veprë më shumë se të çdo veprë tjetër të koleksionit të saj. Shkak u bë fakti se vizatimin e nxjerrë në ankand vite më parë u ofrua ta blinte një amerikan për mbi gjysmë milioni paunds. Tani vizatimi është i ekspozuar pas një xhami anti-plumb, jo për shkak të asaj që paraqet, jo për domethënien e vizatimit. Vepra është bërë mbreslënëse dhe misterioze për shkak të vlerës së saj në tregun e artit.

Arti i madh mund të përmbajë shprehje të përmbajtjes seksuale pa u bërë i pahijshëm, shkruan historiani Kenneth Clark. Skulpturat e detajuara të tempujve indianë të shekullit të 10të ai i quan “kryevepra arti, sepse erotizmi i tyre është pjesë e gjithë filozofisë së tyre”. Edhe Wendy Doniger O’Flaherty, një indologje amerikane, kur shkruan për Kama Sutrën, e quan “një vepër filozofike”, duke e ngritur në statusin e dy veprave të mëdha filozofike, të cilat kanë ndikuar në formimin e shoqërisë indiane: Dharmashastra e Manu-s dhe Arthashastra e Kautilya-s.

Po cila ishte filozofia e Halil Sherif Pashës, që porosi tablonë, të cilën më pas autori, piktori i madh Gustave Courbet, e “mohoi”? Them “e mohoi” pasi dihet se ai, që e kishte zakon të përshkruante gjithë qëllimet e tij artistike në korrespondencat me miqtë e tij, tablonë “Origjina e botës” nuk e ka përmendur asnjëherë, madje nuk ka vënë as firmën e tij në telajo.

Halil Sherif Pasha u lind në Soyut të Egjiptit të Sipërm (atëherë pjesë e perandorisë osmane) në qershor të vitit 1831 në familjen e Muhamed Sherif Pashës, një shqiptar i lindur në Kavala (sot qytet në Greqi). I ati i Halilit, Muhamed Sherif Pasha, ishte bir i adoptuar i Muhamed Ali Pashës, sundimtarit me origjinë shqiptarë të Egjiptit, i cili e mori Muhamedin nga Kavala, e adoptoi, e edukoi bashkë me djemtë e tij dhe e bëri kapiten të ushtrisë egjiptiane të Perandorisë Osmane. Djali i Muhamed Sherifit, Halili, u rrit në një mjedis, ku shkriheshin detyrim për të qënë pjesë e Perandorisë Osmane dhe dëshira për të pranuar ndikimin e madh të evropianëve perëndimorë, që tashmë e njihnin dhe e frekuentonin Egjiptin. Sipas Deniz Turker, që ka studiuar karrierën diplomatike dhe zhvillimin e idealeve egalitariste dhe reformuese të Halilit, Parisi u bë qëndra e viteve të formimit të tij. Më 1856 Halili hyri në shërbimin diplomatik, madje u dërgua si antar i delegacionit fuqiplotë, që përfaqësonte Perandorinë Osmane në bisedimet ruso-turke, pastaj u emërua ambasador i Perandorisë Osmane në Athinë, e më vonë ambasador në Shën Petërburg. Po pas katër vitesh ai dha dorëheqjen nga diplomacia dhe në 1865 shkoi të kalonte ca kohë në Paris, mbasi atje kishte mundësi kurimi për sifilisin, që mendohet se e mori në Rusi. Po atë vit Halili i vdiq i ati, duke

i lënë një pasuri të madhe. Paskëtaj ai mori me qera një apartament të shtrenjtë në rrugën Taitbout në Paris dhe nisi një jetë luksoze të shfrenuar prej bohemi pasanik. Djaloshi bukurosh e me kulturë u integrua shpejt në jetën e shoqërisë së lartë pariziane. Sipas shkrimtarit e kritikut të njohur francez Théophile Gautier, ai ishte “biri i parë i Islamit, që hyri në rrethet elitare të Perandorisë së Dytë”, ku e quanin “princ i përrallave orientale”... që mbeti turk për nga bujaria dorëshpuar, nga tërheqja pas grave e kumarit, por u bë parizian për nga mendjeprehtësia, eleganca dhe dashuria për teatrin dhe artet”. Veç nuk harronin edhe të shtonin se ai ishte “njeri i edukuar, por imoral e mëndjelehtë”. Halil Pasha u martua dy herë, po edhe gruaja e parë, fisnikja franceze Julie de Niverlie, edhe gruaja e dytë, princesha Nazli Fazl nga dinastia e Muhamed Ali Pashës së Egjiptit, nuk e duruan dot jetën aq të shturur të tij.

Gjesti i tij, porosia e tablosë ku ishte pikturuar vetëm seksi i një gruaje, ishte i pashpjegueshëm dhe shprehje e një guximi të marrë për evropianët, ndërsa për pashain osman ishte thjesht plotësimi i një dëshire erotike të shfrenuar, e cila ishte pjesë e moralit me të cilin ishte ushqyer gjatë jetës së tij në shoqërinë e lartë osmane, moral, që në fund i mori edhe jetën në moshën 48 vjeçare.

A e vendosin këto të dhëna pikturën realiste dhe aspak të idealizuar të seksit të padepiluar të një gruaje në kontekstin kulturor të artit apo të pornografisë? A e bëjnë “të turpshme” tablonë edhe për një sy të edukuar?

Duke qenë se jemi mësuar t’i shohim skulpturat dhe pikturat e Egjiptit të lashtë, Greqisë, Romës si trupa të pastër, të lëmuar, pra të depiluar krejt, na habit kaçubja e errët në seksin e torsit të “Origjinës së botës”. Depilimi përdorej nga egjiptianët e lashtë, nga grekët e romakët e për këtë kemi prova edhe shtatoret e pikturat e kohëve të vjetra. Piktoret dhe skulptoret pas tyre po ashtu i paraqitën të depiluara gratë në tablotë e shtatoret e tyre, që trupat e tyre të dukeshin të pastër e të lëmuar si mëndafsh. Për romakët e lashtë një trup i depiluar ishte edhe simbol i një qytetari të shoqërisë së lartë. Një trup i depiluar ishte një trup i idealizuar, një shprehje e së bukurës.

Edhe te shqiptarët trupi i depiluar i gruas haset te riti i dasmës shkodrane. Kur kërkoja të mësoja domethënien e kompozimit të tablosë «Dasma shkodrane» të Kolë Idromenos, mësova se edhe gratë katolike të Shkodrës e depilonin krejt trupin para martesës, lyenin edhe flokët, një rit që përsëritej deri në fund të jetës. Ashtu depilohen sot edhe yjet e kinemasë apo të televizionit, personazhet VIP.

Po përse Courbet në tablonë “Origjina e botës” e ka paraqitur seksin e gruas të

padepiluar? Patjeter duhej të ishte sipas porosisë të Halil pashës, për koleksionin e tij të tablove erotike, që ai bleu në Paris nga piktorët Delacroix, Ingres, etj., tablo të ekspozuara në apartamentin e tij.

Përse e mbante të fshehur tablonë e Courbet, ku ishte pikturuar vetëm seksi i të dashurës së tij, qoftë ajo një kurtizane? Dhe përse e zbulonte veç për ndonjë mik të rangut të tij, prototip i burrave të pasur apo të pushtetshëm, që kanë më shumë pasuri e pushtet se sa u nevojitet? Sepse edhe ai vetë e dinte natyrën e asaj porosie, një porosi që zbulonte filozofinë e rrethit ku ai ishte rritur, rrethi i shoqërisë së lartë otomane, ku pashallarët dhe vetë sulltani i lejonin vetes jo vetëm argëtimin me dhjetra gratë e haremit, po edhe dëfrimin me djem të rinj, ku gruaja konsiderohej qënie e papërsosur apo njeri i dorës së dytë. Ai ua tregonte pikturën vetëm disa miqve të pasur e të pushtetshëm, që fshehurazi bënin një jetë të shturrur si ai, ndërsa hapur shpreheshin të “skandalizuar” prej zakoneve të shturura të oborrtarëve osmanë.

Për të përcaktuar kontekstin kulturor të tablosë së porositur nga pashai otoman, nisur nga dëshira e tij të kishte në telajo të pikturuar jo gjithë figurën e të dashurës së tij, jo portretin e saj, po vetëm pjesën e trupit të së saj, që përfshinte organin gjenital, na ndihmojnë në gjykimin tonë katër të dhëna: 1. Gustav Kurbe, nuk na ka lënë të shkruar asnjë fjalë për këtë pikturë të tij; 2. Piktori nuk e ka vënë firmën e tij në vepër; 3. Halil Sherif Pasha, porositësi i saj, pronari i saj i parë, e mbajti gjithnjë tablonë të fshehur pas një cohe të blertë në studion e tij dhe e zbulonte vetëm për t’i a treguar ndonjë miku të rangut të tij; 4. Edhe blerësi i fundit i kësaj tabloje, psikoanalisti francez i shekulli të 20të, Jacques Lacan, nuk e ekspozoi kurrë veprën origjinale, të cilën e fshehu pas riprodhimit surealist të saj prej mikut të tij, piktorit André Masson.

Sot ne jemi dëshmitarë të përdorimit të figurës së gruas si objekt, si mall fitimprurës në art dhe në fotografi, në programet televizive, në videoklipet e këngëtarëve bashkëkohës, në posterat e afishuara nëpër qytet. Gjysmë e zhveshur apo lakuriq, gruaja është kthyer në një mall, cili tregtohet përpara syve indiferentë të qytetarëve në qytetet tona. Ndonëse shihet një formë e re ndërgjegjësimit në lidhje me krijimtarinë e viteve dhe shekujve të kaluar, ndërgjegjësimit i formuar nga një këndvështrimi i ri i një shoqërie të hapur, nga pasurimi i dijeve, po e mëncurojnë vështrimin tonë. Kjo nuk i ndalon sloganet lidhur me “lirinë e shprehjes”, “lirinë seksuale”, liri të keqinterpretuara prej tyre, të cilat me qëllim apo pa qëllim po bëhen shkak i shtimit të akteve të dhunës, sidomos ndaj grave.

Që në vitet ‘60 të shekullit të kaluar lëvizja feministe vuri në dukje se përmbajtja e qartë seksuale në të shumtën e rasteve me pamje që tregojnë – pra miratojnë dhunimin e njerëzve, sidomos të grave, nënshtrimin seksual, përmbajtja e reduktuar në pjesët e trupit që kanë në qendër organin seksual, etj., është përmbajtja që ka sjellë sot degradim e përshkallëzuar në mënyrë dramatike të figurës së gruas.

Ne sot jemi dëshmitarë të një klime dhune të përsëritur ndaj grave. Jo vetëm në vendin tonë. Çdo ditë dhunohen gra ngado. Dhe një nga arsyet është edhe pasqyrimi i figurës së tyre të reduktuar në objekt seksi, fokusimi i këtij promovimi në pjesën apo në rolin e tyre seksual. Këtë e shohim në posterat e afishuar edhe nëpër Tiranë, në përmbajtjen e emisioneve televizive, që nën petkun e promovimit të «lirisë së shprehjes», dhe “lirisë seksuale” si shenja të një shoqërie të përparuar, në të vërtetë promovojnë figurën e gruas si mall i tregut të seksit, si objekt dëfrimi.

Duke u përpjekur të tregohemi qytetarë më mendjehapur se sa në të vërtetë jemi, me dashje apo padashje ndihmojmë dhunën në forma të ndryshme ndaj gruas, ndaj lirisë së vërtetë të fjalës dhe seksit.

TANUSH FRASHËRI

**Relatat italo-shqiptare
1910-1939**



*Ndihmesë historike bazuar në dokumentet
arkivore e ato të botuara*

Onufri